



► **ANALIZA KOMPARATIVE E
MODELEVE EKZISTUESE PËR
NDIHMË JURIDIKE NË BE DHE
JASHTË SAJ DHE PRAKTIKAT MË
TË MIRA**





► **ANALIZA KOMPORATIVE E MODELEVE
EKZISTUESE PËR NDIHMË JURIDIKE NË
BE DHE JASHTË SAJ DHE PRAKTIKAT MË
TË MIRA**

*“Shteti juridik është ajri që e thithim”
Gustav Radbruch*

Publikimi: ANALIZA KOMPARATIVE E MODELEVE EKZISTUESE TË NDIHMËS JURIDIKE BRENDA
DHE JASHTË BE-së DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA

Projekti: Qasje e barabartë drejtësi efektive

Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet skemës me grant “Fuqizim i ndikimit të shoqërisë civile për reforma efektive në jurisprudencë”

Autorë:

Natasha Amdiju

Kristina Najdovska Ilievski

Natasha Dokovska Spirovska

Miratuar nga:

Kryetari i Qendrës për Demokraci Ekologjike FLOROZON

Kirill Ristovski

Shkup, 2020

Ky publikim është përpiluar me përkrahje nga Bashkimit Evropian. Përmbajtja, qëndrimet dhe mendimet janë përgjegjësi e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk e pasqyrojnë qëndrimin e Bashkimit Evropian

Hyrje	9
PJEËA I: POLITIKA DHE KORNIZË JURIDIKE PËR QASJE NË DREJTËSI NË SFERËN E MJEDISIT JETËSOR DHE NDIHMË JURIDIKE FALAS NË NIVEL NDËRKOMBËTAR, RAJONAL DHE NACIONAL	11
1.1. Zhvillim të politikave ndërkombëtare dhe kornizës juridike	11
1.1.1. Përkufizim dhe domethënie e nocioneve qasje në drejtës dhe ndihmë juridike falas në sferën e mjedisit jetësor	11
1.2. Pika të nisjes për zhvillim të konceptit për qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor nën patronazh të Kombeve të Bashkuara	12
1.2.1. Deklarata e Stokholmit	12
1.2.2. Marrëveshja nga Konferenca në Rio	13
1.2.2.1 Konventa kornizë për ndryshime klimatike	1414
1.2.2.2 Dokumente që kanë rezultuar nga Samiti botëror për zhvillim të qëndrueshëm në Johannesburg ..	15
1.2.2.3 Protokolli nga Kioto	15
1.2.2.4 Konventa e Aarhusit	16
1.2.2.5 Marrëveshja e Parisit	18
1.2.2.6 Konventa tjera të Kombeve të Bashkuara në lidhje me mjedisin jetësor	19
1.2.3. Zhvillim i kornizës juridike për qasje në drejtësi dhe ndihmë juridike falas në kuadër të Kombeve të Bashkuara	19
1.2.3.1 Deklarata universale për të drejtat e njeriut	19
1.2.3.2 Traktati ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike dhe Traktati ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.....	21
1.2.3.3. Parime dhe udhëzime të OKB-së për qasje te ndihma juridike falas	22
1.2.3.4. Konventa për qasje ndërkombëtare në drejtësi	22
1.2.3.5 Të drejta të njeriut, qasje në drejtësi dhe mjedisi jetësor	23
1.3. Zhvillim i politikave rajonale dhe legjisllacionit	23
1.3.1. Politika dhe legjisllacioni në kuadër të Këshillit të Evropës	23
1.3.1.1 Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive të njeriut	24
1.3.1.2 Konventa për imunitet të jurisdikcionit.....	27
1.3.1.3 Karta Sociale Evropiane.....	27
1.3.2. Këshilli i Evropës dhe mbrojtja e mjedisit jetësor	27
1.3.3. Konventa të Këshillit të Evropës për mbrojtje të mjedisit jetësor	29
1.3.3.1 Konventë për ruajtje të botës së egër dhe habitatet natyrore (Konventa e Bernit)	29
1.3.3.2 Përgjegjësi qytetare për dëme që rezultojnë nga aktivitetet të cilat janë të rrezikshme për mjedisin jetësor (ETS numër 150).....	29
1.3.3.3 Konventa për mbrojtje të mjedisit jetësor nëpërmjet të drejtës penale nga viti 1998 (ETS numër 172)	30
1.4. Bashkimi Evropian	30
1.4.1. Sistemi për të drejta të njeriut para Bashkimit Evropian	32
1.4.2. Bashkimi Evropian dhe Konventa e Aarhusit.....	34
1.4.3 Direktiva të BE-së lidhur me mjedisin jetësor.....	34
1.4.3.1 Direktiva e Këshillit 96/61/KE për parandalim të integruar dhe kontroll të ndotjes.....	35
1.4.3.2 Direktiva 2010/75/BE për emetimet industriale	35
1.4.3.3 Direktiva kornizë për hedhurina (Direktiva 2008/98/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për hedhurina)	35
1.4.3.4 Direktiva 2003/4/KE për qasje publike tek informatat për mjedis jetësor	36
1.4.4. Zbatim i ligjeve për mjedis jetësor në BE.....	38
1.4.4.1 Këshilli për mjedis jetësor para Bashkimit Evropian (ENVI)	38
1.4.4.2 Agjencia Evropian për mjedis jetësor.....	39
1.4.4.3 THEMIS	39
1.4.4.4 IMPEL (IMPEL).....	39
1.5. Kornizë juridike në fqinjësi	40
1.5.1 Kroacia.....	40
1.5.2 Kosova	42
1.5.3 Bosnja e Hercegovina	44

1.5.4 Shqipëria	45
1.5.5 Konventa e Aarhusit në rajon.....	46
1.6 Hyrje – zhvillim i politikave dhe legjislacionit të Maqedonisë	47
1.6.1 Harmonizim me aquis communautaire në sferën e mjedisit jetësor dhe qasje në drejtësi.....	47
1.6.2 Kushtetuta e RMV-së dhe mjedisi jetësor.....	48
1.6.2.1 Pjesëmarrje e publikut në krijim të politikave.....	49
1.6.3. Ligjet dhe akte nënligjore tjera relevante.....	51
1.6.3.1 Ligji për mjedis jetësor	53
1.6.3.2 Rregullore për sigurim të qasjes tek informatat lidhur me mjedisin jetësor.....	56
1.6.3.3 Ligji për cilësi të ajrit ambiental.....	57
1.6.3.4 Ligji për mbrojtje të natyrës	57
1.6.3.5 Ligje tjera në pjesën e mjedisit jetësor	58
1.6.3.6 Ligj për ndihmë juridike falas.....	60
1.6.4 Praktikë jashtëgjyqësore dhe gjyqësore në Maqedoni në sferën e mjedisit jetësor dhe qasja në drejtësi	64
1.6.4.1 Avokat i Popullit	64
1.6.4.2 Ndërmjetësim	64
1.6.4.3 Mekanizëm ankimor i Aarhusit	65
1.6.4.4 Konventa për mbrojtje të botës së egër bimore dhe shtazore dhe të habitateve natyrore në Evropë (Konventa e Bernit)	65
1.6.5. Procedura gjyqësore.....	66
1.6.5.1 Gjykata kushtetuese e RM-së.....	66
1.6.5.2 Procedurë civile	68
1.6.5.3 Procedura penale	69
1.6.5.4 Procedurë administrative	71
1.6.5.5 Procedurë për kundërvajtje	72
1.6.5.6 Ankesë për aktvendim apo vendim në Komision të Qeverisë.....	73
1.6.6. Mekanizma rajonale për mbrojtje gjyqësore në dispozicion të qytetarëve në RMV	73
PJESA II: PRAKTIKA GJYQËSORE NË EVROPË ME FOKUS NË MJEDISIN JETËSOR DHE NDIHMA JURIDIKE FALAS.....	75
2.1 Hyrje – zhvillim i praktikë gjyqësore	75
2.1.1 Gjykata Evropiane e drejtësisë.....	75
2.1.1.1 Gjykata e drejtësisë dhe implementim i Konventës së Aarhusit	77
2.1.2. Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut	77
2.1.3 Komiteti për harmonizim me Konventën e Aarhusit	80
2.1.4. UNECE –Komisioni ekonomik i KB për Evropë	82
2.1.5. Praktikë gjyqësore e gjykatave nacionale të vendeve në botë dhe Evropë	83
2.1.5.1 Praktika gjyqësore në Armeni.....	83
2.1.5.2 Praktika gjyqësore në Belgjikë	85
2.1.5.3 Praktika gjyqësore në Hungari.....	87
2.2 Vështrime përmbyllëse	88
PJESA III: PRAKTIKAT MË TË MIRA NË SIGURIM TË QASJES NË DREJTËSI NË SFERËN E MJEDISIT JETËSOR	89
3.1 Praktika të mira për të drejta të njeriut dhe mjedisin jetësor	89
3.2 Actio popularis.....	89
3.3 Praktika të mira për qasje në drejtësi në sfera tjera.....	90
PJESA IV: REKOMANDIME PËR ZHVILLIM TË MËTUTJESHËM TË POLITIKAVE TË MAQEDONISË DHE LEGJISLACIONI PËR QASJE TË LEHTËSUAR NË SFERËN E MJEDISIT JETËSOR	92
4.1 Rekomandime për qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor	92

LISTA E NOCIONEVE

KB – Kombet e Bashkuara

UNECE- United Nations Economic Commission for Europe, Komisioni ekonomik i KB për Evropë.

UNCSD–Konferencë për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara

BE –Bashkimi Evropian

EEA –Agjencia evropiane për mjedis jetësor

E-PRTR–Regjistri evropian për emetime dhe transmetim të ndotësve

OECD– Organizatë për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim REC– Qendër rajonale për mjedis jetësor

MMJPH – Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor

VNMJ–Vlerësim i Ndikimit mbi Mjedisin Jetësor

SEP–Vlerësim Strategjik i Mjedisit Jetësor

PIKN – Parandalim i Integruar dhe Kontroll të Ndotjes

RETN– Regjistër për emetime dhe transmetim të ndotësve

GZRM – Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë

EJL -Evropa juglindore

FBeH – Federata e Bosnje e Hercegovinës

RS – Republika Serpska

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut

HYRJE

Ky publikim ka për qëllim të japë pasqyrë komparative të gjendjeve në botë, Evropë, Republikën e Maqedonisë së Veriut si dhe në rajon për qasjen në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor. Njëkohësisht, jep udhëzime për përforcim të ndikimit të shoqërisë civile në reformat efektive në sektorin e jurisprudencës, në pajtim me standardet ndërkombëtare të Bashkimit Evropian, për të vlerësuar efikasitetin e sektorit gjyqësor nëpërmjet bashkëpunimit të sektorit publik me palët e interesuara, përkatësisht organizatat civile.

Dokumenti është përgatitur nga një ekip ekspertësh, të angazhuar në suaza të projektit: “Qasje e barabartë për drejtësi efektive”, i zbatuar nga Shoqata e qytetarëve Qendra për demokraci ekologjike FLOROZON nga Shkupi, në partneritet me Environmental Law and Management Association EMLA nga Hungaria. Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet skemës së grantit nga CFSD para Ministrisë për financa–“Përforcim i ndikimit të shoqërisë civile mbi reformat efektive në sektorin juridik” EuropeAid/159467/ID/ ACT/MK, numri i kontratës 12-6208/1.

Përmbajtja e kësaj analize është diskutuar në kuadër të Trupit Joformal Koordinues (Trupi Nacional Koordinues - TNK) për qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor, i cili gjithashtu, është formuar në suaza të projektit të lartpërmendur. Qëllimi i TNK-së, ndër tjerash është t'i përkufizojë pozicionet e institucioneve të ndryshme dhe të palëve të prekura, duke përfshirë atë të sektorit civil dhe të krijojë bazë për qasje multidisiplinare nëpërmjet bashkëpunimit ndërsektorial të faktorëve kryesorë për qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor.

Projekti është në pajtim me Prioritetin 2 të thirrjes së lartpërmendur, ndërsa aksioni bazohet në konkluzionet nga Strategjia e re për reformë në sektorin gjyqësor (“Strategjia”) me Planin aksional 2017-2022, që është miratuar më 28 nëntor 2017 nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat korrespondojnë me Raportet e Komisionit Evropian për progresin e vendit në vitet e fundit. Më konkretisht, projekti ka të bëjë me fuqizimin e kapaciteteve të organizatave lokale dhe nacionale, si dhe të organeve relevante në fushën e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në mënyrë participuese dhe demokratike, nëpërmjet promovimit të mekanizmit për ndihmë juridike falas. Me zbatimin e aksionit, krahas asaj që do të fuqizohen kapacitetet për përfaqësim të organizatave civilë të synuara, do të kontribuohet edhe në zbatimin e reformave në sistemin gjyqësor në vend. Përgjithësisht, ky aksion është dizajnuar t'i përgjigjet progresit të përgjithshëm të reformave gjyqësore në vend dhe të mundëson kushte për arritjen e tyre në kontekst nacional. Arritja e qëllimeve të parapara do të bazohet në qasje gjithëpërfshirëse, fillimisht nëpërmjet vendosjes së bashkëpunimit të fortë ndërmjet palëve të interesuara.

E drejta për mjedis jetësor të pastër ekologjik është garantuar në më tepër se 100 kushtetuta nëpër botë – kjo është përkufizuar sipas Programit të Kombeve të Bashkuara për mjedis jetësor “çdo shpallje e mjedisit jetësor me cilësi të caktuar si e drejtë e njeriut”. Sipas përkufizimit të Programit, të drejtat nga sfera e mjedisit jetësor mund të jenë thelbësore dhe procedurale. Derisa të drejtat thelbësore kanë të bëjnë me mundësinë për mbrojtje nga pasojat të cilat degradimi i mjedisit jetësor i ka mbi të drejtat qytetare dhe politike, të drejtat për jetë dhe lirinë e të shprehurit, të drejtat kulturore dhe sociale, si dhe e drejta për shëndet, ujë, ushqim dhe kulturë, të drejtat procedurale janë parakusht i domosdoshëm për realizimin e llojit të parë të të drejtave. Ato paraqesin pikë kyçe ku kryqëzohen e drejta nga sfera e mjedisit jetësor dhe nga sfera e të drejtave të njeriut – parashohin hapa formal që duhet të ndërmerren në procesin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ndër të drejtat procedurale bëjnë pjesë e drejta e kërkesës për pëlqim paraprak të informuar nga qytetarët, qasje tek informatat, pjesëmarrje në sjellje të vendimeve dhe qasje në drejtësi.

Në kuadër të këtij publikimi shqyrtohen politikat dhe instrumentet ndërkombëtare për qasje në drejtësi, si dhe legjislacioni nacional, përmes prizmës së parimit të qasjes në drejtësi nga sfera e mjedisit jetësor, të mishëruar në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet Konventës së Aarhusit, të ratifikuar nga Kuvendi i RMV-së në vitin 1999.

Ky publikim paraqet pasqyrë të instrumenteve ndërkombëtare lidhur me qasjen në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor, pasqyrë në qasjen për ndihmë juridike falas me raste nga sfera e mjedisit jetësor, shfrytëzim të actio popularis kompetencës së gjykatës, pasi e njëjta është e rregulluar në nivel ndërkombëtar, ndërsa e drejta e mbrojtjes së mjedisit jetësor është e ndërlidhur paevitueshëm me të drejtën për jetë.

Gjithashtu, është bërë vështrim i legjislacionit nacional duke përfshirë edhe instrumentet lidhur me qasjen në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor, vështrim në qasjen për ndihmë juridike falas (nga perspektiva e asaj se cili është shfrytëzues i të njëjtës) duke e kërkuar lidhjen me rastet nga sfera e mjedisit jetësor.

Njëkohësisht, publikimi paraqet pasqyrë të rasteve gjyqësore në nivel ndërkombëtar dhe para gjykatave nacionale në më shumë vende, për praktikën gjyqësore si dhe për shfrytëzimin e Konventës së Aarhusit si mekanizëm për qasje në drejtësi nga shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë. Në anën tjetër, prezantohen edhe pikëpamje për shfrytëzimin e legjislacionit nacional në vendet e fokusit, përkatësisht shfrytëzimin e ndihmës juridike falas në rast të shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë, lidhur me shkeljen e të drejtës për jetë, të paraqitur nëpërmjet rasteve relevante nga gjykatat nacionale dhe evropiane (në lidhje me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut).

JESA I: POLITIKAT DHE KORNIZA JURIDIKE PËR QASJE NË DREJTËSI NË SFERËN E MJEDISIT JETËSOR DHE NDIHMË JURIDIKE FALAS NË NIVEL NDËRKOMBËTAR, RAJONAL DHE NACIONAL

1.1. Zhvillim të politikave ndërkombëtare dhe kornizës juridike

1.1.1. Përkufizim dhe domethënie e nocioneve qasje në drejtës dhe ndihmë juridike falas në sferën e mjedisit jetësor

Hulumtimi për nevojat juridike të qytetarëve përpiqet t'i identifikojnë problemet e përbashkëta për të cilat ata drejtohen për ndihmë, mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të caktuara si dhe zgjidhjet për probleme të caktuara juridike. Qasja efektive në drejtësi është përcaktori vendimtar për zhvillim të qëndrueshëm, mirëqenie e qytetarëve dhe administratë stabile publike. Sipas Organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim¹ (OECD), sundimi i të drejtës, siguria juridike e qytetarëve dhe qasja në drejtësi efektive, ndikojnë në performancat ekonomike të shteteve, të matur nëpërmjet bruto prodhimit vendor (BPV) të zmadhuar, përmirësim i konkurrencës dhe rritje e investimeve, që ndikon në reduktimin e varfërisë dhe përmirësim të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Lidhja e qasjes në drejtësi, realizimit të të drejtave të njeriut dhe zhvillimit theksohet edhe në Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm (QZHQ) të miratuara më vitin 2016. QZHQ-të paraqesin thirrje globale për aksion për t'i vënë fund varfërisë ekstreme, të sigurohet ardhmëri e qëndrueshme, mbrojtje e mjedisit jetësor dhe të mundësohet që njerëzit të gëzojnë barazi, paqe dhe drejtësi. Si rezultat i nevojës dhe përpjekjeve të anëtarëve të KB në nivel ndërkombëtar, është instaluar Qëllim zhvillimor i posaçëm numër 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta, përkatësisht nën qëllimi numër 16.3: Promovim i sundimit të së drejtës në nivel nacional dhe ndërkombëtar dhe siguri të qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë. Ky nënqëllim e thekson rëndësinë e lidhjes ndërmjet besimit në institucionet e drejtësisë, cilësisë në sistemet juridike dhe besimit në qeveri. Qasja në sistemin gjyqësor e përmirëson besimin e qytetarëve në institucionet publike nëpërmjet sigurimit të masave mbrojtëse kundër sjelljes joadekuate.

Kur cenohet ndonjë e drejtë e individëve apo grupi qytetarësh ose shkaktohet dëm, qasja në drejtësi është me rëndësi fundamentale për individin e dëmtuar dhe paraqet komponentë thelbësore të sundimit të së drejtës. Qasja në drejtësi është jashtëzakonisht e rëndësishme për shkak se, nëse ligjet nuk zbatohen dhe nuk i sanksionojnë kundërvajtësit, qytetarët nuk kanë mundësi për të realizuar të drejtat e garantuara, rritje dhe zhvillim. Në raste të drejtësisë joefektive apo të paarrtshme, ekziston padrejtësi e cila ka ndikim negativ mbi pasojat dhe efekte më të gjera mbi shoqërinë si tërësi. Qasja në drejtësi është e rëndësishme edhe për zhvillimin e ekonomisë së ndonjë vendi, për shkak se shpenzimet për nevojat e pazgjidhura juridike i mbulojnë qytetarët, biznesi dhe shoqëria. Mospërbushja e nevojave ligjore të qytetarëve mund të ketë efekte negative në drejtësi në mënyrë plotësuese e derogon barazinë në shoqëri, veçanërisht kur bëhet fjalë për grupet e qytetarëve të lëndueshëm. Pamundësia për t'u zgjidhur problemet juridike i redukton mundësitë ekonomike, e thëllon spiralen e varfërisë dhe e dobëson potencialin njerëzor si dhe rritjen inkluzive.

Qasja në drejtësi lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor donë të thotë që qytetarët mund të shkojnë në gjyq, përkatësisht të kërkojnë mbrojtje gjyqësore nëse autoritetet

¹ Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD), <https://www.oecd.org/gov/access-to-justice.htm>, [hapur 26.05.2019]

publike nuk i respektojnë të drejtat dhe nuk i plotësojnë obligimet që rezultojnë nga dokumentet ndërkombëtare, Kushtetuta dhe legjislacioni nacional në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor, të cilat ndikojnë në jetën dhe shëndetin e tyre. Qytetarët luajnë rol të rëndësishëm në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit jetësor. Autoritetet publike duhet të plotësojnë kërkesa minimale gjatë përgjigjeve ndaj kërkesave për informata lidhur me mjedisin jetësor, konsultim me publikun, kontroll të gjendjes së ajrit dhe ujit, përgatitje të planeve për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe kufizim të aktiviteteve me dëm potencial të subjekteve të ndryshme. Kontestet e pazgjidhura juridike në sferën e mjedisit jetësor mund të çojnë në probleme të mëtutjeshme juridike, sociale dhe shëndetësore si dhe shpenzime.

Qasja në drejtësi, krahas mbrojtjes së të drejtave dhe lirive personale, paraqet edhe vegël e cila i mundëson opinionit t'i konteston vendimet e miratuara nga trupa publike dhe t'i zgjidhë kontestet para një trupi të pavarur dhe të paanshëm. E drejta e qasjes në drejtësi për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ngadalë fiton rëndësi më të madhe në nivel ndërkombëtar dhe evropian, duke i mundësuar edhe opinionit të ndikojë në rishqyrtimin e vendimeve të caktuara të cilat janë në kundërshtim me ligjet për mjedis jetësor.

Ndihma juridike falas është sigurim i ndihmës për persona të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë përfaqësim juridik dhe qasje në sistemin gjyqësor. Ndihma juridike konsiderohet si qendrore në sigurim të qasjes në drejtësi nëpërmjet sigurimit të barazisë para ligjit, të drejtën për avokat dhe të drejtën për gjykim të drejtë. Funkionimi i mirë i sistemit për ndihmë juridike është i domosdoshëm për çdo shoqëri e cila bazohet në sundimin e të drejtës, me ç'rast veçanërisht kategorive të qytetarëve të lëndueshëm, iu mundësohet qasje më e shpejtë dhe më e lehtë në ndihmë juridike, si një nga të drejtat fundamentale.

Republika e Maqedonisë së Veriut në përcaktimet e saj për të arritur anëtarësi të plotfuqishme dhe anëtarësim në Bashkimin Evropian e ka për obligim harmonizimin e legjislacionit nacional me standardet ndërkombëtare nga sfera e ndihmës juridike, ndërsa me qëllim të lehtësimit të qasjes në drejtësi për qytetarët.

E drejta për mjedis jetësor të pastër është e drejtë të cilën çdo person duhet ta gëzojë pavarësisht statusin që e ka, vendin ku jeton dhe kushtet ekonomike në të cilat jeton. E drejta për mjedis jetësor të pastër është një nga të drejta e rralla realizimi i të cilës është ngushtë i lidhur me obligimin për kujdes për mjedisin jetësor, si për njerëzit ashtu edhe për të gjitha subjektet të cilat kanë rolin e tyre ekonomik dhe social në shoqëri. Nevoja për të garantuar këtë të drejtë nuk është vetëm nevojë e individit në shoqëri por edhe e vetë shoqërisë.

1.2. Pika të nisjes për zhvillim të konceptit për qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor nën patronazh të Kombeve të Bashkuara

1.2.1. Deklarata e Stokholmit

Më 5 qershor 1972 në Stokholm, Suedi është mbajtur Konferenca e Parë e KB për mjedis jetësor deklarata zyrtare e të cilës zakonisht quhet Deklaratë e Stokholmit. Si rezultat i Deklaratës së Stokholmit ka rezultuar Programi i Kombeve të Bashkuara për mjedisin jetësor (UNEP). Njëzet parimet në Deklaratën gjerësisht i njohin ndikimet e njeriut mbi mjedisin jetësor, që donë të thotë se për herë të parë në histori, çështjet për mjedisin jetësor vlenin publikisht dhe në nivel global. Deklarata e thekson nevojën që shtetet të dizajnojnë plane integrative për zhvillim të cilat i kombinojnë shkencën dhe teknologjinë për të reduktuar ndotjen e ajrit, tokës dhe ujit dhe ndikimin e njeriut mbi mjedisin jetësor. Ajo i bën thirrje secili shtet të krijojë rregullore për mbrojtjen e botës së egër dhe t'i ruajë resurset natyrore të cilat ekzistojnë në ato shtete dhe propozon krijim të politikave nacionale për popullatën, për shkak se mbipopullimi e cenon gjendjen e resurseve natyrore. Deklarata e Stokholmit ka siguruar bazë për shumë nga politikat të cilat janë vendosur në 113 vendet pjesëmarrëse.

Përveç kësaj, parimet themelore që janë paraqitur në Deklaratën dhe diskutimet që kanë çuar në atë kanë shkaktuar krijimin e Programit për mjedis jetësor të Kombeve të Bashkuara, e cila më pas ka zhvilluar më tepër protokolle specifike për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Në Parimin 1 të Deklaratës 1972 të Konferencës për mjedisin jetësor të njeriut thuhet që “njeriu ka të drejtë fundamentale për liri, barazi dhe kushte adekuate për jetë, mjedis jetësor me cilësi që mundëson jetë të denjë dhe me mirëqenie”, si dhe në tekstet e ndryshme kushtetuese të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës të cilat i mishërojnë dispozitat për mbrojtje të mjedisit jetësor në mënyrë konsekuente. Rekomandimi 1885 (2009) bën thirrje për përpilim të protokollit shtesë ndaj Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, duke e njohur të drejtën për mjedis jetësor të shëndoshë dhe të qëndrueshëm;²

Me këtë Deklaratë, vendet e botës stimulohen të inkorporojnë edhe edukim ekologjik si pjesë bazike e procesit edukativo-arsimor, ashtu që në nenin 19 thuhet: “Duhet të insistohet që individit ta kupton domethënien e përgjegjësisë personale në domenin e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit jetësor”.

1.2.2. Marrëveshja nga Konferenca në Rio

Duke e identifikuar nevojën për aktivitete të mëtutjeshme në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor, nga 3 deri 14 qershor 1992 në Rio de Zhaneiro, Kombet e Bashkuara e organizuan konferencën e madhe për mjedis jetësor dhe zhvillim të qëndrueshëm, e cila është e njohur si Samit për planetin Tokë. Nga kjo konferencë kanë rezultuar tre marrëveshje kryesore³: Agjenda 21, Deklarata nga Rio për mjedis jetësor dhe zhvillim si dhe Deklarata për parimet për menaxhim të qëndrueshëm me pyjet. Në konferencë, për nënshkrim janë hapur edhe Konventa Kornizë për ndryshime klimatike e Kombeve të Bashkuara (UNFCCC) dhe Konventa për llojshmëri biologjike (CBD), ndërsa kanë filluar edhe negociata për Konventën për luftë kundër shkretëtimit (UNCCD). Në Samitin në Rio është vendosur të themelohet Komisioni për zhvillim të qëndrueshëm para Kombeve të Bashkuara, ndërsa krahas përfaqësuesve të lartë të 179 qeverive, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Kombeve të Bashkuara, të autoriteteve lokale, të biznes sektorit, përfaqësues të qarqeve shkencor-hulumtuese, organizatave joqeveritare dhe të tjera të cilët kanë arritur konsensus për partneritet global në drejtim të baraspeshimit të nevojave për ekonomi të shëndoshë, zhvillim shoqëror dhe mjedis jetësor me cilësi të lartë. Kjo marrëveshje e përbashkët është pjesë e Deklaratës për mjedis jetësor dhe zhvillim, 27 parimet e të cilës i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e shteteve në përpjekjet e tyre për zhvillim dhe mirëqenie të njeriut.

Samiti në Rio paraqet pikë kthyesë pas çështjeve lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zhvillim të qëndrueshëm si dhe për proceset demokratike globale nga inkuadrimi i publikut të përgjithshëm gjatë miratimit të vendimeve dhe aktvendimeve lidhur me këtë problematikë.

Konferenca në Rio është mbajtur në kohë kur dispozitat për të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut bëhen kriter dominues për të gjitha vendet. Vlerësohet që degradimi i mjedisit jetësor është formë e veçantë e diskriminimit të njeriut dhe bllokimit të lirive të tij. Prandaj, qasja në zgjidhjen e problemeve për mjedisin jetësor gjithnjë e më tepër është si çështje thelbësore për mënjanim të dallimeve të padrejta të cilat ekzistojnë në botë dhe në vende të ndryshme, madje edhe në ato të zhvilluara⁴.

Në kuadër të Deklaratës nga Rio është miratuar edhe Parimi 10 me të cilin përkufizohet e drejta e publikut për qasje tek informatat lidhur me mjedisin jetësor, e drejta për pjesëmarrje të publikut gjatë miratimit të vendimeve lidhur me mjedisin jetësor dhe të drejtën për qasje në drejtësi. Parimi 10, përkatësisht Partneriteti për Parimin 10, paraqet bazë për miratim të Konventës së

2 Parliamentary Assembly, Future action to be taken by the Council of Europe in the field of environment protection <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-en.asp?FileID=16731&lang=en> [hapur më 22.4.2019 god.]

3 Zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit jetësor përmes dokumenteve të Kombeve të Bashkuara, botues Qendra e Gjellbër e Maqedonisë, 2008 f. 4, <https://civil.org.mk/wp-content/uploads/2013/05/djeklarazia.pdf> [hapur më 16.6.2019 god.]

4 Zhvillimi i qëndrueshëm i paradigëm globale, autore Margarita M. Matlievska, Monografi, Shkup 2011, f. 25 <https://www.academia.edu/2925222/> [hapur më 31.05.2019.]

Aarhusit - 1998 në konferencën e katër të ministrave: “Mjedisi jetësor për Evropën”, të mbajtur në Aarhus, Danimarkë, nën patronazh të Komisionit ekonomik për Evropën para Kombeve të Bashkuara.

Agjenda 21 paraqet konsensus global dhe shkallë të lartë të pajtimit politik për pamundësinë për ndarjes së zhvillimit dhe mjedisit jetësor. Për realizimin e saj, më përgjegjëse janë qeveritë, ndërsa me rëndësi prioritare janë strategjitë nacionale, politika, planet dhe programet. Agjenda 21 paraqet sistem komplet të ri të “ligjit”, i cili nisët nga shpallja e vlerave dhe arrin deri në realizim të qëllimeve specifike. Rrjedhimisht, Agjenda 21 nuk është e kufizuar me formulim të rregullave legale, por ajo i përgatit, i formon, jep instruksione, përkujdeset për zbatimin e tyre dhe e verifikon efektivitetin e tyre. Edhe më e rëndësishme është që Agjenda 21 në vete përmban edhe mekanizma për monitorim dhe zbatim të masave të cilat i propozon.

1.2.2.1 Konventa kornizë për ndryshime klimatike

Kjo Konventë ka filluar të nënshkruhet më 4 qershor 1992 në samitin e mbajtur në Rio de Zhaneiro, ndërsa ka hyrë në fuqi më 21 mars 1994⁵. Sipas Konventës, Qeveritë duhet të:

- grumbullojnë dhe ndajnë informata për emetimet e gazrave serë;
- vendosin strategji nacionale për zvogëlim të emetimit të gazrave serë dhe për adaptim të ndikimeve të pritura, duke përfshirë edhe dhënien e përkrahjes finaniare dhe teknologjike të vendeve në zhvillim;
- sigurojnë mbështetje në përgatitjet për adaptimet ndaj ndryshimeve klimatike.

Në dhjetor 1992, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, e formoi Komisionin për zhvillim të qëndrueshëm⁶ (UN Commission on Sustainable Development, CSD) si trup funksional ndërqeveritar i themeluar me qëllim të ndjekjes efektive të rekomandimeve dhe detyrimeve që kanë rezultuar nga Konferenca për mjedis jetësor dhe zhvillim. Komisioni përbëhet nga 53 anëtarë të cilët kanë mandat trevjeçar dhe i raporton Këshillit për ekonomi dhe punë sociale (ECOSOC). Komisioni është kompetent për ndjekje të progresit të zbatimit të Agjendës 21 dhe Planit për zbatim nga Johannesburg, në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar. Komisioni e vlerëson përparimin në bazë të raporteve nacionale të cilat vendet ia dërgojnë atij.

Dokument i rëndësishëm ndërkombëtar në të cilin konfirmohet angazhimi dhe premtimi për financim të zhvillimit është Konsensusi nga Monterej⁷ (Monterrey Consensus) që ka rezultuar nga Konferenca ndërkombëtare për financim të zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, të mbajtur në Monterej, Meksikë, më 18-22 mars 2002. I njëjti përmban 73 nene që kanë të bëjnë me vegla përkrahëse të zhvillimit, duke filluar nga ballafaqimi me sfidat për financim të zhvillimit, mobilizim të rrjedhave ndërkombëtare monetare, përsheptim të tregtisë ndërkombëtare si shtytës i zhvillimit, rritje të bashkëpunimit ndërkombëtar financiar dhe teknik për zhvillim, përmirësimin e koherencës dhe konsistencës së sistemeve ndërkombëtare monetare, fiskale dhe tregtare si përkrahje e zhvillimit.

5 Ligji për Ratifikim më 4 dhjetor 1997 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 61/97, ndërsa hyri në fuqi më 28 Prill 1998 http://www.zeleni.org.mk/fileadmin/user_upload/publications/Odrzliviot_Razvoj_i_Zivotnata_sredina_niz_dokumentite_na_UN.pdf [hapur më 04.06.2019.]

6 Margarita M. Matlievska, Zhvillimi i qëndrueshëm i paradigmes globale, Shkup 2011. Funksionet e Komisionit janë përcaktuar në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme nr. A/RES-47-191 me datë 27 dhjetor 1992 f. 33, <https://www.academia.edu/2925222/> [hapur më 04.06.2019.]

7 ibis

1.2.2.2 Dokumente që kanë rezultuar nga Samiti botëror për zhvillim të qëndrueshëm në Johannesburg

Në periudhën nga 26 gusht deri më 4 shtator 2002 në Johannesburg, Afrika Jugore, u mbajt Samit botëror për zhvillim të qëndrueshëm, WSSD), i cili paraqet edhe shënim të 10 vjetorit të Konferencës në Rio. Qëllimi themelor i Samiti ishte identifikimi i mekanizmave qartë të përcaktuar për zbatim të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel global, rajonal dhe veçanërisht në nivel nacional, konfirmim të përparimit të arritur në zbatimin e rekomandimeve dhe qëllimeve nga Agjenda 21 si dhe harmonizim të mënyrës së veprimit të mëtutjeshëm. Në Samit janë miratuar dy dokumente:

- (Politik) Deklaratë nga Johannesburgu; dhe
- Plani për zbatim nga Johannesburgu.

Me Deklaratën nga Johannesburgu, përfaqësuesit e kombeve të botës, ndër tjerash, e vërtetojnë përcaktimin e tyre për zhvillim të qëndrueshëm si dhe ndërtim të shoqërisë humane, të drejtë dhe me dashuri, të vetëdijshme për nevojën e dinjitetit njerëzor për të gjithë. Të bashkuar në përcaktimin e përbashkët për përpjekje me vendosmëri, popujt obligohen që në mënyrë pozitive do t'i përgjigjen nevojës për krijim të planit praktik dhe të qartë i cili do ta çrrënjosë varfërinë dhe do të sjellë zhvillim të njerëzimit.

Në Planin për zbatim, ndër të tjerat, fuqishëm konfirmohet përpjekja e përbashkët ndaj parimeve nga Rio dhe aplikim të plotë të Agjendës 21. Me këtë dokument harmonizohen qëllimet e dakordësuara ndërkombëtare për zhvillim, fuqizohet obligimi për t'u ndërmarrë veprime dhe masa konkrete në të gjitha nivelet dhe stimulohet bashkëpunimi ndërkombëtar. Në Planin për zbatim, parime themelore për arritje të zhvillimit të qëndrueshëm në dobi të të gjithëve janë paqja, stabiliteti, siguria dhe respektimi i shumëllojshmërisë kulturore, të drejtave të njeriut dhe liritë fundamentale, duke e përfshirë edhe të drejtën për zhvillim.

Në 20 vjetorin nga Deklarata e Rio de Zhaneiros, në bazë të Rezolutës së miratuar 64/236 në Asamblenë e Përgjithshme, në Rio de Zhaneiro është mbajtur Konferenca për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (UNCSD) e quajtur Rio+20 me qëllim të shoqërimit të shteteve, sektorit privat dhe publik dhe grupeve tjera të interesit në drejtim të zvogëlimit të varfërisë, avancim të barazisë sociale dhe sigurim të mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Qëllimi themelor i Rio+20 ishte sigurim i obligimit politik për zhvillim të qëndrueshëm, vlerësim të përparimit dhe tejkalim të nyjave ekzistuese në implementim të konkluzioneve nga mbledhjet kryesore për zhvillim të qëndrueshëm dhe adresim të sfidave të reja⁸. Në suaza të Rio+20 janë identifikuar 7 fusha për diskutim për të cilat duhet të kushtohet vëmendje e veçantë: puna e denjë, energjia, fushat e qëndrueshme, siguria e ushqimit dhe bujqësia e qëndrueshme, uji, oqeanet dhe përgatitja për katastrofa dhe fatkeqësi elementare.

1.2.2.3 Protokollin nga Kioto

Protokollin nga Kioto është dokument ndërkombëtar (me të cilin është zgjeruar Konventa Kornizë për ndryshime klimatike të Kombeve të Bashkuara nga viti 1992) që i obligon shtetet anëtare ta reduktojnë emetimin e gazrave serë. Konsiderohet si bashkëpunimi i parë dhe më i gjerë i vendeve nga tërë bota për çështjet e natyrës ekologjike. Ky Protokoll është miratuar në Kioto, Japoni, më 11 dhjetor 1997, ndërsa ka hyrë në fuqi më 16 shkurt 2005. Aktualisht ka 192 vende që e kanë nënshkruar Protokollin (Kanada është tërhequr nga Protokollin në vitin 2012). Protokollin nga Kioto e zbaton qëllimin e UNFCCC (Konventa kornizë për ndryshime klimatike të Kombeve të Bashkuara) me qëllim të zvogëlohet fillimi i ngrohjes globale nëpërmjet reduktimit të koncentracioneve të gazrave serë në atmosferë deri “në nivel që do të kishte parandaluar ndërhyrje antropogjene në sistemin klimatik” (neni 2 i Protokollit). Protokollin nga Kioto vlen për gjashtë gazrat me efekt të

⁸ E drejta për mjedis të pastër jetësor detyrim i çdo qytetari dhe kompanie – shqyrtim i menaxhimit me mbeturinat, botues Qendra për hulumtime dhe analiza juridike – QHAJ, dhjetor 2014, fq.3, <https://cpia.mk/> [hapur më 12.06.2019.]

serrave, të përmendura në Aneksin A: Dyoksid karboni (CO₂), Metan (CH₄), Oksid nitrik (N₂O), Hidroflourokarbonate, Perflorokarbonate (PFC) dhe Sulfuri heksaflorik (SF₆).

Në vitin 2012 është përcaktuar periudhë e dytë e obligimeve, e njohur si Amendamenti nga Doha, me të cilën parahihen: obligime të reja për palët nënshkruese të Protokollit nga Kioto për periudhën 2013 – 2020, nga çka qartë shihet që interesi për mbrojtje të mjedisit jetësor nëpërmjet reduktimit të gazrave serë është në nivelin më të lartë në komunitetin ndërkombëtar. Sipas Amendamentit nga Doha, 37 shtete kanë qëllime obliguese: Australia, BE (dhe 28 shtetet anëtare të saj), Bëlorusia, Islanda, Kazakistani, Lihtenstajni, Norvegjia, Zvicra dhe Ukraina. Japonia, Zelanda e Re dhe Rusia kanë marrë pjesë në periudhën e parë, mirëpo nuk kanë ndërmarrë qëllime të reja në periudhën e dytë të përkushtimit. Në maj të vitit 2019, 128 shtete e kanë pranuar Amendamentin nga Doha kurse hyrja në fuqi kërkon të pranohet nga 144 shtete.

Megjithëse marrëveshje globale, ky protokoll nuk parasheh dënime dhe sanksione tregtare për shtetet që e kanë ratifikuar, por nuk kanë arritur t'i reduktojnë emetimet e gazrave serë. Në anën tjetër, çdo shtet që e ka ratifikuar, mund lehtë të tërhiqet nga i njëjti, nevojitet vetëm të japë njoftim një vit paraprakisht.

Duke e pasur parasysh atë që periudha e dytë e obligimeve përfundon në vitin 2020, negociatat që janë mbajtur në kuadër të konferencave vjetore të UNFCCC për ndryshimet klimatike dhe masat, kanë rezultuar me miratim të Marrëveshjes së Parisit nga viti 2015, i cili është instrument i veçantë në kuadër të UNFCCC, në vend të Protokollit nga Kioto.

1.2.2.4 Konventa e Aarhusit

Konventa për qasje tek informatat, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, përgjithësisht e njohur si Konventë e Aarhusit, është nënshkruar më 25 qershor 1998 në qytetin danez Aarhus. Ka hyrë në fuqi më 30 tetor 2001. Duke filluar nga marsi i vitit 2014, konventën e kanë ratifikuar 47 palë, 46 shtete dhe Bashkimi Evropian (BE). Të gjitha shtetet të cilat e kanë ratifikuar janë nga Evropa dhe Azia Qendrore. Konventa paraqet obligim juridik për gjithë ato entitete që e kanë ratifikuar. BE ka filluar me implementimin e parimeve të Konventës në legjisllacionin e vet, veçanërisht në Direktivën Kornizë për ujëra (Direktiva 2000/60/KE). Lihtenshtajni dhe Monako e kanë nënshkruar Konventën, mirëpo nuk e kanë ratifikuar.

Konventa e Aarhusit është qasje që bazohet në të drejta: publiku edhe tani edhe në të ardhmen, ka të drejtë të di dhe të jeton në mjedis jetësor të shëndoshë. Konventa e Aarhusit i siguron publikut të drejta lidhur me qasjen tek informatat, pjesëmarrje të publikut dhe qasje në drejtësi, në proceset e vendimmarrjes të qeverive për çështje lidhur me mjedisin jetësor (lokale, nacionale dhe ndërkufitare). Kjo Konventë përqendrohet në raportin e ndërsjellë dhe ndërveprimet mes publikut dhe pushtetit shtetëror për çështje që e rregullojnë sferën e mjedisit jetësor.

Konventa e Aarhusit është marrëveshje multilaterale për mbrojtjen e mjedisit jetësor, e nëpërmjet saj rriten mundësitë e qytetarëve për qasje tek informatat për mjedisin jetësor dhe sigurohet procedurë transparente dhe e sigurt rregulluese. Kjo Konventë mundëson jo vetëm raport të ndërsjellë dhe të besueshëm ndërmjet shoqërisë qytetare dhe të qeverive, por edhe fuqizim të pozicionit të publikut dhe pjesëmarrjes së vet në procesin e vendimmarrjes, që shpie drejt shoqërive të ndërgjegjshme ekologjike. Secila Palë e Konventës ka për obligim t'i promovojë parimet të cilat i përmban ajo, si dhe të plotësojë raport nacional, gjithmonë duke pranuar procedurë konsultative dhe transparente.

Konventa mundëson qasje të publikut të bazuar në të drejta, duke u nisur nga e drejta që secili të jetë i informuar dhe të jetojë në mjedis jetësor të shëndoshë. Nacionet "opinione" dhe "publik i interesuar" përkufizohen në mënyrë që: të parët janë të gjithë aktorët e shoqërisë qytetare, ndërsa të dytët, janë ata persona ose organizata që janë të prekura apo të interesuara për vendimmarrje në lidhje me mjedisin jetësor (për shembull: OJQ për mjedis jetësor).

Në Konventë është respektuar parimi i mosdiskriminimit, ashtu që të gjitha informatat duhet të jenë të siguruara, pa marrë parasysh nacionalitetin apo shtetësinë e kërkuesit. Ngritja e vetëdijes për domethënien e mjedisit jetësor, por edhe promovimi i edukimit të opinionit për mjedisin jetësor janë dy elemente kyçe të cilave Konventa u jep rëndësi të madhe.

Konventa e Aarhusit bazohet në tre (3) shtylla:

*Shtylla e parë, **qasja tek informatat*** e garanton të drejtën që secili qytetarë të ketë qasje gjithëpërfshirëse dhe lehtë të arritshme tek informatat për mjedis jetësor. Autoritetet publike duhet t'i sigurojnë të gjitha informatat e dhura dhe të njëjtat t'i grumbullojnë dhe distributojnë me kohë dhe në mënyrë transparente. Ata mund të refuzojnë të bëjnë këtë vetëm në situata të caktuara, për shembull: në rast të mbrojtjes nacionale.

*Shtylla e dytë, **pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje*** parasheh që publiku duhet të jetë i njoftuar me të gjitha projektet relevante dhe duhet t'i mundësojë të merr pjesë në procesin e vendimmarrjes. Mundësia e këtyre i përforcon kapacitetet edhe të vendimmarrësve, për shkak se të njëjtit mund ta përdorin diturinë dhe ekspertizën e njerëzve nga sfera e mjedisit jetësor. Në atë mënyrë përmirësohet cilësia e vendimeve ekologjike, por edhe legjitimiteti procedural i procedurave gjatë miratimit të tyre, si dhe rezultatet e arritura.

Shtylla e tretë është thelbësore për këtë analizë dhe ka të bëjë me **qasjen në drejtësi**. Përkatesisht, publiku ka të drejtë për procedura gjyqësore dhe administrative në rastet kur shteti e shkel ose nuk e respekton ligjin për mjedis jetësor dhe parimet e Konventës.

Konventa e Aarhusit është "**proceduralizim i rregullores për mbrojtje të mjedisit jetësor**", ajo më tepër përqendrohet në përcaktim dhe numërim të procedurave, në vend të vendosjes së standardeve dhe përcaktim të rezultateve, duke u mundësuar palëve të kyçura të interpretojnë dhe zbatojnë Konventën në pajtim me sistemet dhe kushtet nacionale. Ky model është i përkryer për menaxhim në më tepër nivele.

Në anën tjetër, rreziku, që përfshin humbje të kohës dhe të resurseve të cilat ndryshe mund të investohen në përkufizim të rezultateve, Konventën e bën të paqartë, të dobët dhe të hapur për më shumë interpretime. Kritikata tjera të cilat e shënojnë faktin që trupat privat janë përjashtuar nga procedurat e detyrueshme të parapara me Konventën (Mejson, 2010). Gjithashtu, mund të debatohet nëse organizatat e përfshira joqeveritare i përfaqësojnë në mënyrë të vërtetë interesat e mjedisit jetësor, për shkak se qytetarët e rëndomtë shpesh herë nuk kanë mjete për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proceset. Dallimet relative ndërmjet pjesëmarrësve dhe pabarazitë në resurset e grupeve sociale gjithashtu sugjerojnë mundësi për mbrojtje të padrejtë dhe të pabarabartë të mjedisit jetësor.

Konventa e Aarhusit, në fakt i ka paraparë risitë në të drejtën ndërkombëtare ekologjike: i ka ndërlidhur të drejtat ekologjike me të drejtat e njeriut, i ka identifikuar obligimet ndaj gjeneratave të ardhshme, ka konstatuar që zhvillimi i qëndrueshëm mund të arrihet vetëm nëpërmjet inkuadrimin të të gjithë faktorëve, r ka lidhur përgjegjësinë e shteteve dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përqendrohet në ndërveprimin ndërmjet publikut dhe autoriteteve publike në kontekst demokratik. Me miratimin e kësaj Konvente, tash më qartë mund të vërehet synimi i komunitetit ndërkombëtar për involvim sa më të madh në garantimin e të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë në nivel ndërkombëtar, nacional dhe lokal.

1.2.2.5 Marrëveshja e Parisit⁹

Një nga marrëveshjet më të rëndësishme multilaterale nga sfera e mjedisit jetësor dhe fuqizim i përgjigjes globale ndaj rrezikut prej ndryshimeve klimatike është Marrëveshja e Parisit. Marrëveshja për ndryshime klimatike është miratuar më 12 dhjetor 2015 në Paris, Francë, në Samitin Global për ndryshimet klimatike në organizim të Kombeve të Bashkuara me qëllim të bashkimit të vendeve të botës në luftën kundër ndryshimeve klimatike nëpërmjet adaptimit të burimeve të gjelbra të energjisë, reduktimin e gazrave serë dhe zvogëlim të ngrohjes globale.

Aktivitet konkret që kërkohet nga shtetet është që ato të heqin dorë nga burimet e pa rinovueshme të energjisë (thëngjilli, nafta dhe gazi) dhe të përdorin burime të rinovueshme të energjisë (aerogeneratorë, panele solare, të përdorin hidroenergji dhe gjeotermale). Vendet në zhvillim, të cilat nuk mund të t'i arrijnë ato qëllime me forcat e tyre, duhet të jenë të përkrahura nga ana e vendeve më të zhvilluara.

Marrëveshja e Parisit ka për qëllim ta kufizojë ngrohjen globale në më pak se 2°C, mbi nivelet paraindustriale (prej viteve 1850-1900), deri në vitin 2100. Marrëveshja, gjithashtu, numëron më shumë qëllime rigjide për kufizim të rritjes së temperaturës në vetëm 1,5°C mbi nivelet para erës industriale. Marrëveshja parasheh edhe përkrahje të zmadhuar të vendeve në zhvillim në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe kërkon nga vendet e zhvilluara të sigurojnë edhe 100 miliardë dollarë në Fondin e Gjelbër klimatik.

Sipas Marrëveshjes, secili vend ka plan individual (apo “kontribute të përcaktuara nacionale”) për ballafaqim me emetimet (e veta) të gazrave serë. Kjo Marrëveshje ka për qëllim ta rritë aftësinë e vendeve nëpërmjet përforsimit të kapaciteteve për t'u ballafaquar me ndikimin e ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, vendeve në zhvillim dhe vendeve më të lëndueshme u mundëson përkrahje të zmadhuar financiare dhe përkrahje teknologjike, me çka do të përkrahen aktivitetet e tyre në pajtim me qëllimet nacionale.

Marrëveshja e Parisit më 22 prill 2016 (Dita e planetit Tokë) është hapur për firmosje në selinë e KB në Nju Jork. E njëjta ka hyrë në fuqi më 4 nëntor 2016, 30 ditë pas të ashtuquajturit “prag të dyfishtë” (ratifikim prej 55 vendeve që marrin pjesë me së paku 55% të emetimeve globale).

Sipas Kombeve të Bashkuara, Marrëveshja është “hibrid i dispozitave ligjore obligative dhe joobligative”, mirëpo nuk ka pasojë apo dënim të qartë për shtetet që nuk i plotësojnë qëllimet e vendosura. Ekspertët, krahas gjithçka vlerësojnë që asnjë vend nuk do të tërhiqet nga Marrëveshja e Parisit për shkak të presionit ndërkombëtar, kundërshtimit të qytetarëve të tyre dhe ekonomisë.¹⁰

Prej 196 vendeve të përfshira në negociata, që e kanë nënshkruar në fillim, Marrëveshjen deri më sot e kanë ratifikuar 181 palë (shtete)¹¹.

Konventa ka një Protokoll –Protokolli i Kievit për regjistra për lirim dhe transfer të ndotësve i cili është miratuar në takimin e jashtëzakonshëm të palëve më 21 maj 2003, Në Kiev, Ukrainë. Protokollin e kanë nënshkruar 36 shtete dhe Bashkimi Evropian.

Protokolli i Kievit është instrumenti i parë obligues juridik ndërkombëtar për regjistër të ndotësve dhe transfer të ndotësve (PRTRs).

Konventa e UNECE-s për qasje tek informatat, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasja në drejtësi lidhur me çështjet për mjedis jetësor (Konventa e Aarhusit) bëhet shembull për aplikim të konceptit të “demokracisë ekologjike” në Parimin 10 të deklaratës nga Rio për mjedis jetësor dhe zhvillim.

9 Marrëveshja e Parisit për ndryshime klimatike, në fuqi nga 4 nëntor 2016, https://unfccc.int/files/meetings/paris_nov_2015/application/pdf/paris_agreement_english.pdf [hapur më 13.05.2019]

10 J. Majr/rtr/afp, Çfarë sjell marrëveshja e Parisit për klimën? e publikuar nga DW më 13.12.2015, <https://p.dw.com/p/1HMg4> [hapur më 22.04.2019]

11 United Nation, Climate Change, What is the Paris Agreement, <https://unfccc.int/process/the-paris-agreement/what-is-the-paris-agreement-0> [hapur më 06.05.2019]

Konventa tregon si demokracia ekologjike mund ta promovojë transparencën dhe bashkëpunimin ndërkombëtar dhe si kjo mund të ndihmon në menaxhimin ekologjik me resurset. Konventa i ka vendosur themelet për shoqëri paqësore, inkluzive dhe të drejtë. Përkushtimi i fortë i Palëve të Konventës së Aarhusit për promovim të demokracisë ekologjike në kontekst të realizimit të Agjendës për zhvillim të qëndrueshëm nga viti 2030 është konfirmuar me Deklaratën në Budvë. Sot Konventa e Aarhusit është pjesë e legjislacionit të 47 palëve, nga të cilat 46 shtete dhe BE-ja.

1.2.2.6 Konventa tjera të Kombeve të Bashkuara në lidhje me mjedisin jetësor

Konventa për llojshmëri biologjike - CBD (e hapur për nënshkrim në Samitin në Rio de Zhaneiro) është ratifikuar me Ligj për ratifikim ("Gazetar zyrtare e RM-së" 54/97), ka hyrë në fuqi më vitin 1998. Kjo Konventë për herë të parë në të drejtën ndërkombëtare e përkufizon mbrojtjen e llojshmërisë biologjike si obligim të përbashkët të gjithë njerëzimit. Ajo i mbulon të gjitha eko-sistemet, llojet dhe resurset gjenetike dhe i ndërlidh përpjekjet tradicionale për mbrojtje me qëllimet ekonomike të shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve biologjike dhe i përcakton parimet për ndarje të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve nga shfrytëzimi i resurseve gjenetike. Vendimmarrësve, Konventa u sjell udhëzime të bazuara në parimin e kujdesit, sipas të cilit mosekzistenca e provave të plota shkencore nuk duhet të jetë justifikim për prolongim të masave për parandalim apo minimizim të rreziqeve nga reduktimi i diversitetit biologjik.

Konventa për luftë kundër shkretërimit - UNCCD, është miratuar më 17 qershor 1994 në Paris, ndërsa ka hyrë në fuqi më 26 dhjetor 1996. Në R. e Maqedonisë së V., Konventa është ratifikuar më vitin 2002 ("Gazeta Z. e RM-së" 13/02). Qëllimi i Konventës është të parandalohet përhapja e shkretëtirave dhe të zbuten efektet e thatësirave në zonat më të goditura të cilat ballafaqohen me thatësi dhe shkretërim, me theks të veçantë në territorin e Afrikës.

1.2.3. Zhvillim i kornizës juridike për qasje në drejtësi dhe ndihmë juridike falas në kuadër të Kombeve të Bashkuara

1.2.3.1 Deklarata universale për të drejtat e njeriut

Më 10 dhjetor 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e miratoi dhe e shpalli Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut. Ky akt historik i Asamblesë u bëri thirrje të gjitha vendeve anëtare që të publikojnë tekstin e Deklaratës për të nxitur distribuimin, prezantimin e saj dhe të lexohet kryesisht në shkollat dhe institucionet e tjera arsimore, pavarësisht statusi politik të shteteve apo territoreve. Është miratuar dhe proklamuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme me Rezolutën 217 A (III) nga 10 dhjetori 1948.

Asambleja e Përgjithshme e proklamoi Deklaratën universale për të drejtat e njeriut si një standard të përgjithshëm për t'u arritur, për të gjithë popujt dhe kombet. Megjithëse nuk ka karakter obligues, kjo Deklaratë është përgjithësisht e pranuar nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe paraqet themel të konventave të shumta ndërkombëtare dhe të marrëveshjeve juridike të cilat kanë karakter obligues. Deklarata në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë është e inkorporuar në kushtetutat e shteteve të cilat synojnë mbrojtjen dhe garantim të të drejtave të njeriut.

Parimi i mosdiskriminimit gjatë realizimit të të drejtave për herë të parë është vendosur me Deklaratën universale e OKB-së për të drejtat e njeriut, e miratuar në vitin 1948, ndërsa më tutje e përpunuar në: Traktatin ndërkombëtar për liri dhe të drejta qytetare dhe politike (TNLQP), Traktatin për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore (TDESK), Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (KEDR), Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të femrës (KEDF) Konventën për të drejtat e fëmijëve (KDF), Konventën për të drejtat e personave me pengesa (KDPP) si dhe Konventat e organizatës ndërkombëtare të punës (ONP). Me këto dokumente themelore garantimi i të drejtës për barazi dhe eliminimi i çfarëdo forme të diskriminimit është shpallur si standardi më i lartë në korpusin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Në nenin 1 të Deklaratës qartë është përmendur që të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe me dinjitet dhe të drejta të barabarta. Ata posedojnë logjikë dhe vetëdije dhe duhet të veprojnë nëri ndaj tjetrit në frymën e përkatësisë së përgjithshme njerëzore. Në nenin 2 theksohet që të gjitha të drejtat dhe liritë e numëruara në këtë Deklaratë u përkasin të gjithë njerëzve pavarësisht dallimet e tyre, siç janë: raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, gjuha, religjioni, bindja politike dhe tjera, prejardhja nacionale ose shoqërore, pronësia, lindja apo status tjetër. Në Deklaratë, ndër tjerash theksohet që secili ka të drejtë për jetë, liri dhe siguri të personit (Neni 3 i Deklaratës), askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit apo dënimit mizor, jonjerëzor apo nënçmues. Secili ka të drejtë që në çdo vend të njihet dhe pranohet si person para ligjit. Të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim, për mbrojtje të barabartë me ligj. Sipas nenit 7, të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit dhe të gjithëve u takon, pa asnjë diskriminim, mbrojtje e barabartë para ligjit. Të gjithëve u përket mbrojtje e barabartë nga cili do diskriminim që është në kundërshtim me këtë Deklaratë dhe nga çfarë do stimulim të diskriminimit të tillë. Secili ka të drejtë që gjykatat nacionale ta mbrojnë mënyrë efektive nga shkelja e të drejtave themelore të cilat i janë garantuar me kushtetutë dhe me ligjet (Neni 8).

Deklaratë në suaza të këtij teksti normativ përcakton më shumë të drejta të cilat njeriut i garantojnë të drejtë për qasje në drejtësi, mirëpo fillimisht nënkuptohen dy kushtet në të cilat njeriu mund të shfrytëzojë të drejtën e vet për ndihmë juridike në Traktatin Ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike: së pari, nëse nuk ka mjaftueshëm mjete me të cilat do ta sigurojë përfaqësimin juridik dhe së dyti, kur plotësimi i kësaj të drejte është në interes të drejtësisë. Përkatësisht në Nenin 7 proklamohen parimet e barazisë para ligjit, mbrojtje e barabartë me ligj dhe barazi gjatë zbatimit të ligjit. Me interpretimin e këtillë të barazisë si parim, nënkuptohet roli aktiv i shtetit dhe masat e aksionit afirmativ, që është qartë i përcaktuar në marrëveshjet ndërkombëtare të cilat vijojnë më pas.

Duke e lexuar tekstin e Deklaratës universale për të drejtat e njeriut, në përmbajtjen e saj askund nuk do të haset e drejtë eksplicite për mjedis jetësor të shëndoshë. Kjo e drejtë nënkuptohet me nenin 3 të Deklaratës, sepse është ngushtë e lidhur me të drejtën për jetë, liri dhe siguri të personit. Së këtejmi, tërthorazi janë rregulluar të drejtat nga sfera e mjedisit jetësor, për shkak se ndotja e mjedisit jetësor drejtpërsëdrejti e rrezikon jetën, shëndetin dhe sigurinë e njeriut. Për t'u mbrojtur e drejta për mjedis të shëndoshë jetësor, nevojitet qasje në drejtësi për secilin qytetar të cilit kjo e drejtë i është shkelur. Secili ka të drejtë të njihet si subjekt juridik para ligjit (neni 6), kurse veçanërisht është e rëndësishme se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë, pa asnjë diskriminim, për mbrojtje të barabartë para ligjit (neni 7). Neni i fundit u mundëson qytetarëve të cilëve u është shkelur e drejta apo u është rrezikuar e drejta për mjedis jetësor të shëndoshë të mund të kërkojnë mbrojtje të të drejtës në formë institucionale, pavarësisht gjendjen e tyre pronësore. Qasja në drejtësi duhet të jetë e garantuar për të gjithë, duke i përfshirë njerëzit që janë në gjendje të vështirë financiare. Ndalesa për diskriminim si bazë e ka parasysh, ndër tjerash edhe gjendjen pronësore që nuk mund të jetë kusht për qasje në drejtësi. Si rrjedhojë, secili ka të drejtë që gjykatat nacionale ta mbrojnë në mënyrë efektive nga shkelja e të drejtave themelore të cilat i ka të garantuara me kushtetutë dhe me ligje (neni 8 i Deklaratës). Në shtetin tonë e drejta themelore e garantuar me Kushtetutë dhe ligje, ndër tjerash është edhe e drejta për mjedis të shëndoshë jetësor. Për këtë arsye, secilin qytetar duhet t'i mundësohet dhe garantohet qasje efektive në drejtësi, në rastet kur kjo e drejtë themelore është rrezikuar apo është shkelur.

1.2.3.2 Traktati ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike dhe Traktati ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore

Për dallim nga Deklarata universale për të drejta të njeriut, Dokumentet juridiko-ndërkombëtare të OKB-së janë me karakter obligues, përkatësisht autoritetet administrative dhe gjyqësore janë të obliguar t'i aplikojnë drejtpërsëdrejti. Mbrojtja më e gjerë është siguruar me Traktatin ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike (1966) dhe Traktati ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore (1996). Traktati ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike përmban një pako me më shumë të drejta: e drejta për jetë (si e drejta më themelore e njeriut), e drejta për liri dhe siguri, e drejta për gjykim të drejtë dhe tjera.

Me këtë dokument sërish vihet theksi në parimin e barazisë dhe të drejtën për mjet juridik efektiv në rast të mosrespektimit të të drejtave. Në nenin 2 të Traktatit ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike (1966) garantohet e drejta e të gjithë personave që gjenden në territorin e shtetit anëtar, për respektimin e të drejtave që njihen me këtë traktat pavarësisht racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, religjionin, mendimin politik ose tjetër, prejardhjen nacionale ose sociale, gjendjen pronësore, lindjen ose rrethanë tjetër. Më tutje, rregullohet e drejta e secilit person të përdor mjet juridik efikas dhe të sigurojë zbatim në bazë të procedurës për mjet juridik. Në nenin 3, rregullohet e drejta e barabartë e meshkujve dhe grave, t'i gëzojnë të gjitha të drejtat qytetare dhe politike të këtij traktati. Kjo nënkupton angazhim aktiv të shtetit për vendosje të parimit të barazisë së palëve para organeve gjyqësore dhe administrative të shtetit, që nuk do të jetë vetëm formalisht.

Neni 6 i Traktatit ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike¹² e njeh dhe mbron të drejtën për jetë të të gjithë njerëzve. E drejta për jetë ka domethënie kyçe edhe për individët edhe për shoqërinë në tërësi. Kjo e drejtë është më e vlefshme dhe e trashëgon çdo qenie njerëzore, për shkak se është e pandashme nga personaliteti njerëzor. Ka domethënie fundamentale dhe mbrojtja e saj efektive është parakusht për t'i gëzuar të gjitha të drejtat e tjera. E drejta për jetë është e drejtë që nuk interpretohet ngushtë, por në kuptimin e saj më të gjerë. Paragrafi (1) nga neni 6 i Traktatit parasheh që askush nuk guxon të privohet nga jeta me vullnet diskret dhe që kjo e drejtë është e mbrojtur me ligj. Kjo paraqet obligim për shtetet ta respektojnë dhe ta garantojnë të drejtën për jetë, nëpërmjet masave legjislative dhe të tjera si dhe të sigurojnë mjete juridike efikase dhe mbrojtjen e kësaj të drejte.

Vërejtje e përgjithshme – komenti numër 32 i Komitetit për të drejtat e njeriut në pjesën V: Raporti i nenit 6 me nenet tjera të Traktatit dhe regjimet tjera juridike, në pikën 62 thekson që: Degradimi i mjedisit jetësor, ndryshimet klimatike dhe zhvillimi i paqëndrueshëm janë një nga kërcënimet më serioze për të drejtën për jetë të gjeneratave të tashme dhe të ardhshme. Detyrë për shtetet anëtare është ta respektojnë të drejtën ndërkombëtare për mjedis jetësor, si dhe ta respektojnë të drejtën për jetë të secilit në pajtim me këtë legjislacion.

Zbatimi i obligimit të respektohet dhe garantohet e drejta për jetë, e veçanërisht për jetë të denjë, ndër tjerash varet nga masat e ndërmarra nga shtetet anëtare për ruajtje të mjedisit jetësor dhe për mbrojtjen e të njëjtave nga dëmet, ndotja dhe ndryshimet klimatike të shkaktuara nga subjekte publike dhe private. Për ato shkaqe, shtetet anëtare duhet të sigurojnë shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore, zhvillim dhe zbatim të standardeve thelbësore ekologjike, zbatim të vlerësimeve të ndikimit mbi mjedisin jetësor. Ekziston obligim për shtetet të konsultohen me shtete tjera relevante për aktivitete të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi mjedisin jetësor, të sigurojnë raportim për shtetet tjera të interesuara për fatkeqësi natyrore dhe raste urgjente kur është i domosdoshëm bashkëpunim i ndërsjellë. Gjithashtu, sigurojnë qasje adekuate tek informatat për rreziqe për mjedisin jetësor dhe përkushtojnë vëmendje të mjaftueshme në parimin e kujdesit.¹³

¹² Traktati ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike, OKB, 1976, e hapur më: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CCPR.aspx> [e hapur më 18 prill 2017]

¹³ *Komenti i përgjithshëm numër 36 (2018) për nenin 6 nga Traktati ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike, për të drejtën për jetë*, https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CCPR/Shared%20Documents/1_Global/CCPR_C_GC_36_8785_E.pdf [hapur më 05.06.2019]

Në nenin 26 të Traktatit ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike, parashihet e drejtë e veçantë për barazi para ligjit dhe mosdiskriminim në aspekt të të drejtave dhe obligimeve të garantuara që i kanë shtetet. Kjo dispozitë ka të bëjë me të gjitha të drejtat të cilat shteti në legjislacionin e vet ua pranon individëve në territorin e saj apo nën jurisprudencë të saj, e drejtë në të cilën individ mund të thirret edhe për situata të caktuara, përkatësisht të drejta të cilat nuk janë lëndë e drejtpërdrejtë e kësaj konvente, nëse konstatohet që ato janë diskriminuese.

Traktati ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (1966) në nenin 2 paragrafi (2) dhe nenin 3 garantojnë të drejta të barabarta të meshkujve dhe grave për t'i gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

1.2.3.3. Parime dhe udhëzime të OKB-së për qasje te ndihma juridike falas

Më 20 dhjetor 2012, Asambleja e Përgjithshme pranë OKB-së, e miratoi dokumentin e parë ndërkombëtar në lidhje me dhënien e ndihmës juridike falas apo Parime dhe udhëzime të OKB-së për qasje në ndihmë juridike falas, ku janë përfshirë standarde globale për ndihmë juridike falas, për shkak të të cilave OKB u bën apel shteteve t'i miratojnë dhe ta fuqizojnë dhe promovojnë efektivitetin e ndihmës juridike falas. Parimi i parë i cili është pjesë e dokumentit nga 20 dhjetori i vitit 2012 është si vijon:

“Njohja e ndihmës juridike duhet të jetë element esencial në funksionimin e sistemit juridik, që bazohet në sundimin e të drejtës si bazë për t'i gëzuar të gjitha të drejtat e njeriut, ndër të cilat edhe të drejtën për gjykim të drejtë. Si rojtar i rëndësishëm i cili i garanton kushte themelore të drejta dhe besimin publik në sistemin juridik, shteti duhet ta garantojë të drejtën për ndihmë juridike në kuadër të sistemit nacional legjislativ në nivelin më të lartë të mundur, duke e përfshirë edhe Kushtetutën – nëse është e nevojshme.“

1.2.3.4. Konventa për qasje ndërkombëtare në drejtësi

Konventa për qasje ndërkombëtare në drejtësi është nënshkruar më 25 tetor 1980 në Hagë, nga ana e shteteve anëtare¹⁴ në Konferencën e Hagës për të drejtën ndërkombëtare private¹⁵. Konventa është dokumenti i parë ndërkombëtar me të cilin më në detaje është përfshirë problematika e rregullimit të së drejtës për qasje në drejtësi dhe mbrojtja e saj gjyqësore dhe mbrojtje tjetër në nivel botëror, me ç'rast ajo është e mbrojtur si e drejtë e të gjitha shtetasve apo personave me qëndrim të rregulluar në shtetin përkatës, që është nënshkruer i Konventës, por edhe në të cilën cili do shtet-nënshkruer të Konventës në të cilin do të fillojë ose ka filluar ndonjë procedurë gjyqësore. Do të thotë, qëllimi i Konventës nuk është t'i harmonizojë legjislacionet nacionale, por të sigurojë që statusi i shtetasit të huaj apo mospasje vendbanim apo vendqëndrim në shtet nuk do të jetë bazë për diskriminim gjatë qasjes në drejtësi.

Shtetas i cilit do shtet kontraktues, si dhe persona me vendbanim të përhershëm në cilin do nga vendet kontraktuese, ka(në) të drejtë për ndihmë juridike në procedurë gjyqësore që ka të bën me konteste qytetare dhe tregtare në cilin do nga vendet nënshkruese, me të njëjtat kushte sikur të jenë shtetas të atij shteti. Në shtetet ku ndihma juridike është siguruar në çështje administrative, sociale dhe fiskale, dispozitat e kësaj Konvente do të aplikohen vetëm për rastet që kanë ekzistuar paraprakisht, para paraqitjes në gjykata dhe tribunalet kompetente për punë të tilla¹⁶.

14 Konferenca e Hagës për të drejtën ndërkombëtare private ka 68 shtete anëtare nga e gjithë bota, ndër të cilat edhe Republika e Maqedonisë së Veriut, <http://88.85.126.176/PregledNaZakon.aspx?id=15357> [hapur më 06.05.2019]

15 Më hollësisht për Konferencën e Hagës për të drejtën ndërkombëtare private dhe për tekstin integral të Konventës në <https://www.hcch.net/> [hapur më 12.06.2019]

16 Konventë për qasje ndërkombëtare në drejtësi 1, <https://assets.hcch.net/docs/a311a685-d6e7-41d4-8210-7c2b8c30429e.pdf> [hapur më 05.06.2019]

1.2.3.5 Të drejta të njeriut, qasje në drejtësi dhe mjedisi jetësor

Ndryshimet klimatike janë një nga kanosjet më të mëdha për të drejtat e njeriut të gjeneratës sonë dhe paraqesin rrezik serioz për të drejtat themelore për jetë, shëndet, ushqim dhe standard adekuat jetësor të individëve dhe bashkësive nëpër botë.

Sipas Komisarit të lartë pranë Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut dhe mbrojtje të mjedisit jetësor¹⁷:

Mjedisi jetësor si parakusht për të gëzuar të drejtat e njeriut (obligimet për të drejtat e njeriut në shtetet duhet ta përfshijnë edhe obligimin për të siguruar nivel të mbrojtjes së mjedisit jetësor, që është i domosdoshëm për t'u mundësuar zbatim i plotë i të drejtave të mbrojtura);

Të drejta të caktuara, veçanërisht qasja tek informatat, pjesëmarrja në vendimmarrje dhe qasja në drejtësi lidhur me çështje që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, si themelore për miratim të vendimeve lidhur me mjedisin jetësor (duhet të zbatohen të drejtat e njeriut për t'u siguruar mbrojtje e mjedisit jetësor); dhe e drejta për mjedis të balancuar të sigurt, të shëndoshë dhe ekologjik si e drejtë e njeriut në vete.

Deklaratë e Stokholmit, e në masë më të vogël edhe Deklarata nga Rio, tregojnë që lidhja ndërmjet të drejtave të njeriut dhe dinjitetit dhe mjedisit jetësor ka qenë konsiderueshëm e theksuar në fazat e hershme të përpjekjeve të Kombeve të Bashkuara për zgjidhje të problemeve ekologjike.

Trupa të ndryshëm të OKB-së kanë bërë thirrje për zgjidhje të çështjeve lidhur me të drejtat e njeriut dhe mjedisin jetësor. Komisioni për të drejta të njeriut (tani i transformuar në Këshill për të drejta të njeriut) me Rezolutën 2005/60 kërkon nga Komisari i Lartë dhe i bën thirrje UNEP-it, UNDP-së dhe trupave dhe organizatave tjera relevante, në suaza të mandateve të tyre dhe programeve të miratuara për punë dhe buxhete: *“të vazhdojnë t'i koordinojnë përpjekjet e tyre në aktivitetet lidhur me të drejtat e njeriut dhe mjedisin jetësor në çrrënjosjen e varfërisë, vlerësim dhe rehabilitim ekologjik post-konflikt, parandalim të katastrofave, vlerësim dhe rehabilitim pas katastrofave, t'i marrin parasysh konstatimet dhe rekomandimet relevante të të tjerëve në punën e tyre dhe të shmanget puna e dyfishtë”* (paragrafi 8).

1.3. Zhvillim i politikave rajonale dhe legjislacionit

1.3.1. Politika dhe legjislacioni në kuadër të Këshillit të Evropës

Këshilli i Evropës¹⁸ është organizata më e vjetër ndërkombëtare politike dhe paraqet organizatë udhëheqëse për të drejtat e njeriut në Evropë. Detyra themelore e Këshillit të Evropës është të krijohet sferë e përbashkët demokratike dhe juridike nëpër gjithë kontinentin, me çka do të sigurohet respektim i vlerave themelore: të drejtat e njeriut, demokracia dhe sundimi i të drejtës. I themeluar më 4 maj 1949 me Kushtetutë, në Londër, Këshilli numëron 47 vende anëtare, 1 vend kandidat – Bjellorusia dhe 5 vende vëzhgues. Nga vendet nënshkruese, 28 janë anëtare të Bashkimit Evropian.

Me Marrëveshjen e Londrës nga viti 1949, janë themeluar dy organe të Këshillit të Evropës nga të cilët njëri është i llojit parlamentar (Asamble Parlamentare), ndërsa tjetri është i tipit ndërqeveritar (Komiteti i ministrave).¹⁹

Asambleja Parlamentare përbëhet nga 324 deputetë prej 47 vendeve anëtare; Asambleja e zgjedh Sekretarin e Përgjithshëm, Komisarin për të drejta të njeriut dhe gjyqtarët e Gjykatës evropiane

17 E ndërmarrë nga ueb faqja e Raportuesit para KB për të drejtat e njeriut dhe mjedis jetësor <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Environment/SREnvironment/Pages/SREnvironmentIndex.aspx> [është ndërmarrë më

18 Këshilli i Evropës është institucion tjetër nga Këshilli i Bashkimit Evropian apo Këshilli evropian, për shkak se ato janë institucione të Bashkimit Evropian.

19 Zhan Klod Gotron, Institute publiko-juridike të së drejtës romake të recipuara në sistemet e sotme juridike, E Drejta Evropiane, Shkup 2006, <http://eprints.ugd.edu.mk/9927/1/Magisterska%20teza.pdf> [hapur më: 21.06.2019]

për të drejtat e njeriut; siguron forum për debate dhe i ndjek zgjedhjet; komisionet e saj luajnë rol të rëndësishëm në shqyrtimin e çështjeve aktuale.²⁰

Komiteti i ministrave është trup i angazhuar për të sjell vendime të Këshillit të Evropës. Roli dhe funksionet e tij janë gjerësisht të përkufizuara në Kapitullin IV të Statutit. Ai përbëhet nga ministra për punë të jashtme të vendeve anëtare. Komiteti takohet një herë në vit, ndërsa në nivel të zëvendësve (përfaqësues të përhershëm të Këshillit të Evropës) një herë në javë. Mbjajta e takimeve është rregulluar me Statut dhe Rregullore. Zëvendës ministrave iu ndihmojnë Byro, grupe raportuese koordinatorë tematike dhe ad hoc grupe punuese.²¹

Komiteti drejtues për të drejtat e njeriut (CDDH) është trup i cili referohet në Komitetin e ministrave të Këshillit të Evropës. Ekspertët tjerë, veçanërisht përfaqësuesit e shoqërisë qytetare, marrin pjesë edhe në këto takime. Nën kompetencë të Komitetit të ministrave dhe duke i pasur parasysh standardet juridike të Këshillit të Evropës, si praktikë relevante gjyqësore për të drejta të njeriut, CDDH e zbaton punën e Këshillit të Evropës në sferën e të drejtave të njeriut, këshillon dhe jep ekspertizë juridike për Komitetin e ministrave për të gjitha çështjet nën kompetencë të vet.²²

1.3.1.1 Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive të njeriut

Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (e miratuar në Romë, 4 nëntor 1950) është gurrthemel i sistemit për të drejtat dhe liritë e njeriut paraqet Konventë evropiane për të drejta të njeriut. E njëjta ndërlidhet me Deklaratën universale për të drejtat e njeriut, të cilën Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e miratoi më 10 dhjetor 1948, me qëllim që qeveritë e të gjitha vendeve, me të njëjta synime dhe trashëgimi të përbashkët të idealeve dhe traditave politike, respektim të lirisë dhe sundimit të së drejtës, t'i bëjnë hapat e parë me vendosmëri për garantimin e të drejtave të caktuara të përkufizuara në Deklaratën universale. Konventa paraqet marrëveshje ndërkombëtare, me diapazon të paparë deri më tani me të cilin shtetet anëtare të Këshillit të Evropës premtojnë që do t'i garantojnë të drejtat themelore qytetare dhe politike, jo vetëm për qytetarët e tyre, por edhe të secilit që është pjesë e jurisprudencës së tyre.

Në Pjesën I të Konventës (neni 2-19) është paraqitur listë e të drejtave dhe lirive të njeriut, respektimi i të cilave është siguruar përfundimisht nga ana e Gjykatës evropiane për të drejta të njeriut. Konventa veçanërisht i garanton: e drejta për jetë, e drejta për procedurë të drejtë gjyqësore, e drejta për respektim të jetës private dhe familjare, liri e të menduarit, vetëdije dhe religjion, liria e të shprehurit, liria për tubim dhe shoqërim dhe mbrojtje e pronës. Krahas kësaj, mbrojtje e posaçme sigurohet nga: tortura dhe sjellja apo ndëshkimi jonjerëzor dhe degradues, skllavëri dhe punë të detyruar, parburgim në bazë të vullnetit diskret dhe në mënyrë të paligjshme dhe diskriminim në realizimin e të drejtave dhe lirive të cilat janë përcaktuar me Konventën.

Vështruar nga aspekti i të drejtës për mjedis jetësor, megjithëse kjo nuk është theksuar në mënyrë eksplicite në Deklaratë, e njëjta mund të shihet nëpërmjet neneve të caktuara nga e njëjta, në kuptim të aspekteve në vijim:

Në pajtim me pjesën 1 të titulluar “Liri dhe të drejta” në nenin 2 paragrafi (1) i Konventës është përcaktuar në mënyrë konkrete që e drejta për jetë e secilit njeri është e mbrojtur me ligj. Në shtetin tonë e drejta për jetë është e drejtë e garantuar me kushtetutë. Në anën tjetër, gjatë çrregullimit të mjedisit jetësor ekziston rrezik mbi shëndetin, por edhe mbi jetën e njeriut.

²⁰ Concul of Europe, <https://www.coe.int/en/web/about-us/structure> [hapur më 07.05.2019]

²¹ Concul of Europe, Convention on Civil Liability for Damage resulting from Activities Dangerous to the Environment, Lugano, 21/06/1993 - Treaty open for signature by the member States, the non-member States which have participated in its elaboration and by the European Union, and for accession by other non-member States: <https://www.coe.int/en/web/cm> [hapur më 28.05.2019]

²² Concul of Europe, Convention on Civil Liability for Damage resulting from Activities Dangerous to the Environment, Lugano, 21/06/1993 - Treaty open for signature by the member States, the non-member States which have participated in its elaboration and by the European Union, and for accession by other non-member States: <https://www.coe.int/en/web/human-rights-intergovernmental-cooperation/human-rights-development-cddh> [hapur më 22.04.25.04]

Neni i përmendur nga Deklarata është relevant dhe ndër tjerash, e përfshin mjedisin jetësor, megjithëse tërthorazi. Në anën tjetër, neni 6 paragrafi (1) i Deklaratës, gjithashtu i garantuar me kushtetutën e shtetit tonë, e garanton të drejtën për procedurë të drejtë gjyqësore në mënyrë që: “Secili ka të drejtë në mënyrë të drejtë dhe publike, në afat të pranueshëm kohor para gjyqit të pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj t’i shqyrtohen dhe përcaktohen të drejtat dhe obligimet qytetare ose baza e çfarëdo akuze penale kundër tij.”

Aktgjykimi shqiptohet publikisht ndërsa gazetarët mund të jenë të përjashtuar nga e tërë procedura apo një pjesë të saj në interes të moralit, rendit publik ose të sigurisë nacionale në shoqëri demokratike, kur këtë e kërkojnë interesat e ndonjë të mituri apo mbrojtja e jetës private të palëve në kontest, ose kur gjykata këtë e konsideron si të domosdoshme për shkak se në rrethana të veçanta publiciteti mund t’iu shkaktojë dëm interesave të drejtësisë.

Së këtejmi, çdo qytetar të cilit i është pezulluar, cenuar apo në mënyrë tjetër i është shkelur e drejta për mjedis jetësor të shëndoshë ka të drejtë, ndër tjerash të kërkojë mbrojtje gjyqësore për të drejtën e vet para gjykatës së pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj.

Neni 8 i Deklaratës e garanton të drejtën e secilit person për respektim të jetës së tij private dhe familjare, shtëpinë dhe dokumentin. Autoriteti publik nuk guxon të ndikon në realizimin e kësaj të drejte, përveç në rastet kur ndikimi është paraparë me ligj dhe paraqet masë e cila është në interes të sigurisë shtetërore dhe publike, mirëqenies ekonomike, mbrojtjes së rendit dhe parandalimit të veprave penale, mbrojtjes së shëndetit dhe moralit, ose mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve, në një shoqëri demokratike.

Nenet 13 dhe 14 gjithashtu janë relevante dhe të zbatueshme për çështje nga sfera e mjedisit jetësor, ashtu që secili person, të drejtat dhe liritë e të cilit janë të identifikuara me këtë Konventë, i janë shkelur, ka të drejtë për ankesë para autoriteteve nacionale, madje edhe atëherë kur shkeljen e këtyre të drejtave dhe lirive e kanë bërë persona gjatë kryerjes së detyrës. Neni 14 e ndalon diskriminimin: “Gëzimi i të drejtave dhe lirive, të validizuara me Konventën, duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në gjini, racë, ngjyrë të lëkurës, gjuhë, religjion, mendim politik ose çfarë do tjetër, prejardhje nacionale apo sociale, përkatësi në ndonjë pakicë nacionale, pozitë materiale, origjinë nga lindja apo çfarë do statusi tjetër”.²³

²³ Konventë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, Romë 4 nëntor 1950 neni 14, https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf [hapur më 13.05.2019]

NENI 2²⁴

E drejta për jetë

1. E drejta e secilit njeri për jetë është e mbrojtur me ligj. Askush nuk mund të privohet qëllimisht nga jeta, përveç me ekzekutim të dënimit me vdekje, të shqiptuar me aktgjykim gjyqësor, me të cilin është shpallur fajtor për vepër penale e cila, sipas ligjit, është e ndëshkueshme me dënim të tillë.
2. Vlerësohet që dispozitat e këtij neni nuk janë shkelur nëse vdekja ka ndodhur si rezultat i përdorimit absolutisht të nevojshëm të forcës:
 - a. në mbrojtje të secilit individ nga dhuna e paligjshme;
 - b. gjatë arrestimit sipas ligjit apo parandalim të arratisjes së personit të arrestuar në bazë të ligjit;
 - c. gjatë parandalimit ligjor të trazirës apo rebelimit.

NENI 8

E drejtë e respektimit të jetës private dhe familjare

1. Secili njeri ka të drejtën t'i respektohet jeta private dhe familjare, shtëpia dhe korrespondenca.
2. Autoriteti publik nuk guxon të ndërhyrë në realizimin e kësaj të drejte, përveç nëse ajo ndërhyrje është paraparë me ligj dhe nëse paraqet masë e cila është në interes të sigurisë shtetërore dhe publike, mirëqenies ekonomike, mbrojtjes së rendit dhe parandalimit të veprave penale, mbrojtjes së shëndetit dhe moralit, ose mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve, në një shoqëri demokratike.

Protokolli i Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është miratuar në Paris, 20 mars 1952, për shkak të ndërmarrjes së masave për sigurim të garantimit kolektiv të atyre të drejtave dhe lirive të cilat nuk janë përmendur në Pjesën I të Konventës. Në nenin 1 garantohet mbrojtja e pronësisë: “Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë për posedim paqësor të pronës vet. Askush nuk mund të jetë i privuar nga prona e vet, përveç në interes publik dhe me kushte të parapara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Dispozitat paraprahe nuk ndërhyjnë në të drejtën e shteteve të miratojnë ligje të cilat i konsiderojnë të domosdoshme për rregullim të shfrytëzimit të pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm ose për shkak të pagesës së sigurt të tatimit, kontributeve tjera dhe dënimeve me para”.²⁵

Në Protokollin numër 12 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Romë, 4 nëntor 2000) neni 1 paragrafi (1) përcakton ndalesë të përgjithshme të diskriminimit: “Realizimi i çdo të drejte të paraparë me ligj do të sigurohet pa diskriminim mbi cilën do bazë sikur gjinia, raca, ngjyra, gjuha, religjioni, bindja politike ose tjera, prejardhja nacionale apo sociale, lidhje me pakicë nacionale, pronë, lindja ose status tjetër. Askush nuk guxon të jetë i diskriminuar nga ana e organit publik në çfarë do baze të përmendur në paragrafin (1)”.²⁶

Pra, Konventa evropiane për të drejtat e njeriut vendos edhe mekanizëm për zbatim të obligimeve të cilat i kanë pranuar shtetet kontraktuese.

²⁴ ibis

²⁵ Protokolli i Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore Paris, 20 mars 1952, neni 1, https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf [hapur më 06.05.2019]

²⁶ Protokolli numër 12 i Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore Romë, 4 nëntor 2000, neni 1, https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf [hapur më 14.05.2019]

1.3.1.2 Konventa për imunitet të juridiksionit

Interes i veçantë është Konventa për imunitet të juridiksionit nga viti 1972, mbrojtje të mjedisit jetësor si dhe në marrëveshjet nga sfera e të drejtës humanitare. Veçanërisht duhet të nënvizohen Karta Sociale Evropiane nga viti 1961 si dhe Ligji evropian për mbrojtje sociale nga viti 1964. Veprimi legjislativ i Këshillit të Evropës ka çuar edhe deri në krijimin e të drejtës rajonale evropiane.²⁷

1.3.1.3 Karta Sociale Evropiane

Karta Sociale Evropiane, e miratuar në vitin 1961, i garanton të drejtat sociale dhe ekonomike të njeriut; të drejtën për kushte të barabarta për punë; të drejtën për negociata kolektive; të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje; të drejtën për mbrojtjen e grave të punësuar; të drejtën për orientim profesional; të drejtën për mbrojtje shëndetësore; të drejtën për sigurim social; të drejtën për ndihmë sociale dhe shëndetësore; të drejtën për ndihmë nga shërbimet për kujdes social; të drejtën për arsimim profesional dhe për rehabilitim profesional dhe social të personave me pengesa fizike apo mentale; të drejtën për mbrojtje juridike sociale dhe materiale të familjeve; të drejtën për mbrojtje sociale dhe materiale të nënës dhe fëmijës; të drejtën për angazhim në profesional profitabil në territorin e shteteve tjera-palë kontraktuese dhe të drejtën për mbrojtje dhe ndihmë të punonjësve – emigrantë dhe familjeve të tyre.

Me nënshkrimin e Kartës shtetet-palë nënshkruese pranojnë dy obligime për respektimin dhe realizimin e saj konzistent.

Karta Sociale Evropiane e reviduar (e miratuar nga Këshilli i Evropës) përmban listë më të detajuar të të drejtave ekonomike dhe sociale, si e drejta për punë, e drejta për kushte të barabarta për punë, e drejta për pagë të drejtë, e drejta për organizim të punonjësve, e drejta për trajnim profesional dhe ngjashëm. Në nenin 3 të Pjesës 5, është paraparë obligimi i shteteve për të siguruar realizimin e të drejtave nga Karta pa diskriminim.

1.3.2. Këshilli i Evropës dhe mbrojtja e mjedisit jetësor

Këshilli i Evropës e vë zhvillimin e qëndrueshëm në majo të agjendës së vet. Politika e vet është që përparimi ekonomik nuk guxon t'i komprometojë mjetet kritike të njerëzimit: cilësia e mjedisit jetësor dhe peizazhet, të drejtat e njeriut dhe barazia sociale, llojshmëria kulturore dhe demokracia. Këshilli i Evropës i konsideron ndryshimet klimatike si problemi më serioz ekologjik me të cilin ballafaqohet bota sot, i identifikon implikimet për të drejtat e njeriut dhe është aktiv në dy fronte: ruajtje e resurseve natyrore dhe shumëllojshmëria biologjike, por edhe mbrojtja e shumëllojshmërisë dhe vitaliteti i kulturave të shumta në botë. Prandaj, shtylla kulturore e zhvillimit të qëndrueshëm kërkon përpjekje paralele për zhvillim të kulturës së qëndrueshmërisë dhe për mbrojtje të llojshmërisë kulturore.

Komiteti i ministrave të Këshillit të Evropës, Komitetit drejtues për të drejta të njeriut ia beson detyrën për të punuar për të drejtat e njeriut dhe mjedisin jetësor. Duke e monitoruar punën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, qartë vërehet përkushtimi në çështjet lidhur me mjedisin jetësor dhe vlerëson që nuk është vetëm e drejtë fundamentale e qytetarëve të jetojnë në mjedis jetësor të shëndoshë, por obligim i shoqërisë si tërësi dhe i secilit individ, veçanërisht t'u lënë në trashëgimi mjedis të shëndoshë jetësor për gjeneratat e ardhshme. Më tej, theksohet që pjesë e resurseve për fat të keq, nuk janë të rinovueshme dhe se degradimi i mjedisit jetësor shpesh herë është i pakthyeshëm.

Asambleja Parlamentare prapë se prapë jep vërejtje dhe shpreh keqardhje që edhe përkrah të gjitha politikave dhe iniciativave ligjore që janë ndërmarrë, si në nivel ndërkombëtar, ashtu edhe në nivel nacional, mbrojtja e mjedisit jetësor është ende në nivel shumë të ulët. Në këtë kontekst Këshilli i Evropës ka miratuar numër të konsiderueshëm konventash, direktivash, rregulloresh,

²⁷ Protokoll i Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore Paris, 20 mars 1952, neni 1, https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf [hapur më 06.05.2019]

rekomandimesh dhe ngjashëm. Disa prej tyre janë: Konventa për ruajtje të botës së egër dhe habitateve natyrore nga viti 1979 (Konventa e Bernit, ETS numër 104), Konventa nga viti 1993 Përgjegjësi qytetare për dëme që rezultojnë prej aktiviteteve të cilat janë të rrezikshme për mjedisin jetësor (ETS numër 150) dhe Konventa për mbrojtje të mjedisit jetësor nëpërmjet të drejtës penale nga viti 1998 (ETS numër 172).

Asambleja Parlamentare e ka miratuar edhe Rekomandimin 1614 (2003) për mjedisin jetësor dhe të drejtat e njeriut dhe Rekomandimin 1431 (1999) për aktivitetet e ardhshme që duhet t'i ndërmarrë Këshilli i Evropës në sferën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, i cili tash më ka propozuar shtim të komponentit për mjedisin jetësor në Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut.

Rekomandimin 1431 (1999), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës propozoi të plotësohet KEDNj me kërkesë për *“mjedis jetësor të shëndoshë dhe të qëndrueshëm si e drejtë themelore e njeriut”*. Asambleja Parlamentare është angazhuar për domosdoshmërinë për *“t'u njohur e drejta e njeriut për mjedis të shëndoshë, të qëndrueshëm dhe të denjë që përfshin obligim objektiv për shtetet ta mbrojnë mjedisin jetësor, në ligjet nacionale, sipas mundësisë në nivel kushtetues”*. Në Rekomandimin 1614²⁸, Asambleja Parlamentare, gjithashtu ka propozuar hartim të protokollit për KEDNj për mbrojtje të mjedisit jetësor, duke i përfshirë të drejtat procedurale të Konventës së Aarhusit.

Këto propozime, sidoqoftë janë refuzuar nga ana e Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës, për shkak të faktit që KEDNj veç më siguron mbrojtje të mjedisit jetësor nëpërmjet të drejtave të njeriut të gjeneratës së parë dhe të dytë. Rekomandimi 1883 (2009) për sfidat lidhur me ndryshimet klimatike sërish e ka nxitur debatin për përpilim të protokollit plotësues të KEDNj, në lidhje me të drejtën për mjedis jetësor të shëndoshë. Në këtë drejtim Rekomandimi 1885 (2009)²⁹ e alarmon jo vetëm të drejtën themelore të qytetarëve të jetojnë në mjedis jetësor të shëndoshë, por edhe obligimin e shoqërisë si tërësi dhe secilin individ, të lënë në trashëgimi mjedis jetësor të shëndoshë dhe të qëndrueshëm, veçanërisht, për gjeneratat e ardhshme.³⁰

Asambleja Parlamentare në Rekomandimin 1885 (2009) e njuh dhe shënon praktikën në sferën e mjedisit jetësor të zhvilluar nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut dhe e përshëndet publikimin e Doracakut për të drejta të njeriut dhe parimet ekologjike të cilat rezultojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejta të njeriut, të publikuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2006. Parimet në doracakun rezultojnë nga praktika gjyqësore nga nëntori i vitit 2005 dhe shpreh shpeshë që ky doracak do të jetë rregullisht i azhurnuar. Kjo praktikë gjyqësore ka siguruar mbrojtja e të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë të jetë nëpërmjet “goditjes” në bazë të respektimit të të drejtave individuale në nenet 2 dhe 8 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Me aktivitetet e veta, Këshilli i Evropës ka ndihmuar të formohet mjedis përkatës juridik në Evropë në dobi të shumëllojshmërisë biologjike, planifikimit hapësinor dhe menaxhimit me peizazhin dhe zhvillimin e qëndrueshëm territorial të bazuar në shfrytëzim të integruar të resurseve kulturore dhe natyrore.

Republika e Maqedonisë së Veriut u bë shteti i 38 anëtar i Këshillit të Evropës më 9 nëntor 1995.³¹ Prej atëherë, në mënyrë aktive bashkëpunon me të gjithë trupat e KE-së (Komiteti për parandalim të torturës, Komisionin e Venecias, EKRI, Komisararin për të drejtat e njeriut, etj.) dhe në mënyrë intensive i plotëson obligimet e veta që rezultojnë nga anëtarësia në Këshillin e Evropës dhe Konventat e Këshillit të Evropës të cilat i ka miratuar.

28 Rekomandimi 1614 (2003), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=17131&lang=en> [hapur më 22.04.2019]

29 Rekomandimi 1885 (2009), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetailsEN.asp?fileid=24830&lang=EN&search=cmNvbW1lbmRhdGlvbiAxODg1> [hapur më 11.04.2019]

30 Otatio Kviriko dhe Muilld Bumurgar, Ndryshime klimatike dhe të drejta të njeriut: perspektivë për të drejtën ndërkombëtare dhe krahasuese, fq. 303

31 Publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Evropës, <https://www.coe.int/mk/web/skopje/the-council-of-europe> [hapur më 08.04.2019]

Në kuadër të bashkëpunimit aktiv 18-vjeçar të R. së Maqedonisë së Veriut me Këshillin e Evropës, përfaqësues të institucioneve qeveritare rregullisht dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në punën e komiteteve ad hok dhe komiteteve të ekspertëve të Këshillit të Evropës, takimet e të cilëve janë në funksion të zbatimit të programit ndërqeveritar të aktiviteteve dhe harmonizim të politikave evropiane në të gjitha sferat, përveç mbrojtjes.³²

Nga maji deri më nëntor 2010 R. e Maqedonisë së Veriut për herë të parë ka kryesuar me Komitetin e ministrave të Këshillit të Evropës. Në kuadër të kryesimit gjashtëmujor, shteti ka dhënë kontribut maksimal në drejtim të promovimit të vlerave dhe standardeve të organizimit, si dhe për përmirësim të relevancës së saj politike në skenën ndërkombëtare. Prioritetet e kryesimit të Maqedonisë me Organizatën janë fokusuar drejt: fuqizimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, fuqizimin e integritimit me respektim të diversitetit dhe promovim të bashkëpunimit ndërkombëtar.³³

1.3.3. Konventa të Këshillit të Evropës për mbrojtje të mjedisit jetësor

1.3.3.1 Konventë për ruajtje të botës së egër dhe habitatet natyrore (Konventa e Bernit)

Konventa për ruajtjen e botës së egër dhe të habitateve natyrore (Konventa e Bernit) është miratuar në Bern, Zvicër më vitin 1979 dhe ka hyrë në fuqi më vitin 1982. Konventa e Bernit është instrument obligues juridik ndërkombëtar në sferën e mbrojtjes së natyrës, duke e mbuluar pjesën më të madhe të trashëgimisë natyrore të kontinentit evropian, duke përfshirë edhe disa shtete të Afrikës. Qëllimet kryesore të Konventës janë të sigurojnë ruajtje dhe mbrojtje të specieve të egra dhe llojeve bimore dhe habitatet e tyre natyrore (të përmenden në Shtojcat I dhe II të Konventës), të rritet bashkëpunimi ndërmjet palëve kontraktuese dhe të rregullohet eksploatimi i atyre llojeve (duke i përfshirë edhe speciet shtegtuese) të numëruara në Shtojcën III. Për atë qëllim, Konventa imponon obligime të juridike për palët nënshkruese, duke mbrojtur më shumë se 500 lloje bimore të egra dhe më shumë se 1.000 kafshë të egra.

1.3.3.2 Përgjegjësi qytetare për dëme që rezultojnë nga aktivitetet të cilat janë të rrezikshme për mjedisin jetësor (ETS numër 150)³⁴

Qëllimi i Konventës është të sigurohet kompensim përkatës për dëmin që rezulton prej aktiviteteve të cilat janë të rrezikshme për mjedisin jetësor, ndërsa gjithashtu parashihet edhe mjetet për parandalim dhe kthim. Në Konventën përmendet që problemet me kompensim përkatës të emetimeve që lëshohen nga vendi, ndërsa shkaktojnë dëm në vend tjetër janë gjithashtu të karakterit ndërkombëtar.

Sistemi i Konventës bazohet në përgjegjësi objektive duke e marrë parasysh parimin “ndotësi paguan”. Megjithatë, vendosen rregulla të veçanta lidhur me gabimin e viktimës, shkakun, përgjegjësinë e përbashkët të operatorëve të instalacioneve apo vendeve për dëmtim dhe skemën e detyrueshme për siguri financiare për mbulim të përgjegjesisë sipas Konventës.

Konventa parasheh që personat e interesuar të kenë të drejtë për qasje tek informatat që i posedojnë trupat me përgjegjësi publike për mjedisin jetësor.

Konventa themelon komitet të përhershëm i cili është përgjegjës për interpretim dhe zbatim të Konventës. Komiteti mund të japë rekomandime lidhur me zbatimin e Konventës dhe të propozojë çfarë do amendamenti të domosdoshëm ndaj Konventës.

32 Publikuar në MPJ, http://mfa.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=124&Itemid=403&lang=mk
33 Ibis.

34 Konventë për përgjegjësi qytetare për dëm si rezultat i aktiviteteve të rrezikshme për mjedisin jetësor, Detaje për marrëveshjen numër 150, Këshilli i Evropës, <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/150> [пристапено на 22.04.2019 год.]

1.3.3.3 Konventa për mbrojtje të mjedisit jetësor nëpërmjet të drejtës penale nga viti 1998 (ETS numër 172)

Konventa është e orientuar drejt përmirësimit të mbrojtjes së mjedisit jetësor në nivel evropian me shfrytëzim të zgjidhjes në instancë përfundimtare - e drejta penale, me qëllim ta kthehet mbrapa dhe të parandalohet sjellja më e dëmshme për atë. Gjithashtu, përpiqet ta harmonizon legjislacionin nacional në këtë sferë.

Ky instrument juridik i obligon shtetet nënshkruese të inkorporojnë dispozita specifike në ligjin e tyre penal apo t'i modifikojnë dispozitat ekzistuese në këtë sferë. Ajo i përcakton si vepra penale numër të madh të veprave të kryera qëllimisht apo nga neglizhenca ku shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëmtim permanent të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve ose bimëve apo rezultojnë me vdekje ose lëndim serioz të cilit do person.

Konventa e përkufizon konceptin e përgjegjësisë penale të personave fizikë dhe juridikë, i numëron masat që duhet t'i miratojnë shtetet për t'u mundësuar konfiskim të pronës dhe t'i përkufizojnë autorizimet që i kanë në dispozicion autoritetet si dhe siguron bashkëpunim ndërkombëtar.

Sanksionet duhet të përfshijnë dënime me burg apo me para dhe mund të përfshijnë kthim të mjedisit jetësor në gjendjen origjinale. Dispozitë tjetër e rëndësishme ka të bëjë me mundësinë e shoqatave për mbrojtje të mjedisit jetësor të marrin pjesë në procedura penale lidhur me shkeljet e parapara në Konventë.

Duke e shqyrtuar ndikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare tregtare dhe nevojën për adresim të përhapjes potencialisht të pabarabartë të përfitimeve potenciale të përgjithshme, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e miratoi Rezolutën 2152 (2017)³⁵ më 27 janar 2017, duke u thirrur në Marrëveshjen për ndryshime klimatike në Paris 2015. Rezoluta 2152 (2017) ka të bëjë me "Gjeneratë të re" të marrëveshjeve tregtare, duke theksuar që asnjë marrëveshje nuk guxon t'i minimizojë politikat publike të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor, shëndetin publik dhe të drejtat sociale.

Marrëveshjet nuk duhet të përfshijnë autorizime që investitorët t'i minimizojnë (tejkalojnë) imperativët në ekologji, demokraci dhe të drejtat e njeriut. Asambleja Parlamentare u bën thirrje negociatorëve të Bashkimit Evropian të qëndrojnë të fortë në vendosmërinë e tyre për t'i mbrojtur dhe promovojnë interesat e qytetarëve evropian dhe të përkushtojnë shumë vëmendje në formulimin e përpiktë të dispozitave lidhur me mjedisin jetësor, sigurinë e ushqimit, shëndetin publik, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Me këtë rezolutë, Këshilli i Evropës edhe një herë e promovon qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor, të drejtat e njeriut dhe sundimin e të drejtës demokratike, duke i lehtësuar benefitet nga tregtia ndërkombëtare.

1.4. Bashkimi Evropian

Institucione jopolitike: Gjykata për drejtësi e Bashkimit Evropian, Banka Qendrore Evropiane dhe Gjykata e revizorëve.

Bashkimi Evropian është themeluar me marrëveshje ndërkombëtare – Treaty është marrëveshje formale e nënshkruar ndërmjet shteteve me qëllim të përkufizimit (apo modifikimit) të detyrave dhe obligimeve të tyre të ndërsjella. Bashkimi Evropian është i fokusuar drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm, jo vetëm në kontekst të krijimit të politikave për mjedis jetësor, por edhe në kontekst të të gjitha vendimeve politike: edhe ekonomike, edhe sociale edhe ato që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor.

Bashkimi Evropian (BE), institucionet e saj (Komisioni Evropian, Këshilli i ministrave dhe Parlamenti Evropian), e kanë mbrojtjen e mjedisit jetësor si lëndë të veprimit nga themelimi i Bashkimit. Në Marrëveshjen për formim të Komunitetit Ekonomik Evropian apo Marrëveshjen nga Roma (të

³⁵ Rezoluta 2152 (2017), 27 janar 2017, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-EN.asp?fileid=23489&lang=en> [hapur më 09.05.2019]

nënshkruar më 25 maj 1957) thuhet që: *Komuniteti ka për detyrë promovim në ... nivel të lartë të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë për mjedis jetësor.*

Në Preambulën e Marrëveshjes për Bashkimin Evropian (nga 7 shkurti 1992, ka hyrë në fuqi më 1 nëntor 1993) apo ndryshe i njohur Marrëveshja e Mاستrihtit, thuhet: *Komuniteti është i vendosur të promovojë përparim ekonomik dhe social për qytetarët e tij, duke e marrë parasysh parimin e zhvillimit të qëndrueshëm...*

Me Marrëveshjen nga Amsterdami³⁶ me të cilën plotësohet Marrëveshja për Bashkimin Evropian, marrëveshjet për formim të komuniteteve evropiane dhe aktet e lidhur, miratohet obligimi për "arritje të zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm" (neni B) dhe duke theksuar që instrumentet financiare të Bashkimit do të punojnë në mënyrë simultane dhe afatgjatë, drejt sigurimit të rritjes ekonomike, kohezionit dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor. Marrëveshja nga Amsterdami e inkorporon zhvillimin e qëndrueshëm si qëllim themelor (Core Objective) të Bashkimit Evropian, siç thuhet në nenet 2, 3 dhe 6 të Marrëveshjes. Kështu, në nenin 6 thuhet që: *Kërkesat që i përcakton mbrojtja e mjedisit jetësor duhet të jenë të integruara gjatë përkufizimit dhe zbatimit të politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit... me theks të veçantë në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm.*

Me Marrëveshjen nga Nica (të nënshkruar më 26 shkurt 2001, ndërsa në fuqi ka hyrë më 1 shkurt 2003) edhe një herë konfirmohet përpjekja e Bashkimit Evropian për shfrytëzim të mundësive të Marrëveshjes për themelim të Bashkimit Evropian për mbrojtje të mjedisit jetësor, duke përfshirë edhe shfrytëzim të lehtësimeve dhe instrumenteve me orientim tregtar dhe drejt promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Draft Marrëveshja për formim të Kushtetutës së Evropës është përpunuar me qëllim t'i zëvendësojë të gjitha marrëveshjet ekzistuese me tekst të vetëm. E miratuar më 17 dhe 18 qershor 2004 nga ana e shefave të shteteve dhe qeverive në Këshillin Evropian të Brukselit, ndërsa e nënshkruar në Romë, më 29 tetor të vitit 2004 nga ana e 25 vendeve anëtare të Bashkimit. Megjithatë, Kushtetuta nuk hyri në fuqi, për shkak se procedura e mëtutjeshme impononte ratifikim nga secili vend anëtar, në pajtim me rregullimet e tyre kushtetuese (në procedurë parlamentare ose me referendum), mirëpo Franca dhe Holanda, në vitin 2005 e refuzuan tekstin e saj.

Si zëvendësim i Marrëveshjes Kushtetuese është krijuar Marrëveshja e Lisbonës e cila është Marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga ana e liderëve të 27 vendeve anëtare të Bashkimit më 13 dhjetor 2007. Për të hyrë në fuqi duhej të ratifikohen nga secili shtet anëtar në pajtim me kushtet e veta kushtetues dhe juridik. Me nënshkrim të instrumentit për ratifikim më 3 nëntor 2009 nga ana e kryetarit Çek, Marrëveshja e Lisbonës ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor të vitit 2009.

Marrëveshja e Lisbonës e plotëson Marrëveshjen e Bashkimit Evropian dhe Marrëveshjen për formim të Komunitetit Evropian. Në pjesën e Dispozitave të përgjithshme, në nenin 2, paragrafi (3) thuhet që: *Bashkimi do të themelojë treg të brendshëm. Do të punojë në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm të Evropës të bazuar në rritje të ekuilibruar ekonomike dhe stabilitet të çmimeve, ekonomi sociale tregtare me konkurrencë të lartë, me qëllim të punësimit të plotë dhe kontribut social si dhe shkallë të lartë të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit jetësor.*

Më tutje, në të njëjtin nen 2, paragrafi (5), thotë që: *Bashkimi në marrëdhëniet me botën, do t'i përkrahë dhe promovojë vlerat dhe interesat e veta dhe do të kontribuon për mbrojtjen e qytetarëve të vet. Do të kontribuon për paqe, siguri, zhvillim të qëndrueshëm të Tokës, solidaritet dhe respekt të ndërsjellë mes njerëzve, tregti të lirë dhe të drejtë, çrrënjosje të varfërisë dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtat e fëmijëve si dhe monitorim të rreptë dhe avancimin e të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe respekt ndaj parimeve nga Karta e Kombeve të Bashkuara.*

Në Dispozitat e përgjithshme, në pjesën e titulluar Marrëdhënie të jashtme të Bashkimit, neni 10 A, në paragrafin (2) thuhet: *Bashkimi do të përkufizojë dhe zbatojë politika dhe aksione të përbashkëta dhe do të punojë në drejtim të shkallës më të lartë të bashkëpunimit në të gjitha fushat*

³⁶ E nënshkruar më 2 tetor 1997, ka hyrë në fuqi më 1 maj 1999.

e marrëdhënieve ndërkombëtare me qëllim, ndër tjerash ... që të ndihmojë gjatë zhvillimit të masave ndërkombëtare për ruajtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit jetësor dhe menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore globale, për t'u siguruar zhvillim i qëndrueshëm.

Përveç në dokumentet e përmendura por edhe në shumë të tjera të Bashkimit Evropian është përcaktuar pozita e vet ndaj zhvillimit të qëndrueshëm në përpjekjet e përgjithshme zhvillimore të saj, që implikon edhe obligime dhe hapa konkret që duhet t'i ndërmerr ai.

Në maj 2005, Komisioni Evropian e miratoi "Draft deklaratën për parime udhëheqëse për zhvillim të qëndrueshëm", në të cilën thuhet: Bashkimi Evropian është fortë i vendosur për zhvillim të qëndrueshëm. Ky është parimi kyç i të gjitha politikave dhe aktiviteteve... Deklarata e konfirmon vizionin afatgjatë për qëndrueshmëri, i identifikon qëllimet kryesore të politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit dhe e përshkruan mënyrën si Bashkimi dëshiron t'i plotëson ato qëllime. Këto parime udhëheqëse korrespondojnë me vlerat themelore të modelit shoqëror dinamik evropian... Zhvillimi i qëndrueshëm është qëllim kritik i të gjitha politikave të Komunitetit Evropian.

Për t'u arritur kjo, Bashkimi Evropian dhe vendet anëtare të tij angazhohet për respektim të qëllimeve kritike (mbrojtje e mjedisit jetësor, barazi sociale dhe kohezion, prosperitet ekonomik dhe përmbushje e obligimeve ndërkombëtare) dhe parimet për zbatim të politikave (promovim dhe mbrojtje e të drejtave themelore, barazi brenda dhe ndërmjet gjeneratave, shoqëri e hapur dhe demokratike, inkluzion të qytetarëve, inkluzion të biznesit dhe partnerëve shoqëror, koherencë e politikave dhe menaxhim/udhëheqje, integrim të politikave, shfrytëzim të diturive më të mira në dispozicion, parimi i kujdesit dhe zbatim të parimit ndotësi pagan).

1.4.1. Sistemi për të drejta të njeriut para Bashkimit Evropian

Sistemi për të drejta të njeriut para Bashkimit Evropian e përfshin Kartën për të drejta themelore (Karta) si dhe direktivat për mosdiskriminim. Karta, (e nënshkruar në vitin 2000), proklamoi një sërë të drejtash qytetare, politike, ekonomike dhe sociale për qytetarët evropian dhe të gjithë personat të cilët qëndrojnë në BE në bazë të të drejtave dhe lirive themeluar që njihen me Konventën Evropiane për të drejta të njeriut, traditat kushtetuese të komunitetit për të drejtat themelore sociale të punonjësve dhe konventa tjera ndërkombëtare në të cilat BE-ja apo vendet e veta anëtare janë nënshkruese. Karta e tejkalon domenin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut me atë që është e përkushtuar edhe në probleme posaçërisht bashkëkohore si bioetika dhe mbrojtja e të dhënave personale.

Karta në pajtim me Marrëveshjen e Lisbonës, është juridiko-obligative prej në dhjetor të vitit 2009. Ajo mund të zbatohet nga ana e institucioneve të BE-së dhe vendet anëtare gjatë zbatimit të të drejtës së Bashkimit.

Karta ndalon diskriminim në çfarë do baze sikur: gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja etnike apo racore, karakteristika gjenetike, gjuhë, konfesion apo bindje, qëndrimi politik apo çfarë do qëndrimi tjetër, përkatësia në pakicë nacionale, prona, lindja, pengesa, mosha apo orientimi seksual. Me këtë është zgjeruar kompetenca e BE-së në sferën e barazisë mbi atë që paraqet diskriminim në bazë të gjinisë dhe shtetësisë, si shprehje e parimeve fundamentale të barazisë dhe mosdiskriminimit, që janë pjesë e parimeve në të cilat bazohet Bashkimi Evropian.

Neni 13 i Marrëveshjes për themelimin të Bashkimit Evropian paraqet bazë juridike për miratim të masave nga ana e Bashkimit për luftë kundër diskriminimit. Vendet anëtare të BE-së duhet ta aplikojnë parimin e barazisë në legjislacionin e tyre vendor. Gjykatat nacionale kur përballen me legjislacionin vendor, që nuk është i harmonizuar me këtë parim, nuk duhet të ta zbatojnë por duhet ta garantojnë parimin e përgjithshëm të barazisë dhe të sigurohen që është efikas.

Parlamenti Evropian është i angazhuar në procesin e miratimit të direktivave tjera në fushën e parandalimit të diskriminimit. Detyrë kryesore e Komisionit Evropian është të propozojë ligje të reja, si dhe ta zbatojë të drejtën ekzistuese evropiane dhe t'i zbatojë politikën e ngjashme, si dhe ta zbatojë të drejtën ekzistuese evropiane dhe t'i zbatojë politikën e ngjashme. Gjykata e drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) jep interpretime të të drejtës së BE-së.

BE-ja ka fuqi të miratojë lidhe dhe të ndërmerr aktivitete tjera në sfera të caktuar duke përfshirë edhe parandalim të diskriminimit. Ato ligje kanë përparësi nga ligjet vendase në suaza të sferës së caktuar të kompetencës. “Dominimi” i këtillë i të drejtës së BE-së nënkupton që gjykatat nacionale duhet t’i japin përparësi të drejtës së BE-së para dispozitave jokonzistente vendore. Së këtejmi, sistemi juridik i BE-së ka karakter ‘mbinacional’. Kjo donë të thotë se për dallim prej shembullit të Konventës evropiane për të drejta të njeriut, e drejta e BE-së kundër diskriminimit nuk dallon nga e drejta vendase, por paraqet pjesë të pandashme të saj dhe në kushte të caktuar ka zbatim të drejtpërdrejtë. Jo vetëm që gjykatat nacionale mund të udhëzojnë në të drejtën e BE-së, por ato kanë obligim ta aplikojnë. Individë mund t’i kërkojnë të drejtat e tyre që janë paraqitur me të drejtën e BE-së para gjykatave vendore, nëse dispozita në të cilën ato referohen ka aplikim të drejtpërdrejtë.

Në direktivën 2008/52/KE³⁷ të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian thuhet se qëllimi për sigurim të **qasjes më të mirë në drejtësi**, si pjesë e politikës së Bashkimit Evropian për themelim të fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, duhet të përfshijë qasje në metoda të zgjidhjes gjyqësore dhe jashtëgjyqësore të kontesteve. Në atë drejtim, kjo direktivë duhet të kontribuojë për funksionim të rregullt të tregut të brendshëm, veçanërisht për shkak se e përfshin shërbimet ndërmjetësuere.

Direktiva ka për qëllim t’i përmirësojë të drejtat themelore dhe i merr parasysh parimet nga Karta Bashkimit Evropian për të drejta themelore. Krijimi i procedurave alternative jashtëgjyqësore, përmendet në Direktivën e BE-së, kontribuon në qasjen në drejtësi si e drejtë themelore e njeriut.

Ndërmjetësimi, thuhet në Direktivë, mund të mundësojë zgjidhje jashtëgjyqësore, që financiarisht shpaguhen, të kontesteve për çështje qytetare dhe tregtare nëpërmjet procesit të adaptuar për nevojat e palëve. Më e mundur është që marrëveshjet që rezultojnë nga ndërmjetësimi do të zbatohen në bazë vullnetare dhe do të rezultojnë me lidhje miqësore dhe të qëndrueshme ndërmjet palëve. Këto benefite janë edhe më të theksuara në situata ku ekzistojnë elemente ndërkuftare.

Si procedurë e orientuar drejt gjetjes së zgjidhjeve efektive tregtare, në Direktivë theksohet që ndërmjetësimi nuk duhet të konsiderohet si alternativë më e keqe e procedurës gjyqësore, në kuptim që respektimi i marrëveshjeve që rezultojnë nga ndërmjetësimi do të varen nga vullneti i mirë i palëve.

Besueshmëria është e rëndësishme në procesin e ndërmjetësimi, pra sipas kësaj, kjo direktivë duhet të sigurojë shkallë minimale për mundësi zbatimi të dispozitave nga procedura civile në lidhje me atë si të mbrohet besueshmëria e ndërmjetësimi në të gjitha procedurat e mëtutjeshme gjyqësore apo arbitrazhin qytetar dhe tregtar.

Ndërmjetësimi i përcaktuar në këtë direktivë duhet të paraqet proces vullnetar në kuptim të asaj që palët janë vet përgjegjëse për procesin dhe mund ta organizojnë ashtu si duan dhe ta përfundojnë në çdo kohë. Prapë se prapë, sipas të drejtës nacionale, thuhet në Direktivën, gjykatat duhet të jenë në mundësi të përcaktojnë afate për procesin e ndërmjetësimi. Përveç asaj, gjykatat duhet t’u prezantojnë palëve mundësinë për ndërmjetësim gjithmonë kur kjo është e përshtatshme.

Në Direktivën theksohet edhe rëndësia e krijimit të kornizës së parashikueshme juridike dhe legjisllacioni i cili konkretisht do të fokusohet në aspektet kritike të ndërmjetësimi dhe në atë drejtim në procedurën civile.

37 Publikuar në Akademik.mk 17.01.2017, <https://akademik.mk/alternativnite-vonsudski-postapki-i-pristapote-dopravda-evropskiot-parlament-i-sovetot-na-eu-za-medijatsijata-vo-graganskite-i-trgovskite-sporovi/> hapur më 06.05.2019

1.4.2. Bashkimi Evropian dhe Konventa e Aarhusit

Me ratifikimin e Konventës së Aarhusit në shkurt 2005, BE-ja obligohet të garantojë qasje të gjerë në drejtësi për çështjet lidhur me mjedisin jetësor, si në nivel nacional ashtu edhe në nivel të BE-së.

Sipas vendimit të Gjykatës së drejtësisë të Bashkimit Evropian në rastin Etang de Berre³⁸, me vetë nismën e Bashkimit, Konventa e Aarhusit si dhe të drejtat dhe obligimet që rezultojnë nga e njëjta, bëhen pjesë e *acquis communautaire* i dhe i obligojnë institucionet e Bashkimit dhe vendet anëtare. Pavarësisht zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë, Bashkimi Evropian ka miratuar direktiva me të cilat rregullohen të drejtat dhe obligimet nga Konventa.

Në vitin 2006, BE-ja miratoi Rregullore të veçantë (KE), numër 1367/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nga 6 shtatori 2006, për aplikim të dispozitave të Konventës së Aarhusit për qasje tek informatat, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor në institucionet dhe trupat e Komunitetit.

Risi në këtë akt është që mundësohet: *Çdo shoqatë qytetare e cila i plotëson kriteret nga neni 11 të ketë të drejtë të kërkojë revizion të brendshëm nga institucioni apo trupi i Komunitetit [Bashkimit] që ka miratuar akt administrativ nga legjislacioni i mjedisit jetësor.*

Me revizionin e brendshëm mundësohet që organet kompetente të rishqyrtojnë nëse kanë sjellë vendim të drejtë kur kanë miratuar ndonjë akt juridik në rast se fitojnë qëndrime të kundërta nga shoqatat qytetare.

1.4.3 Direktiva të BE-së lidhur me mjedisin jetësor

Për dallim prej marrëveshjeve ndërkombëtare, ku e drejta për mjedis jetësor rregullohet në mënyrë të përgjithshme dhe e njëjta nuk është e segmentuar në lidhje me fushat e mbrojtjes, në suaza të Bashkimit Evropian çdo segment është veçmas i përpunuar dhe i rregulluar. Në atë drejtim, BE-ja ka miratuar më tepër Direktiva që mund t'i ndajmë në tre nëngrupe më të mëdha:

- Direktivat për mjedis jetësor;
- Direktivat për ndotje dhe hedhurina;
- Direktivat për kafshë të egra dhe mbrojtje të natyrës.

E drejta ekologjike në nivel të BE-së përfshin më tepër sektorë relevantë dhe fusha nga mjedisi jetësor apo për ata që janë të prekur nga rregullat ekologjike sikur: rregullim i cilësisë së ajrit, ujit, mbrojtja e biodiversitetit, mbrojtja nga zhurma, përdorimi i kimikateve, modifikim i organizmave, prodhimtaria organike, transporti, pyjet, energjetika dhe ndryshimet klimatike dhe ngjashëm. Dispozitat nga ligjet ekologjike drejtpërsëdrejti apo tërthorazi ndikojnë edhe mbi fushat tjera shoqëro-juridike.

Legjislacioni i BE-së për mbrojtje dhe avancim të cilësisë së ajrit përbëhet prej mbi 20 akteve normative. Normimi i këtillë juridik, megjithëse vëllimor dhe i ndërlikuar paraqet rrjet koherent rregullues i cili tërësisht i rregullon ndërveprimet ndërmjet veprimeve të njeriut dhe ajrit si medium i mjedisit jetësor. Rregullimi i këtillë i përfshin edhe burimet stacionare dhe të lëvizshme të ndotjes.

Ujërat janë një nga sektorët e parë të cilët janë të përfshirë në politikat ekologjike të Bashkimit Evropian. Mirëpo edhe përkrah rregullimeve të shumta, në nivel të BE-së mungonte sistem i koordinuar në mënyrë adekuate i cili me efektivitet do ta adreson problemin me karakterin transnacional të ndotjes së ujërave. Me Direktivën 2006/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nga 23 tetori i vitit 2000 është krijuar kornizë për veprim të Komunitetit në fushën e politikës për ujëra.

Çështja e hedhurinave në Bashkimin Evropian është rregulluar nga rrjeti i direktivave me lidhje hierarkike për t'u reduktuar ndikimi negativ mbi njeriun dhe mjedisin jetësor dhe të stimulohet

³⁸ Rasti S – 239/03, Commission v. French Republic, https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:62003CJ0239_SUM&from=FR [hapur më 12.06.2019]

ekonomi energjetik dhe efikase për resurse. Në këtë rrjet rregulloresh, rolin më të rëndësishëm e kanë Direktiva kornizë për hedhurina dhe Direktiva për paketim dhe hedhurina prej paketimeve.³⁹

1.4.3.1 Direktiva e Këshillit 96/61/KE për parandalim të integruar dhe kontroll të ndotjes

Duke e vështruar nevojën për mbrojtje optimale dhe parandaluese të mjedisit jetësor, qasje të integruar për kontroll të ndotjes dhe uniformim të rregullave nacionale të vendeve anëtare të BE-së, në vitin 1996 është miratuar Direktiva për parandalim të integruar⁴⁰ dhe kontroll të ndotjes apo shkurtimisht Direktiva PIKN (Integrated Pollution Prevention and Control-IPPC). Direktiva PIKN është akt themelor dhe kyç normativ për rregullim të aktiviteteve industriale në Evropë.

Qëllimi i Direktivës është të parandalohet ose të zbritet në minimum ndotja e ajrit, ujit dhe tokës si dhe të reduktohen sasitë e hedhurinave të prodhuara nga instalacionet industriale dhe bujqësore.

Direktiva kërkon përfshirje të procedurës për autorizim të aktiviteteve ndotëse nëpërmjet sistemit të integruar të licencave për aktivitete për tridhjetë sektorë industrial, të numëruar në Aneks të posaçëm të Direktivës dhe kontroll të emetimeve nëpërmjet implementimit të “praktika më të mira në dispozicion”.

1.4.3.2 Direktiva 2010/75/BE për emetimet industriale

Me qëllim të avancimit të rregullores lidhur me emetimet e industrisë, më nëntor 2010, Komisioni Evropian miratoi Direktivë të re për emetime industriale (Industrial Emission Directive (IED)). Me këtë Direktivë bëhet racionalizim i legjislacionit ekologjik, përkatësisht inkorporohet Direktiva paraprake PIKN së bashku me gjashtë direktiva tjera në fushën e emetimeve industriale.

Kjo Direktivë e aplikon qasjen e integruar qëllimi i të cilës është të parandalohet dhe të zvogëlohet ndotja në të gjitha mediumet ekologjike nga impiantet e mëdha industriale në BE.

Direktiva e re, duke filluar nga 7.1.2014 i ka zëvendësuar këto direktiva:

1. Direktiva e Këshillit 96/61/KE për Parandalim të Integruar dhe Kontroll të Ndotjes;
2. Direktiva për përbërje të avullueshme organike të tretësve (1999/13/KE), e plotësuar me Rregulloren (KE) 1882/2003 dhe Direktivën 2004/42/KE;
3. Direktiva 2000/76/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit nga 4 dhjetori 2000 për djegie të hedhurinave.
4. Direktiva e Këshillit 78/176/KEE për titanium dyoksid hedhurinë industriale;
5. Direktiva e Këshillit 82/883/KEE për procedurat për mbikëqyrjes dhe monitorim të mjedisit jetësor që kanë të bëjnë me hedhurina të titanium dyoksid industrinë;
6. Direktiva e Këshillit 92/112/KEE për procedurat për harmonizim të programeve për reduktim dhe për mënjanim përfundimtar të ndotjes së shkaktuar nga hedhurinat e titanium dyoksid industrisë.

Nga 01.01.2016 IED e zëvendësoi Direktivën për impiante të mëdha për djegie 2001/80/KE.

1.4.3.3 Direktiva kornizë për hedhurina (Direktiva 2008/98/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për hedhurina)

Kjo Direktivë parasheh përfshirje të direktivave ekzistuese dhe dokumente tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin me hedhurina në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, ashtu që me këtë Direktivë zëvendësohen Direktiva 2006/12/KE për hedhurina, Direktiva 91/689/KEE për hedhurina të rrezikshme si dhe Direktiva 75/439/KEE për vajra të derdhura⁴¹.

³⁹ Listë e Direktivave të miratuara sipas fushave të paraqitura në Shtojcën 1 1

⁴⁰ Me qasje të integruar nënkuptohet që në të njëjtën kohë të merret parasysh dhe të rregullohen të gjitha emetimet në ajër, ujë dhe tokë nëpërmjet PIKN procedurës.

⁴¹ Publikuar në faqen e Komisionit Evropian, <http://ec.europa.eu/environment/waste/legislation/a.htm> [hapur më 18.06.2019]

Me miratimin e kësaj Direktive, Bashkimi Evropian synon vendosjen e kornizës juridike e cila ka qasje gjithëpërfshirëse rreth çështjes për menaxhim me hedhurinat me qëllim të mbrojtjes efikase dhe efektive të mjedisit jetësor dhe para se gjithash, shëndetit të njerëzve të cilët jetojnë në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Direktiva vendos hierarki të ashtuquajtur të hedhurinave që ka të bëjë me masat të cilat duhet të ndërmerren për mbrojtje më të mirë të mjedisit jetësor.

Direktiva parasheh obligim që secili krijues i hedhurinave të përkujdeset për trajtimin e tyre ose të njëjtat t'i siguron nëpërmjet angazhimit të kompanive apo personave tjerë. Ky obligim i krijuesit të hedhurinave në fakt është edhe një nga bazat për menaxhim efikas dhe efektiv me hedhurinat.

Krahas kësaj, Direktiva parasheh edhe trajtim të veçantë të hedhurinave të rrezikshme për t'u shmangur çfarëdo rreziku ndaj mjedisit jetësor, si dhe ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe ndalesë për përzjerje të hedhurinave të rrezikshme me hedhurina tjera të rrezikshme. Vet Direktiva parasheh obligim për monitorim të vazhdueshëm të hedhurinave të rrezikshme, përkatësisht të njëjtat të jenë të paketuara dhe të vulosura në pajtim me rregullat e Bashkimit Evropian.

Kjo Direktivë përmban dispozita me të cilat rregullohet edhe sfera e dhënies së licencave dhe regjistrimi. Përkatësisht, me këto dispozita parashihet që secila kompani apo person tjetër juridik që merret me menaxhim me hedhurina duhet të posedojë leje për menaxhim me hedhurina, të lëshuar nga organet kompetente, që duhet t'i përcaktojë sasinë dhe llojin e hedhurinave, si dhe mënyrën e menaxhimit, përkatësisht trajtimin, monitorimin dhe kontrollin të sistemit të përgjithshëm të aktiviteteve që ndërmerren gjatë menaxhimit me hedhurina.

Duke i shqyrtuar bazat e kësaj Direktive, është e qartë që Bashkimi Evropian gjithnjë e më shumë e identifikon të drejtën për mjedis jetësor të shëndoshë dhe të pastër, si një nga korpusi i të drejtave të njeriut.

1.4.3.4 Direktiva 2003/4/KE për qasje publike tek informatat për mjedis jetësor

E drejta për qasje tek informatat për mjedis jetësor në Bashkimin Evropian për herë të parë është inkorporuar në vitin 1990 me Direktivën e Këshillit 90/313/KEE për qasje të lirë tek informatat për mjedis jetësor.

Me këtë Direktivë janë vendosur bazat për qasje tek informatat për mjedis jetësor dhe është hapur proces për ndryshim në mënyrën si organet kompetente i qasen kësaj çështjeje.

Për shkak të harmonizimit të legjislationit evropian me Konventën e Aarhusit, në vitin 2003 është miratuar Direktiva 2003/4/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për qasje tek informatat për mjedis jetësor dhe për shfuqizim të Direktivës 90/313/KEE të Këshillit.

Qëllimet e kësaj Direktive janë:

- a. Qytetarët të kenë për qasje te të gjitha informatat për mjedis jetësor të cilat i posedojnë organet shtetërore; dhe
- b. mënyrë adekuate, në formë elektronike çdoherë kur është e mundur, të bëhen publikisht të arritshme informatat për mjedis jetësor, me qëllim të arrihet përhapje e informatave për mjedis jetësor në publik.

Kjo Direktivë jep përkufizime për nocionet në vijim:

“Informata për mjedisin jetësor” janë të gjitha informata në formë të shkruar, vizuale, audio, elektronike apo çfarëdo forme tjetër materiale që kanë të bëjnë me:

- (a) gjendjen e medimeve dhe resurseve në mjedisin jetësor, siç janë ajri dhe atmosfera, uji, dheu, toka, peizazhi dhe pasuria natyrore, duke i përfshirë moçalet, sipërfaqet bregore dhe detare si dhe shumëllojshmëria biologjike;
- (b) faktorë të cilët krijojnë zhurmë, rrezatim ose hedhurina, duke përfshirë edhe hedhurina radioaktive, të cilat ndikojnë apo mund të kenë ndikim negativ në mjedisin jetësor;

- (c) masa (duke përfshirë masa administrative), siç janë politika, legjislacion, plane, programe, marrëveshje dhe aktivitete ekologjike të cilat janë të dizajnuara për ta mbrojtur mjedisin jetësor;
- (d) raporte për zbatim të masave legjislative me të cilat rregullohet sektori i mjedisit jetësor;
- (e) gjendja e shëndetit dhe siguria e njeriut, lokalitetet kulturore dhe zonat natyrore veçanërisht të mbrojtura me ligj.

Qasje tek informatat për mjedis jetësor me kërkesë:

Vendet anëtare garantojnë që organet publike, gjithmonë kur prej tyre kërkohet, në pajtim me dispozitat e Direktivës, do t'i japin informatat në dispozicion për mjedis jetësor që i posedojnë me kërkesë të cilit do person të interesuar.

Në pajtim me Direktivën, informata për mjedis jetësor janë të arritshme:

- (a) sa është e mundur më shpejtë, po më së voni në afat prej një muaji pas parashtrimit të kërkesës, ose
- (b) afat prej dy muajve pas pranimit të kërkesës, nëse për shkak të vëllimit dhe kompleksitetit të informatave që janë kërkuar nuk mund të dërgohet informatë në afat më të shkurtë. Në këto raste, kërkuesit do të jenë të informuar sa është e mundur më shpejtë dhe sido që të jetë para skadimit të asaj periudhe një mujore për vazhdim të afatit për dërgim të informatave dhe shkaqet për atë.

Sa i përket qasje në drejtësi, vendet anëtare garantojnë që secili që aplikues i cili konsideron që kërkesa e tij për informata është injoruar, gabimisht e refuzuar (tërësisht apo pjesërisht), apo i është dhënë përgjigje joadekuate, ka të drejtë për qasje në procedurë në bazë të lëshimeve të organit publik, procedurë në të cilën do të rishqyrtohet lënda nga ana e organit të njëjtë apo ndonjë organi tjetër publik, ose lënda do të jepet për shqyrtim dhe veprim në trup të pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj. Çdo procedurë e këtillë duhet të jetë ekspeditive dhe falas ose e lirë.

Përveç procedurës për revizion, vendet anëtare do të sigurojnë që kërkuesi ka qasje në procedurë për revizion para gjyqit apo trup tjetër të pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj, në të cilin aktet ose lëshimet e organit publik në fjalë mund të jenë të shqyrtuara dhe vendimet e të cilit mund të bëhen finale. Shtetet mund të sigurojnë persona të tretë të cilët janë të inkrimuar me publikim të informatave gjithashtu, mund të ketë qasje në regres ligjor.

Vendimet finale janë obligative për organin publik i cili i posedon informatat. Shkaqet për refuzim të dhënies së informatat do të paraqiten në formë të shkruar, në të gjitha rastet kur ndonjë informatë kërkohet nga organi publik, ndërsa kërkesa e personit të jetë refuzuar.⁴²

Me qëllim të inkuadrimin të të drejtave dhe obligimeve nga Konventa e Aarhusit në legjislacionin e Bashkimit, Parlamenti Evropian dhe Këshilli më 26 maj 2003 e miratojnë edhe Direktivën 2003/35/KE për zbatim të pjesëmarrjes së opinionit në lidhje me miratimin e planeve dhe programeve të caktuara lidhur me mjedisin jetësor dhe për plotësim të pjesëmarrjes së opinionit dhe qasjen në drejtësi në Direktivat e Këshillit 85/337/KEE dhe 96/61/KE. Direktiva i inkuadron dispozitat nga Shtylla e dytë e Konventës së Aarhusit e cilat parasheh inkuadrim të opinionit në vendimmarrje për aktivitete konkrete (neni 6 i Konventës), në miratimin e planeve, programeve dhe politikave (neni 7) dhe të akteve normative lidhur me mjedisin jetësor (neni 8 i Konventës) me atë që e rregullon të drejtën për pjesëmarrje të publikut në direktiva tjera konkrete: Direktiva për parandalim të integruar dhe kontroll të ndotjes (PIKN) dhe Direktiva për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor (VNMJ).

Me këtë Direktivë bëhet edhe harmonizim i të drejtës për pjesëmarrje të publikut në miratim të programeve dhe planeve në pajtim me Direktivat në vijim:

⁴² Direktiva 2003/4/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga 28 janar 2003 për qasje të publikut tek informatat për mjedis jetësor dhe për shfuqizim të Direktivës 90/313/KEE të Këshillit, <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2003:041:0026:0032:EN:PDF> [hapur më 31.05.2019]

- Direktiva 75/442/KEE për hedhurina;
- Direktiva 91/157/KEE për bateri dhe akumulatorë;
- Direktiva 91/676/KEE për ndotje prej nitrateve;
- Direktiva 91/689/KEE për hedhurina të rrezikshme;
- Direktiva 94/62/KE për paketim; dhe
- Direktiva 96/62/KE për cilësi të ajrit..

Direktiva për pjesëmarrje të publikut duhet të sigurojë që organet kompetente në vendet anëtare të BE-së me kohë do ta njoftojnë publikun për procedurën për miratim apo ndryshim të planeve dhe programeve të cilat mund të kenë ndikim mbi mjedisin jetësor. Të gjitha komentet e publikut duhet të merren parasysh seriozisht dhe në fund të procedurës, organet kompetente duhet ta njoftojnë publikun për vendimin e miratuar dhe për shkaqet për miratimin e të njëjtit.

Si përgjigje ndaj avarive të shumta ekologjike, krijimin e përhapur të “pikave të nxehta ekologjike” dhe humbjen alarmante të biodiversitetit, Parlamenti Evropian dhe Këshilli e miratojnë Direktivën 2004/35/KK nga 21 prill 2004 për përgjegjësi për mjedisin jetësor në aspekt të parandalimit dhe mënjanimit të dëmit mbi mjedisin jetësor (DEO).

Direktiva ka dy qëllime themelore:

- a) të sigurojë që operatorët aktivitetet e të cilëve kanë shkaktuar dëm ekologjik do të mbajnë përgjegjësi financiare për rikuperim nga dëmi i shkaktuar; dhe
- b) të sigurojë që operatorët aktivitetet e të cilëve shkaktojnë kërcënim të drejtpërdrejtë për mjedisin jetësor janë përgjegjës për ndërmarrje të masave parandaluese në harxhim të tyre.

Për t'u aplikuar dispozitat e Direktivës, duhet të ekzistojë një ose më tepër ndotës të cilët mund të identifikohen (kriter i identifikimit); dëmi duhet të jetë konkret dhe të ekzistojë mundësi për kuantifikim të vet (kriteret për dëm të matshëm); dhe të ekzistojë lidhje e shkaqeve ndërmjet dëmit dhe operatori konkret (kriter për lidhje shkak-pasojë).

Zbatimi i mirë i Direktivës duhet të sigurojë nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit jetësor, ndërsa për zbatim të Direktivës nevojitet transponim përkatës i dispozitave në legjislacionet e vendeve anëtare.

1.4.4. Zbatim i ligjeve për mjedis jetësor në BE

1.4.4.1 Këshilli për mjedis jetësor para Bashkimit Evropian (ENVI)

Këshilli për mjedis jetësor është përgjegjës për politikën e BE-së për mjedis jetësor, duke e përfshirë edhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, shfrytëzimin modest të resurseve dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Gjithashtu merret me çështje ekologjike ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e ndryshimeve klimatike.

Në rolin e vet si krijues i politikave, Këshilli është përgjegjës për miratimin, bashkë me Parlamentin Evropian, legjislacionit ambicioz për mbrojtje të mjedisit jetësor që i mbron habitatet natyrore, mban ajër dhe ujë të pastër, siguron mënjanim të hedhurinave, e përmirëson diturinë për kimikatet toksike dhe i ndihmon bizneset të lëvizin drejt ekonomisë së qëndrueshme.

Këshilli gjithashtu siguron që aspektet ekologjike janë integruar në mënyrë të drejtë në politikat tjera të BE-së, siç janë industria, bujqësia, transporti, energjia dhe shërbimet.

Në nivel ndërkombëtar, BE-ja dhe vendet anëtare të saj synojnë standardet ekologjike të BE-së të pasqyrohen në marrëveshjet ndërkombëtare për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike.⁴³

⁴³ Konfigurim i Këshillit për mjedis jetësor (ENVI), <https://www.consilium.europa.eu/en/council-eu/configurations/env/> [hapur më 17.06.2019]

1.4.4.2 Agjencia Evropian për mjedis jetësor

Agjencia evropiane për mjedis jetësor (EEA) është agjenci e Bashkimit Evropian. Qëllimi i saj është ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të ndihmojë në arritjen e përmirësimeve të konsiderueshme dhe të matshme të mjedisit jetësor të Evropës nëpërmjet sigurimit të informatave të synuara, relevante, të sigurta dhe me kohë për krijuesit e politikave dhe për publikun. Agjencia evropiane për mjedis jetësor siguron informata stabile, të pavarura për mjedisin jetësor për ata të cilët janë të inkuadruar në zhvillim, miratim, zbatim dhe vlerësim të politikës për mbrojtje të mjedisit jetësor, si dhe të publikut më të gjerë. Në bashkëpunim të ngushtë me Rrjetin Evropian për informata dhe monitorim të mjedisit jetësor (Eionet) dhe 33 vendet e saj anëtare, Agjencia evropiane për mjedis jetësor i grumbullon të dhënat dhe prodhon vlerësime për spektër të gjerë të temave lidhur me mjedisin jetësor.⁴⁴

1.4.4.3 THEMIS

Themis është rrjet joformal rajonal i organeve nacionale përgjegjëse për menaxhim dhe mbrojtje të resurseve natyrore si dhe për zhvillim, zbatim dhe aplikim të ligjeve për mjedis jetësor, veçanërisht për ruajtje të natyrës, në vendet candidate për anëtarësim në BE, kandidatët potencial dhe vendet me marrëveshje për asocim me BE-në: Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova*, Republika e Maqedonisë së Veriut, Moldavia, Mali i Zi dhe Serbia. Kroacia është anëtare e rrjetit si vëzhgues dhe siguron ekspertizë dhe përvijë lidhur me procesin e aderimit në BE.

Misioni i rrjetit është ta mbron mjedisin jetësor nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve të anëtarëve të tij për zbatim dhe aplikim të legjislacionit për resurse natyrore dhe pylltari dhe për luftë kundër veprave penale.

Rrjeti Themis është themeluar më nëntor 2010. Lansimi i tij zyrtar është shënuar me publikimin e deklaratës së përbashkët nga ana e vendeve pjesëmarrëse dhe aprovimin e programit të parë shumëvjeçar për punë (MAP) në kontekst të konferencës për prerje ilegale dhe krime ekologjike në Budapest, Hungari. Aktivitetet të cilat zbatohet në kuadër të programeve për punë për 2012-2014 dhe 2014-2017 janë të financuara nga Bashkëpunimi zhvillimor austriak.⁴⁵

1.4.4.4 IMPEL⁴⁶ (IMPEL)

Rrjeti për aplikim dhe zbatim të ligjeve për mjedisin jetësor të Bashkimit Evropian (IMPEL) është asociacion ndërkombëtar joprofitabil i organeve për mjedis jetësor të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, kandidatëve dhe vendeve candidate për aderim në BE dhe vendet anëtare të EEA dhe EFTA.

Asociacioni është i regjistruar në Bruksel, ku gjendet edhe selia e vet juridike. IMPEL është formuar në vitin 1992 si Rrjet joformal Evropian i organeve dhe trupave rregullator të përfshirë në aplikimin dhe zbatimin e ligjeve për mjedis jetësor. Qëllimi i Rrjetit është të krijojë stimul në BE për t'u përmirësuar dhe të vjen në zbatim më efikas të legjislacionit për mjedis jetësor. Për momentin IMPEL ka 48 anëtarë nga 34 vende, këtu bëjnë pjesë të gjitha vendet anëtare të BE-së, Turqia, Shqipëria, Islanda, Zvicra, Norvegjia dhe R. e Maqedonisë së Veriut.

44 Agjencia evropiane për mjedis jetësor (EEA), <https://www.eea.europa.eu/about-us> [hapur më 23.04.2019]

45 Themis Network Europe, Artikull i publikuar në themisnetwork.eu, Publikuar në themisnetwork.eu, <http://www.themisnetwork.eu/about-themis.html> [hapur më 17.04.2019 год.]

46 Ueb faqe e Inspektoratit Shtetëror për mjedis jetësor: http://www.sei.gov.mk/projects_page_mk.asp?ID=5
European Union Network for the Implementation and Enforcement of Environmental Law (IMPEL), Ligjet për mjedis jetësor të Bashkimit Evropian (IMPEL): <https://www.impel.eu/about-impel/> [hapur më 09.05.2019]

1.5. Kornizë juridike në fqinjësi

Legjislacioni për mjedis jetësor në vendet e ish Jugosllavisë është relativisht mirë i zhvilluar. Kjo është para se gjithash për shkak të synimit të vendeve të rajonit të EJL⁴⁷ të kyçen në familjen e Bashkimit Evropian.

Pothuaj të gjitha vendet e rajonit të EJL-së në legjislacionin e tyre e inkuadrojnë edhe të drejtën për mjedis jetësor të shëndoshë.

Në Bosnje e Hercegovinë, kjo e drejtë nuk është e garantuar me Kushtetutë. Në Kosovë mbrojtja e mjedisit jetësor është një nga vlerat themelore kushtetuese, vet Kushtetuta nuk e ka njohur këtë si të drejtë të njeriut, por më tepër aplikon koncept të obligimit, duke deklaruar që mbrojtja e mjedisit jetësor, natyra dhe biodiversiteti është përgjegjësi e secilit. Ky koncept i fundit aplikohet edhe nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku përfshihet obligimi i autoriteteve për të siguruar kushte për qytetarët të jetojnë dhe të promovojnë mjedis jetësor të shëndoshë. Republika e Malit të Zi në Kushtetutën e vet e shpall vendin për shtet “ekologjik”. Në Republikën e Serbisë, e drejta për jetë e kombinuar me përgjegjësinë e shtetit dhe zonat e veta autonome është ta mbrojë mjedisin jetësor, përkatësisht ekziston obligim që për secilin të ruhet mjedisi jetësor.

E drejta për qasje në drejtësi (qasje tek informatat, pjesëmarrje në miratim të vendimeve dhe qasje në drejtësi për çështje lidhur me mjedisin jetësor) është ndryshe, por gjithsesi në shumicën e vendeve të rajonit është rregulluar edhe me Kushtetutë. Në R. e Malit të Zi, e drejta për qasje në drejtësi dhe e drejta për qasje tek informatat për mjedis jetësor janë inkuadruar në Kushtetutë. Sa i përket pjesëmarrjes, Kushtetuta e Kosovës dhe e Malit të Zi përcaktojnë që publiku duhet të inkuadrohet në proceset e sjelljes së vendimeve. Qasja në drejtësi në Bosnje e Hercegovinë është rregulluar edhe si e drejtë e njeriut për gjykim të drejtë. E gjatë është lista e legjislacionit të përgjithshëm dhe sektorial në pjesën e mjedisit jetësor të vendeve të rajonit të EJL-së. Ligji për mbrojtje të mjedisit jetësor është miratuar në Shqipëri në vitin 2011, Bosnje e Hercegovinë (subjekt i Federatës Bosnja e Hercegovina 2003, entiteti i Republikës Serpska 2002), Kosova 2005, Mali i Zi 2008, Serbia 2004 dhe Republika e Maqedonisë së Veriut 2005. Në këto shtete çështjet kryesore janë përfshirë me ligje të veçanta, siç janë ajri, uji, hedhurinat, konservimi natyral, peshkimi, xehetaria, vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor (VNMJ), parandalim i integruar dhe kontroll të ndotjes (PIKN), vlerësimi strategjik i mjedisit jetësor (SÇE) dhe ngjashëm.

1.5.1 Kroacia

Kushtetuta e Republikës së Kroacisë përmban disa dispozita të cilat e përmendin mbrojtjen e mjedisit jetësor. Neni 3 i Kushtetutës i cili, ndër të tjerat, përcakton që konservimi i natyrës dhe mjedisit jetësor të njeriut janë vlerat më të larta të rregullimit kushtetues të Republikës së Kroacisë dhe baza për interpretim të Kushtetutës. Neni 69 parasheh që secili ka të drejtë për jetë të shëndoshë dhe do të jetë i obliguar, në suaza të autorizimeve dhe aktiviteteve të saj, të përkushtojnë vëmendje të posaçme në mbrojtjen e shëndetit të njeriut, të natyrës dhe mjedisit jetësor të njeriut. Konventa e Aarhusit është tërthorazi e inkuadruar në sistemin juridik të vendit, nëpërmjet transponimit të legjislacioneve relevante të BE-së. Akti themelor i cili e rregullon mbrojtjen e mjedisit jetësor është Ligji për mbrojtje të mjedisit jetësor. Në Kroaci e drejta për qasje tek informatat për mjedis jetësor, bashkë me të drejtën përkatëse për qasje në gjykatat është rregulluar me Ligjin për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe me Ligjin për të drejtën e qasjes tek informatat.

Vendimet administrative për mbrojtje të mjedisit jetësor në instancë të parë miratohen nga ana e organeve qendrore apo rajonale/shtetërore ose trupat tjerë publik, varësisht nga çështja e cila rregullohet. Përgjithësisht, ekziston mundësi për parashtrim të ankesës në trup më të lartë

⁴⁷ Qasje në drejtësi në lidhje me mjedisin jetësor: qëndrim, shpenzime dhe ilaçe në dispozicion lidhur me Konventën për qasje tek informatat, pjesëmarrje e publikut në miratim të vendimeve dhe qasje në drejtësi në mjedisin jetësor të Evropës jug-lindore, autor Ksaba Kis

administrativ, përveç nëse ankesa është e përjashtuar me ligj ose nuk ekziston trup më i lartë (vendimi, për shembull, është miratuar nga ana e Ministrisë). Procedura për ankesë administrative është rregulluar me Ligjin për procedurë administrative. Sidoqoftë, organet kompetente si dhe trupat e apelit në çdo situatë specifike përcaktojnë cili ligj i veçantë e rregullon çështjen.

Gjykatat administrative i shqyrtojnë rastet kundër organeve publike, që i bën të rëndësishme gjykatat në sferën e mbrojtjes së mjedisit jetësor. E drejta për revizion gjyqësor kundër vendimeve individuale administrative është e garantuar me Kushtetutën e Kroacisë (neni 19/2).

Të drejtën për qasje tek informatat që i posedojnë organet publike e garanton Kushtetuta e Kroacisë. Qasja tek informatat për mjedis jetësor është e rregulluar me numër të madh të ligjeve.

Shfrytëzuesit e të drejtës për informata janë tërhequr nga pagesa e shpenzimeve administrative dhe kompensimeve në procedurat para organeve publike, të cilët gjithashtu kanë të bëjnë edhe me procedurën ankimore.

Shoqatat kanë interes të mjaftueshëm juridik në procedurat e rregulluara me Ligjin për mbrojtje të mjedisit jetësor, i cili parasheh pjesëmarrje të publikut të përfshirë, nëse i plotësojnë kërkesat në vijim: (a) nëse janë regjistruar në pajtim me dispozitat e veçanta që i rregullojnë shoqatat dhe (b) nëse mbrojtja e mjedisit jetësor, duke përfshirë edhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mbrojtjen apo shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, është përcaktuar si qëllim në Statutin.

Individët kanë të drejtë të parashirojnë ankesë nëse mund të dëshmojnë shkelje

mbi të drejtën e tyre për shkak të lokacionit dhe/ose natyrës dhe ndikimin e projektit dhe nëse kanë marrë pjesë në procedurën si publik i prekur. Gjykatat administrative kanë përgjegjësi për veprim dhe gjykim të kontesteve administrative. Ato e vlerësojnë ligjshmërinë e vendimeve administrative me të cilat autoritetet publike vendosin për të drejtat, obligimet dhe interesat juridik të palës në punët administrative dhe ligjshmërinë e akteve tjera me të cilat është shkelur e drejta, obligimi apo interesi juridik i palës.

Sipas praktikës gjyqësore kushtetuese të Gjykatës administrative të Republikës së Kroacisë, qytetarët të cilët jetojnë ose punojnë në fushë ku është e mundur apo ka mundësi të ndodhin efekt negative mbi mjedisin jetësor dhe interesi i të cilëve për ruajtjen e cilësisë së mjedisit jetësor mund të ndikohet nga ndonjë projekt, kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor edhe individualisht ose në mënyrë të organizuar si shoqata të regjistruara, grupe të personave apo vendbanime⁴⁸. Gjithashtu, ata kanë të drejtë të iniciojnë kontest administrativ para gjykatës administrative kundër vendimit të miratuar në vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor për mbrojtjen e të drejtave të tyre ose interesat e drejtpërdrejta personale në bazë të ligjit.⁴⁹

Secili që konsideron se të drejtat e tij apo të saj janë shkelur, ka të drejtë ta konteston vendimin administrativ, në bazë të Ligjit për konteste administrative.

Ligji për mbrojtje të mjedisit jetësor nga viti 2007 e kufizoi të drejtën për të kontestuar vendim administrativ vetëm për ata persona që kanë marrë pjesë në procedurën si publik i prekur dhe të cilët mund të dëshmojnë shkelje të së drejtës së tyre për shkak të lokacionit dhe/ose natyrës dhe ndikimin e projektit (dhe dy kushtet që duhet të plotësohen). Prandaj, rregullat e përgjithshme të Ligjit për konteste administrative janë më të volitshme nga rregullat e Ligjit për mbrojtje të mjedisit jetësor. Kriteret e OJQ janë të njëjta siç është përshkruar për këqyrjen administrative. Procedurat gjyqësore në rastet lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor janë urgjente. Megjithatë, kjo përcakton që urgjenca vlen vetëm për procedurat e iniciuara në pajtim me Ligjin për mbrojtje të natyrës, parimi i urgjencës nuk aplikohet, madje edhe kur padia është parashtruar me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor.

48 Raporti kombëtar për implementimin e Konventës së Aarhusit, 2017. Rastet Us1149 / 97 Us-89/01 https://apps.unece.org/ehlm/pp/NIR/listnr.asp?YearID=2017&wf_Countries=MK&wf_Q=QA&QuerID=&LngIDg=EN&YearIDg=2017 [hapur më 08.05.2019]

49 Raporti kombëtar për implementimin e Konventës së Aarhusit, 2017. Rastet Us-7555/2004-5 https://apps.unece.org/ehlm/pp/NIR/listnr.asp?YearID=2017&wf_Countries=MK&wf_Q=QA&QuerID=&LngIDg=EN&YearIDg=2017, [hapur më 08.05.2019]

Ligji nuk përcakton afate kohore në të cilat gjykata duhet të vendos për lëndën, pra interpretimi i nocionit “urgjente” në procedurat e iniciuara në pajtim me Ligjin për mbrojtje të mjedisit jetësor, më së shpeshti bëhet e drejtë diskrete e gjyqit. Gjykatat duhet të kenë instruksione të qarta lidhur me domethënien e parimit të urgjencës. Ato mund të përfshijnë vendosje të afateve për: lëshim të ndalesës preliminare, prenotim të seancave dëgjimore si dhe për miratim të vendimeve.

1.5.2 Kosova

Ligji për mjedis jetësor në Kosovë⁵⁰ bazohet në tre burime: Kushtetuta, ligjet e miratuara nga Kuvendi dhe aktet nënligjore të miratuara në lidhje me çështjet për mjedisin jetësor.

Kushtetuta e miratuar në vitin 2008, e përkufizon mbrojtjen e mjedisit jetësor si një nga vlerat themelore. Në Kushtetutë nuk është garantuar e drejta për mjedis jetësor të shëndoshë, mirëpo në nenin 52 (Përgjegjësi për mjedis jetësor) është paraparë që mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit, mjedisi jetësor dhe trashëgimia natyrore janë përgjegjësi e secilit, që e nënkupton interesin publik.

Krahas kësaj, Neni 52 i Kushtetutës së Kosovës u jep të drejtë të gjithëve “të jenë të dëgjuar nga institucionet publike dhe i shqyrtojnë mendimet e tyre për çështjet që ndikojnë mbi mjedisin jetësor në të cilin jetojnë”, që donë të thotë se përdoret parimi i pjesëmarrjes së publikut në Konventën e Aarhusit në nivel kushtetues. Kushtetuta obligon në nenin 45 paragrafi (3), institucionet shtetërore të mundësojnë “çdo person të marrë pjesë në aktivitetet publike”, me atë që do t’u mundësojë të gjithë të ndikojnë në mënyrë demokratike mbi vendimet e trupave publik.

Në Kushtetutë, neni 22, në mënyrë taksative është përmendur në aplikim i drejtpërdrejtë i disa marrëveshjeve kritike ndërkombëtare për të drejta të njeriut, të cilat dominojnë mbi ligjet vendit. Ekzistojnë numër i madh i ligjeve të rëndësishme për mjedis jetësor të cilat janë në fuqi. Legjislacioni sekondar në sferën e të drejtës për mjedis jetësor zakonisht lëshohet me autorizim eksplicit me dispozitë ligjore për zbatim të dispozitave ligjore.

Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor është më përgjegjëse për zbatimin e të drejtës ekologjike. Ministria është përgjegjëse për koordinim të aktiviteteve në fushën e mjedisit jetësor me qëllim të promovohet zhvillim koherent i politikave për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Kosova ende nuk e ka ratifikuar Konventën e Aarhusit dhe ky është shkak përse e njëjta nuk aplikohet drejtpërsëdrejti gjatë procedurave gjyqësore. Deri tani vetëm Gjykata Kushtetuese ka bërë rekomandim për Konventën e Aarhusit në rastin, Hoxha et.al v. Kuvendit komunal në Prizren, rast në të cilin Komuna nuk është konsultuar me qytetarët në revidimin e Planit urbanistik komunal.

Kontestet ekologjike mund të jenë konteste në të drejtën administrative ose civile, pra ashtu do të jenë lëndë të cilat mund të referohen edhe në bazë të Ligjit për ndërmjetësim.

Sa i përket miratimit të vendimeve lidhur me çështjet nga sfera e mjedisit jetësor dhe këqyrjes administrative, ligjet sektoriale për mjedis jetësor nuk e sigurojnë të drejtën e publikut (individë, grupe individësh, organizata joqeveritare, subjekte tjera) t’i konteston ligjshmërinë thelbësore dhe/ose procedurale të vendimeve administrative lidhur me mjedisin jetësor.

Ligji për mbrojtje të mjedisit jetësor jep vetëm të drejtë për t’u parashtruar kërkesë në gjykatën kompetente apo organin publik në të cilin kërkohet zbatim adekuat i Ligjit apo ndonjë akti normativ nënligjor. Parakusht është të gjithë personat fizik dhe juridik si dhe publiku të pësojnë dëm material apo të jenë të ballafaquar me ndonjë kërcënim serioz nga vuajtja prej ndonjë dëmi material, që mund t’i përshkruhet ndonjë aktiviteti apo burimi të ndotjes të cilat janë në kundërshtim me Ligj apo ndonjë akt normativ nënligjor. Megjithatë, Ligji nuk ka siguruar pjesë për mbrojtjen e të drejtës për shëndet dhe mjedis jetësor të shëndoshë. Për atë shkak, personi (qytetari apo person tjetër fizik apo juridik, grupet e tyre, shoqata dhe organizata) që dëshmon se ka interes legjitim dhe personi i cili për shkak të lokacionit të projektit dhe/ose për shkak

⁵⁰ Rajon nën administratën e Kombeve të Bashkuara, Këshillit për siguri rezoluta 1244 (1999)

të natyrës së projektit mund të vërtetohet në pajtim me ligjin që kërkesat e tij kanë qenë të shkelura në bazë permanente, ka të drejtë ta kontestojë ligjshmërinë procedurale dhe materiale të vendimeve, aktet apo lëshimet e autoriteteve publike para organit kompetent dhe/ose gjykatës kompetente.

Publiku (individë, grupe individësh, organizata joqeveritare, subjekte tjera) ka të drejtë në procedurë administrative t'i kontestojë aktet/lëshimet nga ana e personave privat dhe organeve publike që janë në kundërshtim me ligjin që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor (neni 9 paragrafi (3) i Konventës së Aarhusit). Qytetarëve u lejohej ta plotësojnë këtë rol në mënyrë që do të mund të parashtronjë ankesë administrative në trupin administrativ, agjenci, për shembull inspektorati për mjedis jetësor kërkon nga organi kompetent administrativ t'i kryen detyrat e veta të posaçme statutore për t'i adresuar veprimet/lëshimet nga ana e personave privat, që janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për mjedis jetësor⁵¹.

Kontestet ekologjike janë të ndërlikuar dhe mund të përfshijnë individë, publik më të gjerë, më tepër kompetenca rregullatore dhe interesa të veçantë. Në rast të këqyrjes gjyqësore të aktit administrativ lidhur me mjedisin jetësor, kompetencat i përket Seksionit Administrativ të Gjykatës themelore në Prishtinë.

Ekzistojnë tre lloje të procedurave gjyqësore që mund të iniciohen kur është parashtruar ankesë në lidhje me mjedisin jetësor, përkatësisht: (1) Procedura administrative gjyqësore para Gjykatës themelore në Prishtinë; (2) Procedura gjyqësore civile para Gjykatës themelore (procedurë për ripërpunim të mjedisit jetësor); (3) Procedura e Gjykatës Kushtetuese në bazë të padisë individuale kushtetuese për të drejtat për qasje tek informatat për mjedis jetësor apo shkelje të supozuar të pjesëmarrjes së publikut.

Gjykatësit nuk kanë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme me legjislacionin që ka të bën me mjedisin jetësor. Nuk ekzistojnë mendime këshillëdhënëse të Gjykatës Supreme për çështjet lidhur me mjedisin jetësor, ndërsa gjatë kësaj nuk është e mundur të inkuadrohen as profesionist (me ekspertizë) në procedurat gjyqësore si anëtarë në tribunin gjyqësor lidhur me rastet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Gjykatat nuk kanë përgjegjësi t'i hulumtojnë detajet për rastet, barra e të dëshmuarit është e palëve.

Ligjit themelor numër 03/L-215 për qasje në dokumentet zyrtare e garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik për të pasur qasje, pa diskriminim në çfarë do baze, me kërkesë paraprake, në dokumente zyrtare që i mbajnë, përgatisin ose pranojnë institucionet publike. Ligji aplikohet në të gjitha institucionet në nivel qendror dhe lokal, duke i përfshirë edhe gjykatat. E drejta për qasje tek informatat, gjithashtu është paraparë me Ligjin për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Ligji në nenin 54 parasheh që të gjithë personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të jenë të informuar për gjendjen e mjedisit jetësor dhe të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes. Sipas Ligjit, informatat për mjedisin jetësor janë të gjitha informatat në formë të shkruar, vizuale, elektronike apo formë tjetër për gjendjen e elementeve të mjedisit jetësor, masat, raportet, analizë të shpenzimeve dhe benefiteve dhe të gjendjes së shëndetit të njerëzve.

Ligji për qasje tek informatat nuk siguron rregulla në lidhje me mjetet juridike në dispozicion në rast se refuzohet kërkesë për informata për mjedisin jetësor. Në pajtim me Ligjin për procedurë administrative, "cila do palë e interesuar ka të drejtë për ankesë kundër ndonjë akti administrativ apo kundër refuzimit joligjor të lëshohet akt administrativ".

Mungesa e vetëdijes juridike për t'u kërkuar revidim administrativ apo gjyqësor është ndoshta shkakton kryesor për refuzim të kërkesave për qasje tek informatat për mjedis jetësor. Tjera na shkaqet janë shkathtësitë juridike për formulim të ankesave administrative, mungesë e mjeteve financiare për angazhim të përfaqësuesit juridik si dhe ndihmë joadekuate dhe e pamjaftueshme

⁵¹ Qasje në drejtësi lidhur me mjedisin jetësor: Qëndrim, shpenzime dhe mjete në dispozicion lidhur me Konventën për qasje tek informatat, pjesëmarrje të publikut në miratim të vendimeve dhe qasje në drejtësi në mjedisin jetësor të Evropës juglindore, autor Ksaba Kis http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.j/AlyticalStudies/SEE_Access2Justice_Study_Final_logos.pdf [hapur më 13.06.2018]

juridike falas e qendrave përkatëse për t'u ndihmuar atyre që janë të gatshëm t'i kontestojnë vendimet e trupave administrativ në lidhje me qasjen tek informatat për mjedis jetësor.

Sa u përket shpenzimeve të procedurës, nuk ekzistojnë implikime/harxhime financiare lidhur me ankesën administrative për çështjet lidhur me mjedisin jetësor. Tarifat për këshillim juridik janë përcaktuar nga Oda e avokatëve të Kosovës. Përfaqësimi juridik në procedurën për ankesë administrative nuk është i detyrueshëm. Shpenzimi kontesteve është i tillë që korniza ekonomike për sistemin e shpenzimeve ka ndikim të konsiderueshëm mbi vendimet e palëve potenciale për atë nëse duhet të padisin apo ta zgjidhin kontestin.

Mund të konstatohet që, sfidat kryesore praktike lidhur me përpunim të rasteve që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor janë:

- Mungesa e vetëdijes juridike ndërmjet individëve dhe organizatave joqeveritare për mundësinë për ankesë kundër vendimeve administrative;
- Mungesa e mekanizmave për ndihmë juridike falas për mbështetje të individëve apo organizatave joqeveritare të interesuara të parashtrojnë ankesa në pajtim me ligjin e zbatueshëm;
- Mungesa e avokatëve/specialistëve juridik kompetent për përballim me ankesat administrative për mjedisin jetësor;
- Mungesa e kurseve të specializuara nga sfera e të drejtës për mjedis jetësor në nivel të arsimit të lartë për zhvillim të shkathtësive juridike të studentëve.

Duhet të përmendet që ekziston numër i vogël i rasteve kur organizatë joqeveritare në cilësi të paditësit ka parashtruar procedurë para gjyqit në emër të interesit publik. disa nga sfidat përfshijnë edhe rrezik për përsëritje të dëmit mbi mjedisin jetësor, kur aktgjykimi i gjyqit nuk mund të përmbahet.

1.5.3 Bosnja e Hercegovina

Nivelet e larta dhe të ulëta në Bosnje e Hercegovinë funksionojnë në varësi të ndërsjellët. Në nivel shtetëror janë pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, kurse nivelet më të ulëta të pushtetit funksionojnë në suaza të njësive të ndara administrative – dy entitetet në Federatën Bosnje e Hercegovinë dhe Republika Serpska, si dhe në qarkun Bërçko në Bosnje e Hercegovinë. Shteti edhe më tutje është i ndarë në mënyrë administrative në dhjetë kantone, për dallim prej Republikës Serpska. Njësitë e vetëqeverisjes lokale janë identike me ato në nivel shtetëror, të përbëra nga qytetet, komunat dhe bashkësitë lokale.

Mbrojtja e mjedisit jetësor është mundësuar nëpërmjet llojeve të ndryshme të mbrojtjes juridike, duke e përfshirë të drejtën administrative, veçanërisht Konventën e Aarhusit dhe Ligjin për mbrojtje të mjedisit jetësor, si dhe të drejtën ndëshkimore, Ligjin për kundërvajtje dhe të drejtën civile.

Zbatimi i Konventës së Aarhusit dhe i akteve për liri për qasje tek informatat është obligativ nga data e ratifikimit nga ana e Bosnje e Hercegovinës.

E drejta për qasje të lirë tek informatat mundëson që secili person të ketë të drejtë për qasje tek informatat e kontrolluara nga autoritetet publike, në shkallën më të lartë të mundur në pajtim me interesin publik, duke e pasur parasysh që ata e përfaqësojnë të mirën publike dhe se qasja e publikut tek informatat promovon transparencë dhe përgjegjësi të këtyre organeve në raport me Konventën e Aarhusit dhe ligjet për mjedis jetësor.

Vëmendje më e madhe në dispozitat për mbrojtje të mjedisit jetësor përkushtohet në të drejtën për qasje tek informatat dhe prandaj pothuaj të gjitha aktgjykimet e grumbulluara të gjykatave në BeH në vitin 2012 vlejnjë për zbatimin e Ligjit për qasje të lirë tek informatat, është e dobishme dhe e domosdoshme të diskutohet për shfrytëzim të mjeteve juridike për qasje në vendimet për informim të organeve kompetente.

Përfundimisht, Konventa e Aarhusit në shtyllën e saj të tretë e parasheh të drejtën për qasje në drejtësi nëpërmjet procedurave për kontestim të veprimeve dhe lëshime nga ana e personave privat dhe organe publike që janë në kundërshtim me dispozitat na legjislacioni i saj nacional lidhur me mjedisin jetësor. Instrumente juridike në lidhje me këtë dispozitë janë paraqitur në ligjet për procedurë civile të miratuara në BeH, si dhe në Ligjin për marrëdhëniet kontraktuese. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet që Ligji për procedurë civile i Republikës Serpska në amendamentet e tij nga viti 2013 e inkorporoi idenë për padi për mbrojtje të interesit të përbashkët/publik.

Shoqatat, institucionet ose organizatat tjera që e mbrojnë kolektivin e përcaktuar ligjor të interesave dhe të drejtave të qytetarëve, mund të ngrenë padi për mbrojtje të interesit të përbashkët/publik, kur organi me mos/aktivitet të caktuar seriozisht i shkel apo i rrezikon interesat dhe të drejtat e përbashkëta

1.5.4 Shqipëria

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe numër i caktuar i ligjeve i rregullojnë çështjet lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor. Nga nënshkrimi i Konventës së Aarhusit nga Shqipëria në vitin 1998, deri në ratifikimin në vitin 2001, janë ndërmarrë shumë masa për intensifikim të zbatimi të kërkesave të parapara.

Individë, grupe dhe organizata joqeveritare kanë të drejtë drejtpërsëdrejti të parashtrojnë ankesë në Gjyq vetëm nëse kjo është paraparë ashtu me ligj.

Nuk ekziston dallim fundamental ndërmjet kushteve për pozitën juridike të individëve dhe për organizatat joqeveritare. Publiku ka të drejtë ta konteston ligjshmërinë thelbësore dhe procedurale të vendimeve në procedurë administrative. Nuk ka actio popularis të garantuar në legjislacionin nacional. Organet për shqyrtim të procedurës administrative mund t'i ndërmarrin këto aktivitete: a) konfirmim të rëndësisë së aktit dhe refuzim të ankesës; b) shfuqizim të aktit dhe miratim të ankesës; v) ndryshim të aktit administrativ.

Ekzistojnë numë i madh i mungesave në legjislacionin shqiptar të cilat tërthorazi ndikojnë për parandalim të publikut të veprojë sipas të njëjtave. Disa prej tyre janë:

- Mungesë e informatave përkatëse për publikun (individë dhe organizata joqeveritare) në lidhje me të drejtën për ankesë kundër vendimeve ekologjike dhe njohja e kufizuar e të drejtave;
- Mungesë e ndihmë juridike falas të cilën e siguron shteti (përveç në lëndë penale);
- Mungesë e avokatëve për përfaqësim të lëndëve të interesit publik;
- Mungesë e moduleve ekologjike për trajnim të studentëve/juristëve të ri..

Nga aspekti juridik, mjetet juridike në rastet e kontestimit të vendimeve/akteve në gjyq dhe të përshtatshëm janë edhe trupa tjerë. Pengesat kryesore me të cilat kufizohet aplikimi i ndalesave gjyqësore për çështje lidhur me mjedisin jetësor janë e drejtë diskrete e gjykatësve të cilët nuk kanë njohuri përkatëse për ligjin për mjedis jetësor, mungesa për pavarësi gjyqësore, zbatimi joadekuat i ndalesave gjyqësore dhe ngjashëm.

Sa u përket shpenzimeve financiare me ankesë administrative (në lidhje me rastet e përfshira me nenin 9, paragrafët (1), (2) dhe (3), legjislacioni shqiptar nuk parasheh asnjë harxhim lidhur me ankesën administrative për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Përfaqësimi juridik në procedurën për ankesë administrative nuk është obligativ. Shpenzime tipike joadministrative dhe jashtëgjyqësore (jashtë secilës procedurë) për raste ekologjike, në procesin e përgatitjes së procedurës ankimore administrative janë:

- Përfaqësues;
- Ekspertizë shkencore (duke përfshirë shpenzime për analizë laboratorike si dhe për përgatitje të raportit të ekspertëve i ashtuquajtur ekspertizë);

- Shpenzime për grumbullim të provave (duke përfshirë edhe shpenzime transporti/akomodim, incizim të dëmeve të shkaktuar mbi mjedisin jetësor, etj).

Sa i përket taksave gjyqësore dhe shpenzimeve tjera lidhur me shqyrtimin e rastit në procedurë gjyqësore, të njëjtat përlogariten me qëllim të garantohet padia. Shuma e shpenzimeve nuk varet nga ajo nëse paditësi është person fizik, grup individësh, organizatë joqeveritare apo entitet i tretë, ose i llojit të rastit (interes privat, interes publik); apo i llojit të procedurave gjyqësore. Lartësia e shpenzimeve varet nga e ashtuquajtura vlerë e rastit.

Shpenzimet gjyqësore lidhur me grumbullimin e provave apo pjesëmarrje të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë shqyrtimit të rastit, janë paraqitura nga pala e cila ka kërkuar prova. Pavarësisht cili është aplikues për rastin, individ ose organizatë joqeveritare, nuk ekziston dallim në përcaktim të lartësisë së shpenzimeve.

Në Shqipëri nuk ekziston mekanizëm për ndihmë juridike falas. Ka avokatë dhe organizatat të cilat punojnë në sferën e mjedisit jetësor, mirëpo ato nuk sigurojnë ndihmë juridike falas për çështjet lidhur me mjedisin jetësor nga ana e OJQ-ve, avokatëve ose firmave juridike. Organizatat joqeveritare ekologjike nuk fitojnë mjete nga buxheti të cilat mund t'i shfrytëzojnë për procedura gjyqësore.

Pengesat kryesore në qasjen në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor në Shqipëri përfshijnë:

- Shpenzime të larta gjyqësore;
- Kompensime të larta për paditësit;
- Mungesë e mjeteve financiare për mbulim të shpenzimeve për avokatë dhe ekspertë;
- Mungesë e ndihmës juridike falas të cilën e siguron shteti (përveç në lëndë penale);
- Mungesë e vetëdijes dhe njohje të Konventës së Aarhusit në gjyqësor;
- Mungesë e avokatëve të cilët e përfaqësojnë interesin publik;
- Mungesë e sanksionit në legjislacion për rastet kur nuk jepen informata;
- Mungesë e procedurave të qarta në rast të padive administrative;
- Mungesë e personelit të kualifikuar në institucionet qeveritare në sferën e mjedisit jetësor;
- Mungesë e kufizimit kohor të licencave ekologjike.

1.5.5 Konventa e Aarhusit në rajon

Republika e Maqedonisë së Veriut, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia e kanë ratifikuar Konventën e Aarhusit. Autoritetet shtetërore nuk e aplikojnë drejtpërsëdrejti, më së shpeshti për shkak të nevojë për harmonizim të legjislacionit nacional për zbatim (Shqipëria, Mali i Zi), por edhe për shkak të interpretimit të dyshimtë të dispozitave kushtetuese për mundësi zbatimi të drejtpërdrejtë të konventave ndërkombëtare. Në Bosnje e Hercegovinë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, e drejta ndërkombëtare konsiderohet si e nivelit më të lartë në krahasim me të drejtën e vendit, për çka autoritetet publike janë në pozicion drejtpërsëdrejti ta zbatojnë Konventën. Megjithatë, në praktikë nuk ka shumë shembuj. Në Serbi, normat ndërkombëtare janë, gjithashtu pjesë përbërëse e sistemit juridik të vendit dhe si të tilla janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme.

Në Shqipëri ekziston ligj i veçantë për lëshim të licencave ekologjike, duke i ndarë aktivitetet në 3 kategori dhe ndarja e llojeve përkatëse të licencave, siç janë A, B dhe V. Shqipëria është vendi i vetëm në rajon që ka Qendër Nacionale për Licencim, ku parashtrohen të gjitha kërkesat për licenca. Në Serbi dhe Maqedoni licencat e tilla mund t'i lëshojë Ministria/Agjencia për mjedis jetësor, zonat autonome dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.

1.6 Hyrje – zhvillim i politikave dhe legjislacionit të Maqedonisë

Normat ndërkombëtare dhe rajonale janë komplementare dhe kërkojnë implementim nacional për të qenë efektive. Normat nacionale duhet të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe rajonale. Me mekanizmat ndërkombëtar dhe rajonal mundësohet mbrojtje juridike kur janë apsolvuar të gjitha mjetet/mundësitë nacionale juridike.

Republika e Maqedonisë së Veriut, si shtet anëtar i OKB-së dhe Këshillit të Evropës, i ka ratifikuar dokumentet ndërkombëtare (Shtojca 2 – listë e instrumenteve të ratifikuara) dhe ato, në pajtim me nenin 118 të Kushtetutës, janë pjesë përbërëse e sistemit juridik të vendit. Me ratifikimin e dokumenteve ndërkombëtare, shteti ndërmerr obligim për respektim, mbrojtje dhe garantim të të drejtave të njeriut të inkuorporuara në legjislacionin vendas. Ky obligim kërkon që shteti të ndërmarrë masa përkatëse ligjore, administrative, buxhetore, gjyqësore dhe të tjera në drejtim të realizimit të plotë të të drejtave të njeriut:

Të respektohet e drejta donë të thotë shteti të përmbahet prej ndikimeve në realizimin e të drejtave. Të mbrohet e drejta donë të thotë të miratojë dhe zbatojë ligje të cilat krijojnë mekanizma, institucione dhe procedura me të cilat parandalohet shkelje e të drejtave nga autoritetet shtetërore ose nga entitetet tjera. Kjo mbrojtje duhet të sigurohet në mënyrë të barabartë për të gjithë. Të garantohet e drejta donë të thotë shteti të ndërmarrë masa aktive dhe të siguron resurse (koordinim, promovim dhe mundësimin e të gjitha kushteve për plotësim) me qëllim t'u mundësojë qytetarëve t'i gëzojnë të drejtat e tyre.

1.6.1 Harmonizim me *acquis* komunitare në sferën e mjedisit jetësor dhe qasje në drejtësi

Në Raportin e fundit të Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2019 për **Kapitullin 27: Mjedis jetësor dhe ndryshime klimatike**, thuhet::

Vendi është në nivel të caktuar të përgatitjes në këtë sferë. Është realizuar progres i kufizuar në harmonizimin e mëtutjeshëm të politikave dhe të legjislacionit me *acquis* në sektorët për ujë, mbrojtje të natyrës dhe hedhurina. Zbatimi dhe implementimi stagnojnë. Vitin e ardhshëm vendi duhet veçanërisht::

- T'i zbatojë masat për përmirësim të cilësisë së ajrit nëpërmjet sigurimit të koordinimit efikas ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale dhe shpërndarje të resurseve të mjaftueshme financiare;
- T'i zbatojë planet e miratuara rajonale për menaxhim me hedhurina dhe të vendos sistem rajonal të integruar për menaxhim me hedhurina;
- Zbatim i Marrëveshjes së Parisit nëpërmjet zhvillimit të Strategjisë gjithëpërfshirëse për aksion lidhur me klimën, në pajtim me kornizën e BE 2030 dhe fillim të procesit të përpilimit të Planit nacional për energji dhe klimë, në pajtim me obligimin e Komunitetit energjetik.

Në lidhje me mjedisin jetësor përmendet që: Kapaciteti administrativ në nivel qendror dhe lokal mbetet i dobët dhe i pamjaftueshëm. ... Nevojitet të përmirësohet zbatimi i Procesit për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe konsultimet publike në nivel lokal. Nuk ka progres lidhur me miratimin e Ligjit për inspektim në mjedisin jetësor dhe Direktivat për përgjegjësi të mjedisit jetësor, INSPIRE dhe Direktiva për krim ekologjik ende nuk janë të harmonizuara dhe të zbatuara tërësisht.

Në lidhje me harmonizimin e kornizës juridike për ndryshime klimatike, me *acquis*, vendi është ende në fazë të hershme. Kapacitetet teknike, institucionale dhe administrative mbesin të dobëta dhe nevojitet të fuqizohen në të gjitha nivelet.

Sa u përket të drejtave themelore thuhet: ... korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe mbetet çështje shqetësuese. Korniza juridike dhe politike për të drejta themelore është përgjithësisht e vendosur dhe Avokati i Popullit ka fituar obligime shtesë. Janë bërë përpjekje për përmirësim të gjendjes me të drejtat e njeriut në praktikë, mirëpo nevojitet përcaktim i

konsiderueshëm i mjeteve dhe lidship i fuqishëm për t'u siguruar zbatim dhe qëndrueshmëri e masave që janë ndërmarrë.

Në lidhje me të drejtat themelore, nevojitet zbatim i rekomandimeve nga trupat ndërkombëtar evropian për të drejta të njeriut, të cilat duhet të shpërndahen në mënyrë sistemore.

Gjithashtu nevojitet zbatim i Ligjit të ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe harmonizim të ligjeve tjera.

Në lidhje me funksionimin e sistemit juridik thuhet: Sistemi jurisprudencës ka arritur shkallë të caktuar të gatishmërisë/është mesatarisht i përgatitur. Është arritur progres i mirë lidhur me "Reformat urgjente prioritare" dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias si dhe të Grupit të lartë të ekspertëve për çështje sistemore për sundimin e të drejtës. Komisioni i Venecias i lavdëroi përpjekjet e vazhdueshme të organeve për harmonizim të rregullave me të cilat rregullohet sistemi e jurisprudencës në pajtim me standardet dhe praktikat ndërkombëtare.

Sa i përket cilësisë së drejtësisë: ... Nevojiten përpjekje për përmirësim të përdorimit të zgjidhjes alternative të kontesteve. Arbitrazhi ende nuk konsiderohet si vegël e qëndrueshme për t'u siguruar drejtësi, qoftë nga palët apo nga gjykatat. Efektet e zbatimit të ligjit të ri për ndërmjetësim, të miratuar më vitin 2013 ende duhet të vlerësohen.

Është evidente që nevojiten përpjekje më të mëdha edhe në fushën e mjedisit jetësor, veçanërisht lidhur me zbatimin e neneve nga Konventa e Aarhusit dhe me harmonizimin me standardet ndërkombëtare, por edhe në fushën e qasjes në drejtësi në procesin para aderimit në BE.

1.6.2 Kushtetuta e RMV-së dhe mjedisi jetësor

E drejta për mjedis jetësor të shëndoshë në sistemin juridik të R. së Maqedonisë së V. është paraparë si një nga vlerat themelore të rregullimit kushtetues të vendit. Sipas nenit 8, në vlera themelore të rregullimit kushtetues janë përmendur "liri dhe të drejta themelore të njeriut të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë" dhe "rregullim, humanizimi i hapësirës dhe mbrojtje si dhe avancimi i mjedisit jetësor dhe respektimi i normave përgjithësisht të pranura të të drejtës ndërkombëtare".

Në pajtim me Kushtetutën, garantohet e drejta për ankesë kundër vendimeve të miratuara në procedurë në shkallë të parë para gjykatës. E drejta për ankesë apo lloj tjetër i mbrojtjes juridike kundër akteve individuale juridike të miratuara në procedurë të shkallës së parë para organit të drejtorisë shtetërore apo organizatë dhe organ tjetër i cili kryen autorizime tjera rregullohet me ligj.

Gjithashtu, garantohet liria e bindjes, vetëdijes, mendimit dhe të shprehurit publik të mendimit, liria e të folurit, performanca publike, informimit publik dhe themelimit të lirë të institucioneve për informim publik, qasja e lirë tek informatat, liria për pranim dhe transferim të informatave. Megjithëse secilit qytetar i garantohet respektim i mbrojtjes së privatësisë së jetës së tij personale dhe familjare, të dinjitetit dhe reputacionit, prapë se prapë Kushtetuta e mbron edhe interesin publik, që nuk guxon të jetë në konflikt me interesin privat, përkatësisht interesi publik është mbi interesin privat.

Në Kushtetutën e R. së Maqedonisë së V. krahas inkorporimit të të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë, në Kapitullin II – Liri dhe të drejta themelore të njeriut dhe qytetarit Nënkapitulli 2 - **Ekonomike, sociale dhe kulturore**, në mënyrë plotësuese është rregulluar e drejta për mjedis jetësor. Përkatësisht, në nenin 43 paragrafi (1) është paraparë që "Çdo njeri ka të drejtë për mjedis jetësor të shëndoshë. Secili ka për detyrë ta avancojë dhe mbron mjedisin jetësor dhe natyrën." Së këtejmi, e qartë është që baza e të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë qëndron, në fakt, në obligimin qytetarët ta mbrojnë mjedisin jetësor. Kjo e drejtë është e drejta e vetme në të cilën të gjithë kanë obligim i cili është ngushtë i lidhur me realizimin e të njëjtës.

Përveç kësaj, në nenin e njëjtë 43, në paragrafin (2), është paraparë që "Republika siguron kushte për realizimin e të drejtës së qytetarëve për mjedis jetësor të shëndoshë", me çka në

fakt garantohet që shteti do të sigurojë kushte për realizimin e të drejtës për mjedis jetësor të qytetarëve.

Pikërisht ky hap me të cilin në mënyrë plotësuese është garantuar e drejta për mbrojtje dhe avancim të natyrës së njeriut është në hap me tendencën botërore të promovimit dhe përfaqësimit të të ashtuquajturës “gjeneratë e tretë” e të drejtave në pajtim me cilën rrethina e njeriut është një nga nevojat themelore, pra, së këtejmi edhe mbrojtja e të njëjtës është një nga të drejtat themelore të njeriut.

Krahas garantimit të drejtpërdrejtë të të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë, Kushtetuta në nenin 55 parasheh që “... Liria e tregut dhe sipërmarrësisë mund të kufizohen me ligj vetëm për mbrojtjen e Republikës, ruajtjen e natyrës, mjedisit jetësor ose shëndetit të njerëzve.”

Në këtë nen tërthorazi garantohet mbrojtja e mjedisit jetësor, përkatësisht vendosen kufizime në drejtim të lirisë së tregut dhe sipërmarrësisë, me qëllim të që të njëjtat të zhvillohen pa rrezik ndaj mjedisit jetësor të shëndoshë të njerëzve.

1.6.2.1 Pjesëmarrje e publikut në krijim të politikave

Konventa e Aarhusit si marrëveshje ndërkombëtare është një nga instrumentet më të rëndësishme për mbrojtje të të drejtës së qytetarëve për mjedis jetësor të shëndoshë. Publiku ka të drejtë dhe duhet të jetë i informuar, të marrë pjesë në vendimmarrje për çështjet për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe të ketë qasje të lirë tek e njëjta.

Implementimi i Konventës së Aarhusit⁵² mundëson përmirësim të qasjes tek informatat, rritje të pjesëmarrjes së publikut në procesin e miratimit të vendimeve me të cilin përmirësohet cilësia e vendimeve dhe gjithë kjo do të rezultojë me përmirësim të cilësisë së mjedisit jetësor. Implementimi i Konventës së Aarhusit kontribuon për mbrojtjen e të drejtës së të gjithë qytetarëve të jetojnë në mjedis i cili është i përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe t’i sigurojë, për të drejtën për qasje tek informatat, pjesëmarrje të publikut në miratim të vendimeve dhe qasje në drejtësi për çështje lidhur me mjedisin jetësor, ndërsa në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor.

Krahas dispozitave dhe politikave të përgjithshme, lëndët të cilat shkaktojnë ndikime të caktuara mbi mjedisin jetësor, shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve, janë të përkufizuara edhe me akte të veçanta ligjore, të cilat prej së afërmi rregullojnë aktivitetet të caktuar ekonomik. Pjesë e zgjidhjeve ligjore e përfshijnë të drejtën e pjesëmarrjes së publikut në procedurat dhe informimit me kohë. Krahas kësaj, rregullat për pjesëmarrje të publikut janë aplikueshme çdoherë kur organet kompetente do të bëjnë ndryshim në ndonjë nga lejet që kanë të bëjnë me aktivitetet e përmendura në Aneksin I të Konventës së Aarhusit. Në anën tjetër, gjithmonë kur bëhen ndryshime të projekteve që u nënshtrohen rregullave për vlerësim të ndikimeve mbi mjedisin jetësor, pavarësisht nëse për objektin kryesor ka qenë obligative të përpunohet vlerësim i ndikimeve mbi mjedisin jetësor. Nëse organet kompetente përcaktojnë që ndryshimet e projektit nuk do të rezultojnë me ndikime mbi mjedisin jetësor – Ministria për Mjedis Jetësor menaxhim me autorizim të caktuar diskret në këto raste, publikut i përket vetëm e drejta për të kontestuar këtë aktvendim (nuk ka hapësirë për koment, as cilën do të drejtë tjetër të pjesëmarrjes në procedurën).

Procedurën për Parandalim të integruar dhe kontroll të ndotjes e inicioni operator (firma) me parashtrim të kërkesës për licencë të integruar ekologjike në MMJPH (apo vetëqeverisjen lokale, nëse bëhet fjalë për ndotës më të vogël që rregullohet me licencë të integruar ekologjike-B). Në periudhë prej 7 ditëve pas parashtrimit të kërkesës së plotë, Ministria për Mjedis Jetësor është e detyruar ta publikon kërkesën në së paku një gazetë me qarkullim nacional dhe në ueb faqen e vet dhe t’ia vë në dispozicion publikut të gjitha informatat lidhur me kërkesën të cilat i nevojiten për të formuar mendim. Komuna përkatëse është e obliguar të japë mendim në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës nga MMJPH. Kryetari i komunës përkatëse ka të drejtë të organizon debat publik në këtë fazë. Publiku ka të drejtë të komentojë në afat prej 14 ditëve pas publikimit të kërkesës nga ana e MMJPH-së, ndërsa ka të drejtë të kërkojë nga investitori të

⁵² Raport nacional për implementim të Konventës së Aarhusit, 2017 https://apps.unece.org/ehlm/pp/NIR/listnr.asp?YearID=2017&wf_Countries=MK&wf_Q=QA&Quer_ID=&LngIDg=EN&YearIDg=2017 [hapur më 10.04.2019]

organizojë debat publik. Në arsyetimin e parashtruar me licencën e integruar ekologjike, Ministria për Mjedis Jetësor obligohet të arsyetojë cilat komente të publikut janë marrë parasysht, ndërsa cilat komente janë refuzuar. Licenca ekologjike mund të ndryshohet ex officio apo me kërkesë të operatorit.

Në të dy rastet, qartë është përkufizuar se vlejné të njëjtat dispozita të cilat gjatë lëshimit të licencës së re, duke e përfshirë këtu edhe procedurën për pjesëmarrje të publikut.⁵³

Sipas nenit 108 të Ligjit për mjedis jetësor, Ministria për Mjedis Jetësor miraton Vendim me të cilin lëshohet licencë e integruar ekologjike - A. Kundër vendimit publiku i prekur dhe shoqatat qytetare nga sfera e mjedisit jetësor mund të parashtrorjnë ankesë në afat prej 15 ditëve nga publikimi i vendimit. Nëse nuk është kënaqur nga vendimi i Komisionit Shtetëror (apo Komisioni nuk sjell vendim në suaza të afatit ligjor), ankuesi mund të ngrit edhe kontest administrativ (në afat prej 30 ditëve nga miratimi i aktit të kontestuar).

Ministria për Mjedis Jetësor në periudhë prej 8 ditëve nga pranimi i Vendimit për zbatim apo moszbatim të Vlerësimit strategjik të ndikimeve mbi mjedisin jetësor, lidhur me ndonjë plan urbanistik, ka të drejtë ta pezullojë vendimin dhe ta obligon komunën përkatëse të zbatojë Vlerësim strategjik për ndikimet mbi mjedisin jetësor, nëse vlerëson që plani mund të ketë ndikime të konsiderueshme mbi mjedisin jetësor ose shëndetin e njerëzve. Publiku, gjithashtu, ka të drejtë ta konteston vendimin në periudhë prej 15 ditëve nga dita e publikimit të saj në ueb faqen e komunës përkatëse.⁵⁴

Ministria për Mjedis Jetësor me vendim të vet e përkufizon edhe shtrirjen e vlerësimit strategjik dhe e publikon në ueb faqen e vet, ndërsa publiku i interesuar ka të drejtë ta kontestojë këtë vendim para Komisionit Shtetëror përkatës të shkallës së dytë.⁵⁵ Procedura për vlerësim strategjik të ndikimeve mbi mjedisin jetësor parasheh së paku 1 (një) debat publik dhe publikim të draft dokumentacionit për periudhë prej së paku 30 ditë, në të cilin opinioni ka të drejtë të parashtrorjë komente dhe sugjerime. Pas këtij hapi, komuna përkatëse përpilon raport për vlerësim strategjik të ndikimeve mbi mjedisin jetësor në të cilin shtohen edhe komentet e publikut dhe e parashtron në MMJPH, i cili duhet të miratohet.

Ministria mund të angazhon ekspertë të jashtëm për ta reviduar Raportin për vlerësim strategjik të mjedisit jetësor dhe ta vlerësojnë cilësinë e tij – vlerësimi publikohet në ueb faqen e Ministrisë në periudhë prej 5 ditëve pas miratimit të vendimit. Organi përgjegjës për miratim të planit ka për detyrë ta marrë parasysht Raportin dhe vlerësimin nga ana e MMJPH, më pas e miraton planin dhe e publikon në ueb faqen e vet bashkë me Deklaratën e cila përmbledh si ndikimet mbi mjedisin jetësor integrohen në plan, si janë marrë parasysht komentet e publikut dhe përse zgjedhur alternativa përkatëse, si dhe masat për monitorim të ndikimeve mbi mjedisin jetësor që do t'i shkaktojë realizimi i planit. Për procedurat për Vlerësim strategjik të ndikimeve mbi mjedisin jetësor mund të thuhet që e drejta për pjesëmarrje të publikut është e garantuar për shkak se ekziston akt i posaçëm nënligjor i cili në detaje e rregullon pjesëmarrjen e publikut në këto procese.⁵⁶

Projektet ndërtimore të cilat i nënshtrohen përgatitjes VNMJ përfundojnë me Vendim të MMJPH për miratim ose refuzim të projektit në bazë të vlerësimit të ndikimeve mbi mjedisin jetësor.

53 Për shembull, shih neni 115, paragrafi (5) i Ligjit për mjedis jetësor i cili e përcakton këtë: “ndryshimet e licencës së integruar ekologjike - A... bëhen sipas procedurës për lëshim të licencës së re të integruar ekologjike - A.” Gjithashtu, shih neni 117 nga Ligji i njëjtë. [hapur më 01.04.2019]

54 Neni 65, paragrafi(11) i Ligjit për mjedis jetësor: “Kundër vendimit [për zbatim apo moszbatim të VSNMJ], publiku ka të drejtë për ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të vet në ueb faqen e organit i cili e përgatit dokumentin e planit... në Komisionin Shtetëror në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë...” [hapur më 04.04.2019]

55 Neni 65, paragrafi(17) i Ligjit për mjedis jetësor: “Kundër aktvendimit [i cili e përcakton përfshirjen e VSNMJ studim] publiku i interesuar... ka të drejtë për ankesë në Komisionin Shtetëror...” [hapur më 23.04.2019]

56 Urdhëresë për pjesëmarrje të publikut gjatë përpunimit të dispozitave dhe akteve tjera, si dhe plane dhe programe nga sfera e mjedisit jetësor (Gazeta zyrtare numër 147/2008 dhe 45/2011). Në nenin 1 të kësaj Urdhërese e cila është qartë e përkufizuar kur janë hapur të gjitha opsionet dhe kur kjo Urdhëresë është e aplikueshme dhe kur bëhen ndryshime në dokumentin relevant

Publiku i interesuar ka të drejtë ta konteston ligjshmërinë thelbësore procedurale të vendimit në afat prej 15 ditëve nga publikimi i vendimit para Komisionit Shtetëror të shkallës së dytë. Nëse vendimi nuk është i publikuar sipas dispozitave të Ligjit për mjedis jetësor (së paku në 1 gazetë nacionale dhe në ueb faqen e MMJPH), publiku i interesuar mund ta kontestojë vendimin në afat prej 15 ditëve nga publikimi i të njëjtës. Nëse nuk është i kënaqur nga vendimi i Komisionit Shtetëror (ose nëse komisioni nuk sjell vendim në suaza të afatit ligjor), ankuesi mund të ngrit edhe procedurë administrative.

Në fund të kësaj procedure Ligji për ndërtim (neni 62-a) parasheh “obligim për informim të fqinjëve”. Më saktësisht, organi kompetent i cili e miraton lejen për ndërtim obligohet “në afatprej tre ditëve nga miratimi i lejes për ndërtim t’i njofton fqinjët e parë të parcelës ndërtimore për lejen e lëshuar për ndërtim dhe që në afat prej 15 ditëve nga dita e lëshimit të njoftimit të lejes për ndërtim mund të shohin dokumentacionin.” Në të njëjtën periudhë parashihet e drejta për një ankesë finale (në shkallë të parë). Leja për ndërtim është e plotfuqishme vetëm pas skadimit të këtij afati. Për fat të keq, ky rregull nuk vlen për projektet në zonat zhvillimore teknologjike të themeluara nga Qeveria.

Duke e pasur parasysh që publiku i interesuar ka të drejtë të marrë pjesë në procedurën për lëshim të licencave, i njëjti mund të inicion kontest administrativ/padi kundër licencës për eksploatim të lëndëve të para minerale (për shkak se Ligji për lëndë të para minerale nuk parasheh të drejtë për ankesë në shkallë të dytë). Përkatësisht, në pajtim me nenin 8 paragrafi (2) i Ligjit për konteste administrative (Gazeta zyrtare numër 62/2006 dhe 150/2010), “kontest administrativ mund të ngritet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kur nuk është paraparë mbrojtje juridike në procedurë administrative në shkallë të dytë”. Studimi për VNMJ është obligativ për kërkuesin e licencës për eksploatim të lëndëve të para minerale dhe së këtejmi publiku i interesuar ka të drejtë ta konteston edhe vendimin për miratim të studimit për VNMJ në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor.

Ekziston mundësi për actio popularis për kontestim të ligjshmërisë thelbësore dhe procedurale të planeve urbanistike (si “akte të përgjithshme”) para Gjykatës Kushtetuese.⁵⁷ Ekziston praktikë e konsiderueshme gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese lidhur me revidimin e planeve urbanistike të kontestuara nga perspektiva e “transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut”.⁵⁸

1.6.3. Ligjet dhe akte nënligjore tjera relevante

Bërthama e legjislacionit për mjedis jetësor në vend përbëhet nga Kushtetuta me të cilën garantohet e drejta për mjedis jetësor të shëndoshë, Konventa e Aarhusit (e ratifikuar nga Kuvendi më 01.07.1999) dhe Ligji për mjedis jetësor (shtator 2005, ka hyrë në fuqi). Krahas kësaj, ligjet aktet nënligjore standarde sektoriale si dhe dispozitat lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor të inkorporuara në legjislacionin për planifikim urbanistik, transport, bujqësi, energjetikë dhe sferat tjera të cilat kanë ndikim mbi mjedisin jetësor, janë pjesë e legjislacionit nacional për mjedis jetësor dhe janë kryesisht të harmonizuara me legjislacionin e BE-së.

Mundësitë për qasje në drejtësi lidhur me mjedisin jetësor legjislacioni i Maqedonisë i garanton nëpërmjet ekzistimit të mekanizmave të cilat qytetari i ka në dispozicion. Kjo e drejtë për qasje në drejtësi është përkufizuar në shtyllën e tretë të Konventës së Aarhusit dispozitat e të cilës janë integruar në përmbajtjen dhe frymën e Ligjit për mjedis jetësor. Në mesin e veglave të cilat u qëndrojnë në dispozicion qytetarëve është vegla, të cilën më së shpeshti mund ta parashtrajnë në afat prej 14 deri 30 ditë nga publikimi i ndonjë vendimi, para organit përkatës publik, ndërsa nëse ky mekanizëm nuk funksionon, ata mund të inicojnë edhe kontest administrativ.

⁵⁷ Rregullore e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së: “Pranë gjykatës kushtetuese secili mund të parashtrrojë nismë për ngritje të procedurës për vlerësim të kushtetutshmërisë së ndonjë ligji apo kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e ndonjë akti tjetër..”, neni 12

⁵⁸ Rregullore e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së zbatimi i akteve të caktuara të miratuara në bazë të planit urbanistik të Gjykatës Kushtetuese nuk und të lejohet as të aplikohet, ndërkaq, nëse zbatimi është në rrjedhë, do të ndërpritet neni 80

Sipas Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, palët kanë të drejtë të kontestojnë çdo veprim administrativ (apo lëshim) ose akt administrativ.⁵⁹ Ankesa duhet të parashtrahet në organin e shkallës së parë (i cili e ka miratuar aktin e kontestueshëm) në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të aktit administrativ. Formalisht, Ligji për procedurë të përgjithshme administrative e njeh parimin e mjetit juridik, të përkatësisht palët e interesuara kanë të drejtë ta kontestojnë çdo veprim juridik (ose lëshim) përkatësisht akt administrativ (shkalla e parë – para trupit të njëjtë i cili e ka miratuar aktin; shkalla e dytë – para Komisionit Shtetëror të pavarur; shkalla e tretë – Gjykata administrative). Kjo konfirmohet me nenin 104 nga Ligji i njëjtë, ku qartë është përcaktuar që “pala ka të drejtë për mjet juridik kundër çdo veprimi apo lëshimi administrativ, nëse konsideron që ia shkel të drejtat apo interesin juridik” (shoqatat qytetare nga sfera e mjedisit jetësor konsiderohen si palë me interes juridik në konteste të sferës së mjedisit jetësor).

Me përjashtim të rasteve të posaçme, si gjendje e jashtëzakonshme publiku i interesuar⁶⁰ ka të drejtë ta kontestojë ligjshmërinë thelbësore dhe procedurale të vendimeve lidhur me aktivitete të caktuara në mjedisin jetësor, njëkohësisht duke pasur të drejtë ta kontestojë edhe vendimin e MMJPH-së të mos zbatojë procedurë për VNMM për ndonjë projekt. Duke e pasur parasysh hierarkinë e gjykatave, në këto raste publiku i interesuar së pari duhet ta ankimojë vendimin para Komisionit kompetent shtetëror të shkallës së dytë. Nëse ankesa nuk kalon para komisionit shtetëror, publiku i interesuar ka të drejtë ta kontestojë vendimin para Gjykatës administrative. Publiku i interesuar ka të drejtë drejtpërdrejtë të iniciojë kontest administrativ nëse me ligj nuk është paraparë ankesë në shkallë të parë.

Të gjitha aktivitetet e përmendura në Aneksin I të Konventës së Aarhusit⁶¹ duhet të kalojnë nëpër vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin jetësor apo procedurë për Parandalim të Integruar dhe kontroll të ndotjes (PIKN). Vetëm në rast të veçanta, me propozim të Ministrisë për Mjedis Jetësor, mund të vendoset pjesërisht apo tërësisht të mos vlerësohet ndikimi i projektit mbi mjedisin jetësor. Në këto raste megjithatë ekziston hapësirë (e kufizuar) për pjesëmarrje të publikut. Krahas kësaj, nëse vendoset që ndonjë projekt nuk ka ndikim mbi mjedisin jetësor, publiku (këtu bëjnë pjesë edhe shoqatat qytetare nga sfera e mjedisit jetësor) ka të drejtë ta kontestojë aktvendimin para Komisionit Shtetëror.⁶²

Individët apo shoqatat qytetare të interesuara nga sfera e mjedisit jetësor mund të kontestojnë akt apo lëshim të organit publik që është në kundërshtim me ligjet nga sfera e mjedisit jetësor

59 59 Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, me “veprim administrativ” nënkuptohet “miratim i akteve administrative, mbrojtje e shfrytëzuesve të shërbimeve publike dhe shërbimeve të interesit të përgjithshëm, si dhe ndërmarrje të veprimeve tjera administrative në punët administrative në pajtim me ligj”; ndërsa “akt administrativ” donë të thotë “akt i vetëm i organit publik që është miratuar në bazë të ligjit me të cilin vendoset për të drejtat, obligimet dhe interesat juridike të palëve. Aktet administrative mund të jenë të emëruara si aktvendim, vendim, urdhër, licencë, leje, ndalesë, pajtim apo tjetër.”, neni 4 paragrafi (1), alineja 6 dhe 7.

Ligji është i harmonizuar me Konventën e Aarhusit në kuptimin që siguron mbrojtje juridike në të gjitha punët administrative. Kjo konfirmohet në nenin 104 paragrafi (1) i këtij ligji ku qartë është përkufizuar që “pala ka të drejtë për mbrojtje juridike kundër çdo veprimi apo lëshimi administrativ, nëse pohon që me atë veprim ose lëshim janë shkelur të drejtat apo interesat juridike të saj. Paragrafi (4) i nenit të njëjtë konfirmon që “kur ankesa, përkatësisht kundërshtimi nuk janë të garantuar me ligj, pala ka të drejtë të ngrit kontest administrativ”.

60 Ligji për mjedis jetësor e përkufizon “palën e interesuar” në këtë mënyrë, publiku që për momentin është i prekur dhe/ose në të ardhmen mund të jetë i prekur apo ka interes lidhur me miratimin e vendimit për mjedis jetësor me të cilin është në raport të posaçëm me procedurë të caktuar. Pala e interesuar i përfshin edhe shoqatat e qytetarëve të formuara për mbrojtje dhe për avancim të mjedisit jetësor, si dhe persona fizik që ka mundësi të madhe t’i ndejnë pasojat nga miratimi i vendimit.”, neni 5 paragrafi (1), alineja 26

61 Urdhëresa për përcaktim të projekteve dhe kritere në bazë të të cilave përcaktohet nevoja për zbatim të procedurës për vlerësim të ndikimeve mbi mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare numër 74/2005; 109/2009 dhe 164/2012) dhe Urdhëresa për përcaktim të aktiviteteve të instalacioneve për të cilat lëshohet licencë e integruar ekologjike përkatësisht licencë për harmonizim me plan operativ dhe orar kohor për parashtrim të kërkesës për licencë për harmonizim me plan operativ, (Gazeta zyrtare numër 89/2005), e transmeton Aneksin I të Konventës së Aarhusit në legjisllacionin nacional.

62 62 Ligji për mjedis jetësor, Gazeta zyrtare numër 147/2008 dhe 45/2011, Urdhëresë për pjesëmarrje të publikut gjatë përpunimit të dispozitave dhe akteve tjera, si dhe plane dhe programe nga sfera e mjedisit jetësor, neni 81, paragrafi (6) <http://www.slvesnik.com.mk/besplatni-izdaniya.nspj> [hapur më 29.05.2019]

dhe mund të kërkojnë të jenë të dëmshpërblyer dhe/ose të kërkojnë ndalesë gjyqësore.⁶³ Kontesti civil mund të iniciohet nga pronarë toke prona e të cilëve, apo person që pëson dëm si pasojë e emetimeve të dëmshme (nëse dëmi i tejkalon kufijtë e përcaktuar në licencën e ndotësit). Krahas kësaj, Ligji për marrëdhënie obligative parasheh të drejtë për secilin pjesëtar të publikut për të iniciuar kontest kundër operatorit i cili është pronar i “burimit të rrezikut” i cili ka potencial për të shkaktuar dëm të konsiderueshëm mbi numër të papërcaktuar të personave (përkatësisht dëm potencial që paraqet rrezik për publikun interes).

Secili mund të denoncojë shkelje të ligjeve nga sfera e mjedisit jetësor para organeve mbikëqyrëse, përkatësisht në Inspektoratin shtetëror për mjedis jetësor që ka për detyrë të veprojë sipas paraqitjes. Nëse Inspektorati konstaton që ekziston shkelje e ligjeve nga sfera e mjedisit jetësor, mund të lëshojë urdhër apo ndalesë për aktivitetin, ose të fillojë procedurë për kundërvajtje. Krahas kësaj, secili mund të denoncojë vepër penale (potenciale) mbi mjedisin jetësor nga organet publike apo persona fizik, para prokurorit publik. Secili mund të parashtojë ankesë para Prokurorit publik, nëse konsideron që të drejtat e tij/saj për mjedis jetësor të pastër janë shkelur nga organet publike. Më tutje, neni 12 i Rregullores së Gjykatës Kushtetuese të RMV-së parasheh që secili mund të parashtojë iniciativë për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjit apo vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ndonjë rregulloreje apo akti tjetër të përgjithshëm para Gjykatës Kushtetuese.

Ligji për veprim për parashtresa dhe propozime⁶⁴ parasheh të drejtë të përgjithshme për qytetarët të parashtrorin parashtresa falas për mbrojtje dhe realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre, mirëpo edhe mbrojtje të interesit publik. Organet publike janë të obliguara të përgjigjen për “arsyeshmërinë dhe rezultatet e veprimit” në afat prej 15/30 ditë për lëndë më komplekse. Nëse konstatohet që është rrezikuar interesi publik, organi publik ka për detyrë të parashtrorin kërkesë në organin kompetent për t’i ndërmarrë masat e nevojshme për ta mënjanuar kundërvajtjen dhe dëmin e shkaktuar. Përkundër kësaj, nuk është krejtësisht e qartë nëse ky mekanizëm për “zbatim të tërthortë civile” të të drejtës nga sfera e mjedisit jetësor mund të përdoret për mbrojtje të mjedisit jetësor si “e mirë publike” dhe mbetet në të ardhmen të vërtetohet nëpërmjet procedurave të organeve publike dhe pushtetit gjyqësor.

Kodi penal në kapitullin XX i rregullon veprat penale mbi mjedisin jetësor dhe natyrën. Përkatësisht, në nenin 218, vepra penale ndotje e mjedisit jetësor dhe natyrës, saktë përkufizohen lartësitë e dënimeve me burg për veprat e kryera penale për persona fizik përkatësisht dënim me para për persona juridik të cilët do të kryejnë vepër penale Ndotje e ujit për pije, Prodhim i mjeteve të dëmshme për mjekim të bagëtive ose kafshëve, Rrezikim i mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina, grumbullim i paautorizuar dhe menaxhim me materie bërthamore.

Ligji për marrëdhëniet obligative e siguron të drejtën për t’u kërkuar kompensim i dëmit, ndërsa në raste të caktuara mund të përdoret për mbrojtje nga ndotja apo aktivitete tjera të dëmshme për mjedisin jetësor. Në atë rast mund të ngritet procedurë civile kundër personave juridik të cilët janë shkaktar i rrezikut.

1.6.3.1 Ligji për mjedis jetësor

Në Ligjin për mjedis jetësor rregullohen të drejtat dhe obligimet e R. së Maqedonisë së V., të komunave, të qytetit Shkup dhe të komunave të qytetit Shkup si dhe të drejtat dhe obligimet e personave juridik dhe fizik, për siguri të kushteve për mbrojtje dhe për avancim të mjedisit jetësor, për realizimin e të drejtës së qytetarëve për mjedis jetësor. Në procedurat e përcaktuara

63 Për shembull, Ligji për marrëdhënie obligative përcakton që secili mund të kërkojë nga person tjetër ta mënjojë burimin e rrezikut që mund të shkaktojë dëm të konsiderueshëm kërkuar apo numri të papërcaktuar të personave. Gjykata, me kërkesë të personit të prekur përcakton masa të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të parandalohet dëmi apo çrregullimi, ose të mënjanohet burimi i rrezikut, (“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 18 nga 03/2001, 09/2001, 25/2001, 17/2002, 01/2003, 07/2008, 06/2009, 12/2009), neni 143 nga <http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=33> [hapur më 29.05.2019]

64 Ligji për veprim për parashtresa dhe propozime (Gazeta zyrtare numër 82/2008...193/2015) i rregullon procedurat që ndërmerren për parashtresa dhe propozime të parashtruar nga qytetarët tek organet publike, http://www.adsdp.mk/adsdpmk/images/DRang/zakoni/ID_na_Zakonot_za_postapuvanje_po_pretstavki_i_predlozi_193_06112015.pdf. [hapur më 05.04.2019]

me këtë ligj zbatohet Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë Ligj nuk është përcaktuar ndryshe, kurse në procedurat gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, nëse me këtë Ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Për mbrojtjen dhe avancimin e cilësisë dhe gjendjes së medimeve të mjedisit jetësor: toka, uji, ajri, në sferat e mjedisit jetësor, për shumëllojshmërinë biologjike dhe pasuritë natyrore, si dhe për mbrojtjen e mbështjellësit të ozonit dhe mbrojtjen nga ndikimi negativ i njeriut mbi sistemin klimatik, krahas dispozitave të këtij ligji vlejné edhe dispozitat e ligjeve për medime dhe sfera të caktuara të mjedisit jetësor (në tekstin e mëtejme: ligje të posaçme). Mbrojtja e medimeve dhe sferave të ndara të mjedisit jetësor arrihet nëpërmjet ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet e veçanta nga: - kryerja e veprimtarive të ndryshme, substancat dhe teknologjitë ndotëse, - hedhurinat, -zhurma dhe dridhjet dhe rrezatimi jonizues dhe ajonizues. Të gjitha masat, standardet dhe qëllimet për mjedisin jetësor, të përcaktuara me këtë apo ligj dhe dispozitat e miratuar në bazë të tyre, zbatohen si kërkesa minimale.

Masat dhe aktivitetet për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor janë të interesit publik. Qeveria e R. së Maqedonisë së V. ka për detyrë të sigurojë mjete financiare nga Buxheti i R. së Maqedonisë së V. për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor. Komuna, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, kanë për detyrë, nga buxheti i komunës, buxheti i Qytetit të Shkupit dhe buxhetet e komunave në Qytetin e Shkupit të sigurojnë mjete financiare për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor.

Qëllime të Ligjit për mjedis jetësor janë: ruajtje, mbrojtje, rigjenerim he avancim të cilësisë së mjedisit jetësor; mbrojtje e jetës dhe e shëndetit të njerëzve, mbrojtje e shumëllojshmërisë biologjike; shfrytëzim racional dhe i qëndrueshëm i pasurive natyrore; zbatim dhe avancim i masave për zgjidhje të problemeve rajonale dhe globale të mjedisit jetësor.

Qëllimet arrihen veçanërisht me:

1. Parashikim, monitorim, parandalim, kufizim dhe mënjanim të ndikimeve negative mbi mjedisin jetësor;
2. Mbrojtje dhe rregullim të sferave të mjedisit jetësor;
3. Ruajtje të mjedisit jetësor të pastër dhe riparim të pjesëve të dëmtuara të mjedisit jetësor;
4. Parandalim të rrezikut dhe rreziqeve për mjedisin jetësor;
5. Stimulim të shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme natyrore të energjisë;
6. Stimulim i përdorimit të produkteve dhe prodhimtarisë më të pastër dhe shfrytëzim i teknologjive të pastra të cilat janë më të volitshme për mjedisin jetësor;
7. Qasje e integruar për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe zhvillim ekonomik;
8. Vendosje të sistemit për planifikim, avancim dhe menaxhim me mjedisin jetësor;
9. Sigurim të mjeteve për financim të masave dhe aktiviteteve për mbrojtje dhe për avancim të mjedisit jetësor;
10. Kontroll të aktiviteteve të cilat e rrezikojné mjedisin jetësor;
11. Zhvillim i vetëdijes për nevojën për mbrojtje të mjedisit jetësor në procesin arsimor dhe promovim të mbrojtjes së mjedisit jetësor;
12. Harmonizim i interesave ekonomike dhe tjera me kërkesat për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor;
13. Njoftim të publikut dhe të institucioneve relevante për mjedisin jetësor dhe inkuadrim të tyre në mbrojtjen e të njëjtit;
14. Lidhje e sistemit për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe të institucioneve të Republikës së Maqedonisë nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetësor me institucionet ndërkombëtare;

15. Stabilizim të koncentracioneve të gazrave të cilat e shkaktojnë efektin e kështit të qelqtë në atmosferë; dhe

16. Ballafaqim me shkretërimin dhe zbutje të efekteve të thatësirave.

Mjedisi jetësor është hapësira me të gjithë organizmat e gjallë dhe pasuritë natyrore, përkatësisht vlerat natyrore dhe të krijuara, lidhjet e tyre të ndërsjella dhe hapësira e përgjithshme në të cilën jeton njeriu dhe në të cilën janë themeluar vendbanimet, përdorimi i përgjithshëm i mirë, objektet industriale dhe të tjera, duke i përfshirë edhe mediumet dhe fushat e mjedisit jetësor.

Mbrojtja dhe avancimi i mjedisit jetësor është sistem i masave dhe aktiviteteve (shoqërore, politike, sociale, ekonomike, teknike, arsimore dhe tjera) me të cilat sigurohet përkrahje dhe krijim i kushteve për mbrojtje nga ndotja, degradimi dhe ndikimi i/mbi mediumet dhe fushat e caktuara të mjedisit jetësor (mbrojtja nga varfërimi i mbështjellësit të ozonit, parandalim të zhurmës së dëmshme dhe dridhjeve, mbrojtja nga rrezatimi jonizues dhe ajonizues, mbrojtja nga aroma e pakëndshme dhe shfrytëzim dhe grumbullim i hedhurinave dhe lloj tjetër i mbrojtjes së mjedisit jetësor).

Ndotje e mjedisit jetësor është emetim i materieve dhe substancave ndotëse, që është rezultat i aktivitetit njerëzor, në ajër, ujë ose tokë, që mund të jetë i dëmshëm për cilësinë e mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve ose emetim i materieve dhe substancave ndotëse prej nga mund të rezultojë dëm mbi pronë ose i cili i cenon ose ndikon mbi shumëllojshmërinë biologjike dhe të rrethinës dhe mbi mënyrat tjera të shfrytëzimit të mjedisit jetësor.

Neni 51 Qasje tek informatat

1. Gjatë kësaj, secili ka të drejtë pa qenë i detyruar ta vërtetojë interesin e vet, të kërkojë informata dhe të dhëna të validizuara që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor nga organet si dhe personat juridik dhe fizik të përcaktuar në nenin 52 paragrafi (1) i këtij ligji.
2. E drejta për qasje tek informatat për mjedis jetësor realizohet në lidhje me të gjitha informatat në formë të shkruar, vizuale, audio, elektronike apo në cilën do mënyrë tjetër të arritshme, kurse të cilat kanë të bëjnë me: 1. Gjendjen e medimeve dhe fushave të mjedisit jetësor, siç janë ajri dhe atmosfera, uji, dheu, toka, shumëllojshmëria biologjike dhe e rrethinës, duke i përfshirë edhe organizmat gjenetikisht të modifikuar si dhe ndërveprimi i ndërsjellë i këtyre elementeve; 2. Faktorët, siç janë materia, energjia, derivatet nukleare dhe energjia bërthamore, zhurma, rrezatimi apo hedhurinat, duke i përfshirë hedhurinat radioaktive, emetimet dhe format tjera të emetimeve në mjedisin jetësor që ndikojnë në mediumet dhe fushat e mjedisit jetësor dhe në jetën dhe shëndetin e njeriut; 3. Masat, duke i përfshirë edhe ato administrative, siç janë politika, legjisllacioni, planet, programet, marrëveshjet që janë në lidhje me çështjet lidhur me mjedisin jetësor, si dhe aktivitetet që mund – drejtpërsëdrejti apo tërthorazi – të ndikojnë mbi mediumet, fushat dhe mbi faktorët e mjedisit jetësor, si dhe masat apo aktivitetet për mbrojtje të atyre elementeve; 4. Raportet, për implementimin e ligjeve dhe dispozitave dhe akteve tjera lidhur me mjedisin jetësor; 5. Analizë e shpenzimeve dhe e fitimeve si dhe analizat tjera financiare dhe ekonomike dhe premisa të cilat përdoren në kuadër të masave dhe aktiviteteve të ndërmarrja për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor nga pika 3 e këtij paragrafi dhe (6). Gjendjet lidhur me mjedisin jetësor dhe shëndetin dhe me sigurinë e njerëzve, siguria e produkteve ushqimore duke e përfshirë edhe ndikimin e ndotjes në zinxhirin e ushqimit, kushtet për jetë të njerëzve, vendet e rëndësishme për kulturën dhe objektet e ndërtaura, në masë që janë nën ndikim apo mund të jenë nën ndikim të medimeve dhe fushave të mjedisit jetësor apo nëpërmjet ndikimit të atyre medimeve dhe fushave mbi cilën do prej gjendjeve të elementeve dhe faktorëve të përmendur.

Neni 52 Përkufizon cilat subjekte të cilat posedojnë informata për mjedisin jetësor:

1. Organe dhe persona fizik dhe juridik (në tekstin e mëtejshëm: subjekte) të cilët posedojnë apo për të cilët ekzistojnë informata për mjedisin jetësor janë: Qeveria e R. së Maqedonisë së V. dhe organet e drejtorisë shtetërore; organet e komunës; të qytetit të Shkupit dhe të komunave të Qytetit të Shkupit; personat juridik dhe fizik të cilëve, në pajtim me ligj, u janë besuar autorizime publike, duke përfshirë edhe detyra speciale, aktivitete dhe shërbime në sferën e mjedisit jetësor dhe/ose – personat juridik dhe fizik të cilët, në bazë të ligjit apo marrëveshjes, kryejnë veprimtari apo shërbim të interesit publik në sferën e mjedisit jetësor, nën vëzhgim të organeve ose personave nga alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij paragrafi.
2. Qeveria e R. së Maqedonisë së V., me propozim të organit të drejtorisë shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, publikon dhe mban listë të subjekteve të cilët posedojnë apo për të cilët ekzistojnë informata lidhur me mjedisin jetësor. Në atë Listë përcaktohen edhe informatat të cilat i posedon secili nga subjektet e përmendur.
3. Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar të përcaktojnë person të autorizuar i cili do të jetë përgjegjës për realizimin e të drejtës për qasje tek informatat për mjedis jetësor, si dhe të sigurojnë hapësirë në të cilën kërkuesit do të mund t'i shqyrtojnë apo të kenë këqyrje në informatat e kërkuara për mjedisin jetësor.
4. Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar të dhënat dhe informatat e kërkuara për mjedis jetësor t'i parashirojnë apo t'i bëjnë të arritshme për personat të cilët kanë kërkuar qasje tek informatat në pajtim me nenin 51 të këtij ligji.

Neni 53 Kushte që kanë të bëjnë me kërkesën për informatë

1. Kërkesa për informatë për mjedisin jetësor mund të parashirohet te secili nga subjektet të cilët posedojnë apo për të cilët ekzistojnë informata lidhur me mjedisin jetësor, të përcaktuara në pajtim me nenin 52 të këtij ligji.
2. Subjektet nga neni 52 i këtij ligji të cilët posedojnë apo për të cilët ekzistojnë informata lidhur me mjedisin jetësor, janë të detyruar të sigurojnë qasje tek informatat për mjedisin jetësor: 1) në afat sa më të shkurtë të mundur, por jo më vonë se një muaj nga dita e pranimit të kërkesës ose 2) më së voni dy muaj pas pranimit të kërkesës, nëse vëllimi dhe kompleksiteti i informatës janë të tilla që periudha prej një muaji, nuk mjafton për t'u kompletuar dokumentacioni. Në atë rast, subjekti nga neni 52 i këtij ligji e njofton kërkuesin e informatës, në afat sa më të shkurtë të mundur, kurse para skadimit të afatit prej një muaji, për nevojën për prolongim të afatit me arsyetim të shkaqeve për të cilat nevojitet prolongimi.

1.6.3.2 Rregullore për sigurim të qasjes tek informatat lidhur me mjedisin jetësor

Në bazë të nenit 53, paragrafi (4) i Ligjit për mjedis jetësor, Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor ka miratuar Rregullore për mënyrën dhe procedurën e sigurimit të qasjes tek informatat lidhur me mjedisin jetësor⁶⁵.

E drejta për qasje tek informatat për mjedis jetësor u takon të gjithë kërkuesve në të njëjtën mënyrë dhe me kushte të barabarta dhe ata janë të barabartë në realizimin e tyre.

Në kërkesat për qasje tek informatat për mjedis jetësor përgjigjet sipas radhës në të cilën janë pranuar kërkesat, në pajtim me periudhën kohore të nevojshme për përgatitje të përgjigjeve.

Subjektet, për të siguruar qasje më të lehtë tek informatat, kanë për detyrë rregullisht t'i publikojnë informatat në ueb faqet e tyre, si dhe ta vendosin në dispozicion kërkesën për qasje tek informatat për mjedis jetësor në vend të dukshëm (neni 4 i Rregullores).

⁶⁵ Publikuar në "Gazetën zyrtare të RMV-së" numër 93 nga 26.07.2007, [hapur më 29.05.2019]

Kërkuesi e realizon të drejtën për qasje tek informatat me parashtrim të kërkesës për qasje tek informatat për mjedis jetësor te subjektet me gojë, me shkrim apo në formë elektronike.

Përmbajtja e kërkesës për qasje tek informatat për mjedis jetësor duhet t'i ketë elementet në pajtim me Ligjin për qasje të lirë tek informatat me karakter publik (neni 5 i Rregullores). Subjektet për shkak të sigurimit të së drejtës për qasje tek informatat për mjedis jetësor përcaktojnë person zyrtar i cili ka për detyrë t'i azhurnojë të dhënat, t'u japë ndihmë parashtruesve dhe të mbajë evidencë për kërkesat e parashtruara (neni 6 i Rregullores).

1.6.3.3 Ligji për cilësi të ajrit ambiental⁶⁶

Akt themelor juridik me të cilin rregullohet mbrojtja dhe avancimi i ajrit është Ligji për cilësi të ajrit ambiental i cili është miratuar më 4 tetor 2004.

Në pajtim me nenin 4 të Ligjit, qëllimet e rregullimit juridik të këtij sektori janë:

- Shmangie, parandalim dhe reduktim i efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin jetësor si dhe trashëgiminë historike dhe kulturore;
- Sigurim i informatave adekuate për cilësinë e ajrit ambiental;
- Parandalim dhe zvogëlim i ndotjeve që shkaktojnë ndryshim të klimës;
- Mirëmbajtje të cilësisë së ajrit ambiental aty ku është e mirë dhe përmirësim në raste tjera.

Me këtë ligj rregullohen masat për shmangie, parandalim apo reduktim të efekteve të dëmshme nga ndotja e ajrit ambiental mbi shëndetin e njeriut si dhe për mjedisin jetësor në tërësi. Kjo realizohet nëpërmjet përcaktimit të vlerave kufitare dhe të synuara për cilësi të ajrit ambiental dhe limitet për alarmim dhe informim, vlerat kufitare dhe të synuara për emetime, formimit të sistemit të vetëm për monitorim dhe kontroll të cilësisë së ajrit ambiental dhe monitorim të burimeve të emetimeve (sistem gjithëpërfshirës për menaxhim me cilësinë e ajrit ambiental dhe burimet e emetimeve – sistem informativ). Rregullohet edhe masa tjera për mbrojtje prej aktiviteteve të caktuara të personave juridik dhe fizik, të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi cilësinë e ajrit ambiental. Dispozitat e këtij ligji kanë të bëjnë me ajrin ambiental, përveç ndotjes së ajrit ambiental të shkaktuar nga substancat radioaktive, zhurma dhe fatkeqësi elementare dhe ndotja e ajrit në mjedisin e punës.

1.6.3.4 Ligji për mbrojtje të natyrës⁶⁷

Me këtë ligj rregullohet mbrojtja e natyrës nëpërmjet mbrojtjes së shumëllojshmërisë biologjike dhe të rrethinës dhe mbrojtjes së trashëgimisë natyrore, në zona të mbrojtura dhe jashtë tyre, si dhe me mbrojtjen e rariteteve natyrore (në tekstin e mëtejme: mbrojtje e natyrës). Për shfrytëzimin e pasurive natyrore për qëllime ekonomike, krahas dispozitave të këtij ligji aplikohen edhe dispozitat e ligjeve të veçanta. Për mbrojtjen e natyrës aplikohet edhe Ligji për mjedis jetësor, nëse nuk është rregulluar ndryshe me këtë ligj. Për mbrojtjen e natyrës aplikohen edhe dispozitat e ligjeve tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës. Për procedurat e përcaktuara me këtë ligj aplikohet Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Mbrojtja e natyrës paraqet veprimtari të interesit publik. Mbrojtja e shumëllojshmërisë biologjike realizohet nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të sistemit të masave dhe aktiviteteve për mbrojtje të specieve të egra, duke e përfshirë materialin e tyre gjenetik, habitatet dhe ekosistemet, me qëllim të sigurohet shfrytëzimi i qëndrueshëm i komponentëve të shumëllojshmërisë biologjike dhe mirëmbajtje e ekuilibrit natyror.

⁶⁶ Ligji për cilësi të ajrit ambiental, "Gazeta zyrtare e RMV-së numër 47/2011" од 31.07.2011, <http://www.moiepp.gov.mk/wpcontent/uploads/2014/09/Zakon%20za%20kvalitet%20na%20Vozduh%20-%20precisten%20tekst%20za%20informativni%20celi.pdf> [hapur më 02.04.2019]

⁶⁷ Ligji për mbrojtje të natyrës ("Gazeta zyrtare e RMV-së" numër 67/2004, 14/2006; 84/2007; 35/2010; 47/2011; 148/2011, 59/2012 dhe 13/2013), <http://www.slvnesnik.com.mk/Issues/04b3bc15a4f14b3392180ebc7b584768.pdf> [hapur më 12.06.2019]

Mbrojtja e shumëllojshmërisë së mjedisit realizohet nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të sistemit të masave dhe aktiviteteve për ruajtjes dhe mirëmbajtje të vlerave karakteristike të mjedisit të cilat rezultojnë nga konfiguracioni i tij natyror dhe/ose nga lloji i aktivitetit njerëzor.

Mbrojtja e trashëgimisë natyrore realizohet nëpërmjet sistemit i cili i përcakton masat, procedurat dhe metodat për t'u fituar status i trashëgimisë kulturore dhe zbatim i mbrojtjes së saj.

Mbrojtja e rariteteve natyrore realizohet nëpërmjet vendosjes së sistemit që i përcakton masat, procedurat dhe metodat për shpallje të rrallësisë natyrore dhe zbatim të mbrojtjes së saj.

Qëllime të ligjit janë:

1. Përcaktim dhe monitorim i gjendjes së natyrës;
2. Ruajtje dhe rinovim i shumëllojshmërisë biologjike dhe të mjedisit në gjendje të ekuilibrit natyral;
3. Vendosje e rrejtësive të zonave të mbrojtura për mbrojtje permanente të vetive në bazë të cilave e kanë fituar statutin e trashëgimisë natyrore;
4. Sigurim i shfrytëzimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore në interes të zhvillimit të tanishëm dhe të ardhshëm, pa dëmtrim të konsiderueshëm të pjesëve të natyrës dhe me çrregullime sa më të vogla të ekuilibrit natyral;
5. Parandalim i aktiviteteve të dëmshme të personave fizik dhe juridik dhe çrregullimeve në natyrë si pasojë e zhvillimit teknologjik dhe e kryerjes së veprimtarive, përkatësisht sigurim të kushteve sa më të volitshme për mbrojtje dhe zhvillim të natyrës; dhe
6. Sigurim i të drejtës së qytetarëve për mjedis jetësor të shëndoshë.

1.6.3.5 Ligje tjera në pjesën e mjedisit jetësor

Lidhur me aktet e veçanta ligjore të cilat i rregullojnë aspektet e mjedisit jetësor për aktivitete të caktuara, për projekte ndërtimore, investitori duhet të parashtrojë projekt themelor i cili duhet të përmban studim për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor (SVNMJ) të miratuar nga Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor (MMJPH), nëse projekti është pjesë e Aneksit I të Konventës së Aarhusit⁶⁸. Licenca ndërtimore nuk mund të lëshohet pa leje nga MMJPH. MMJPH është përgjegjëse për zbatim të procedurës për Vlerësim të ndikimeve mbi mjedisin jetësor, që e përfshin të drejtën e publikut.

Kontrulli mbi emetimet në mediumet e mjedisit jetësor kryesisht bëhet nëpërmjet procedurës për Parandalim të integruar dhe kontroll të ndotjes (PIKN) dhe veglës kryesore rregullatore – licencat e integruara ekologjike (A: licenca ekologjike për instalacione më të mëdha; B: licenca ekologjike për instalacione më të vogla).⁶⁹

Me Ligjin për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësor rregullohet të drejtat dhe obligimet e personave juridik dhe fizik në lidhje me menaxhimin me zhurmën në mjedisin jetësor dhe mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor.

Me Ligjin për menaxhim me hedhurinat rregullohet menaxhimi me hedhurinat; parimi dhe qëllimet për menaxhim me hedhurina; planet dhe programet për menaxhim me hedhurinat; të drejtat dhe obligimet e personave juridik dhe fizik lidhur me menaxhimin me hedhurinat; kërkesat dhe obligimet e personave juridik dhe fizik lidhur me menaxhimin me hedhurinat; kërkesat dhe obligimet e personave juridik dhe fizik të cilët prodhojnë produkte dhe paketime dhe të cilët në

⁶⁸ Ligji për ndërtim: "Projekti themelor përmban studim VNMJ për projektin... nëse dispozitat në sferën e mjedisit jetësor parashohin përgatitje të studimit për këtë lloj të ndërtimit." Sipas "Urdhërësës për përcaktim të projekteve dhe për kriteret në bazë të cilave përcaktohet nevoja për zbatim të procedurës për vlerësim të ndikimeve mbi mjedisin jetësor" projektet ndërtimore janë kryesisht projekte të përcaktuara për të cilat nevoja për procedurën e VNMJ-së përcaktohet veçmas për çdo rast, neni 47, paragrafi(4) <http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=4694> [hapur më 22.04.2019]

⁶⁹ Urdhërësë për pjesëmarrje të publiku gjatë përpunimit të dispozitave dhe akteve tjera, si dhe plane dhe programe nga sfera e mjedisit jetësor Gazeta zyrtare numër 147/2008 dhe 45/2011, Kapitulli XII i Ligjit për mjedis jetësor, <http://www.slvesnik.com.mk/besplatni-izdanija.nspj>, [hapur më 21.06.2019]

fund të ciklit të tyre e ngarkojnë mjedisin jetësor; mënyra dhe kushtet me të cilat mund të bëhet grumbullim, transport, trajtim, magazinim, ripërpunim dhe mënjanim i hedhurinave; importi, eksporti dhe transiti i hedhurinave; monitorimi; sistemi informativ; financimi dhe monitorimi i menaxhimit me hedhurinat.

Procedurat për planifikim hapësinor rregullohet me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta z. numër 199/2014... 163/2016). Ligji (neni 7) përcakton dy tipa kryesor të planeve varësisht nga hapësira që planifikohet: a) Plan hapësinor i Republikës së Maqedonisë të cilin e Miraton Kuvendi dhe paraqet dokument kryesor strategjik për planifikim hapësinor; dhe b) plane urbanistike në të cilat bëjnë pjesë plani i përgjithshëm urbanistik, plani i detajuar urbanistik, plani urbanistik për fshatra dhe plani urbanistik për jashtë vendeve të banuara.

Planet janë në lidhje hierarkike, që donë të thotë se plani urbanistik përgatitet në bazë të të dhënave nga plani hapësinor, plani i detajuar urbanistik përgatitet për zona të inkuorporuara në planin e përgjithshëm urbanistik etj. Sipas Urdhëresës përkatëse⁷⁰, dokumentet urbanistike të planit (dhe ndryshimet e tyre) duhet të kalojnë vlerësim strategjik të ndikimeve mbi mjedisin jetësor. Krahas kësaj, Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (neni 28) thirret në Ligjin për mjedis jetësor dhe përcakton që komuna përkatëse është e obliguar të sjell vendim për zbatim apo vendim për moszbatim të vlerësimit strategjik të ndikimit në të cilin janë arsyetuar shkaqet për zbatim apo moszbatim dhe të njëjtin ta dërgon në Ministrinë për Mjedis Jetësor.

Arsyetimi duhet t'i përmbajë shkaqet për zbatim/moszbatim sipas kriterëve të numëruara në "Urdhëresën për kriteret në bazë të të cilave miratohen vendime nëse dokumente të caktuara të planit mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve". (Gazeta z. numër 144/2007).

Në procedurën për lëshim të Licencës për eksploatim të lëndëve të para minerale faza e fundit e koncesionit dhe lëshimi i licencës për eksploatim të lëndëve të para minerale (pjesa III e Ligjit). Firma e interesuar duhet të marrë licencë për kërkim të lëndëve të para minerale nga Ministria për Ekonomi me kohë të vlefshmërisë që nuk mund të jetë më e gjatë se koha e vlefshmërisë së koncesionit (maks. 60 vite, përkatësisht 30 vite me mundësi për t'u vazhduar edhe 30 vite). Procedurën e nis koncesionari me parashtrim të kërkesës në Ministrinë e Ekonomisë. Kërkesa, ndër të tjerat, përmban licencë për Studim për vlerësim të ndikimeve mbi mjedisin jetësor nga ana e Ministrisë për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, ashtu që si në rastet tjera ashtu edhe në këtë, pjesëmarrja e publikut në procesin e VN MJ karakterizohet me të drejtat dhe kufizimet e njëjta si në procedurat tjera.⁷¹ Draft licenca për eksploatim të lëndëve të para minerale, gjithashtu publikohet në ueb faqen e Ministrisë për Ekonomi dhe publiku i interesuar mund të jep komente për të njëjtën në afat prej 15 ditëve.

Shumimi, mbrojtja dhe gjahu i kafshëve/egërsirave janë të rregulluara me Ligjin për gjueti (Gazeta zyrtare numër 26/2009 ... 193/2015). Terrenet e gjuetisë i përcakton Qeveria në pajtim me Planin hapësinor republikan (neni 28) dhe të njëjtat jepen në menaxhim të personave juridik të cilët kryejnë punë të interesit publik nga sfera e pylltarisë, gjuetisë dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor, apo organeve publike të cilat menaxhojnë me parqet nacionale. Egërsira/kafshët në terrenet e gjuetisë jepen nën koncesion të personave juridik, kryesisht organizata gjahtarësh të cilat kanë përgjegjësi për të lëshuar licenca për gjah për persona të interesuar. Koncepti i lëshimit të koncesioneve është i njëjtë sikur edhe në procedurën paraprakisht të shpjeguar për eksploatim të lëndëve të para minerale. Nuk është paraparë pjesëmarrje e publikut në këto procedura.

Lidhur me Ligjin për organizmat gjenetikiisht të modifikuar, megjithëse parashihet pjesëmarrje e publikut në procesin e vendimmarrjes lidhur me lëshim të qëllimshëm të organizmave gjenetikiisht të modifikuar në qarkullim, vetëm kërkuesi/investitori ka të drejtë të parashtrijë

⁷⁰ Urdhëresa për strategjitë, planet dhe programet, duke i përfshirë ndryshimet e atyre strategjive, planeve dhe programeve për të cilat detyrimisht zbatohet procedurë për vlerësim të ndikimit të tyre mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve (Gazeta zyrtare numër 153/2007 dhe 45/2011). Neni 3, paragrafi (13)

⁷¹ Ligji për lëndës të para minerale, (Gazeta zyrtare numër 136/12 , 25/13, 93/13,44/14,160/14, 195/15,192/15,3 9/16,53/16,120/16,189/16), Neni 55, paragrafi (2), alineja 4 [http://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20mineralni%20surovini%20-%20Precisten%20tekst%20\(Rabotna%20verzija\).pdf](http://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20mineralni%20surovini%20-%20Precisten%20tekst%20(Rabotna%20verzija).pdf) [hapur më 13.06.2019]

padi kundër vendimit të MMJPH-së për refuzim të njoftimit për lëshim të qëllimshëm të OGJM-ve në qarkullim, përkatësisht publiku nuk ka të drejtë të kontestojë Licencë veç më të miratuar për lëshim të qëllimshëm të OGJM-ve. Nuk ekzistojnë dispozita të cilat e rregullojnë procedurën në rast të azhurnimit apo ndryshim të kushteve të Licencës.

Regjistrimi i pesticideve është rregulluar me Ligjin për produkte për mbrojtje të bimëve (Gazeta zyrtare numër 110/2007 ... 39/2016) dhe Ligjin për siguri të ushqimit (Gazeta zyrtare numër 157/2010 ... 39/2016). Ideja kryesore parandaluese mbi Ligjet është që asnjë produkt nuk guxon të futet në treg dhe të përdoret nëse paraprakisht nuk futet në regjistrin e Drejtorisë fitosanitare në kuadër të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi Ujore, në bazë të kërkesës së parashtruar nga person juridik i cili është pronar i produktit, përkatësisht në regjistrin e prodhuesve ushqimor. Nuk parashihet pjesëmarrje e publikut në këto procedura.

Çështja e eksportit/importit të kimikateve, duke përfshirë edhe importin/eksportin e kimikateve të caktuara të rrezikshme është rregulluar me Ligjin për kimikate (Gazeta zyrtare numër 145/2010 ... 37/2016). Eksporti/importi i kimikateve mund të bëhet nga ana e personit juridik vetëm me leje për eksport/import të lëshuar nga Ministria për Shëndetësi (neni 69). Në lidhje eksportin/importin e kimikateve të caktuara të rrezikshme (kimikate industriale dhe pesticide, vlen koncepti i Konventës së Roterdamit për pëlqim paraprak. Nuk parashihet pjesëmarrje e publikut në këto procedura.

1.6.3.6 Ligj për ndihmë juridike falas

Kuvendi i R. së Maqedonisë së V. më 16 maj 2019 e miratoi Ligjin e ri për ndihmë juridike falas (LNJF), i publikuar në "Gazetën zyrtare të RMV-së" numër 101 nga 22.05.2019, ndërsa zbatimi fillestar i të cilit ka nisur prej 1 tetorit 2019. Ligji ka për qëllim të sigurojë qasje të barabartë të qytetarëve dhe personave tjerë të përcaktuar me këtë ligj nga institucionet e sistemit, njoftim, realizim dhe mundësim të ndihmës juridike efektive, në pajtim me qëllimin për qasje të barabartë në drejtësi. (Neni 2 i LNJF).

Me miratimin e Ligjit të ri për ndihmë juridike falas bëhet harmonizim me Direktivën 2002/8/KE të Këshillit nga 27 janari 2003 për përmirësim të qasjes në drejtësi nëpërmjet kontesteve ndërkufitare me vendosje të minimum rregullave të përbashkëta që kanë të bëjnë me ndihmë juridike për konteste të tilla.

Në pajtim me Ligjin, ndihmë juridike falas japin seksionet rajonale të Ministrisë për Drejtësi të R. së Maqedonisë së V., shoqatat e autorizuara të qytetarëve të regjistruara si dhënës të NJF-së, klinikat juridike të regjistruara para Fakulteteve Juridike, ndërsa të regjistruara në regjistrin e Ministrisë së Drejtësisë dhe avokatë të regjistruar në regjistrin për dhënie të ndihmës juridike sekondare para Ministrisë për Drejtësi. Ndihma juridike falas mundësohet për persona të cilët plotësojnë kriteret e caktuara dhe e njëjta realizohet si ndihmë juridike primare dhe ndihmë juridike sekondare.

Të drejtë për ndihmë juridike primare kanë të gjithë personat fizik të cilët kanë vendbanim apo vendqëndrim në R. e Maqedonisë së V.

Ndihmë juridike primare është lloji i ndihmës juridike falas e cila sigurohet nga person i autorizuar zyrtar të Ministrisë, shoqatë e autorizuar dhe klinikë juridike. Shoqatë e autorizuar është ajo e cila në pajtim me dispozitat e këtij ligji i plotëson kushtet për dhënie të ndihmës juridike primare dhe në bazë të aktvendimit të Ministrisë është e autorizuar për të dhënë ndihmë juridike primare dhe është e regjistruar në Regjistrin e shoqatave të autorizuara për dhënie të ndihmës juridike primare.⁷²

Klinika juridike është njësi organizative e fakultetit juridik para universitetit e themeluar në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe qëllimi i të cilës është realizim i mësimi praktik të studentëve.⁷³

⁷² Ligj për ndihmë juridike falas, Gazeta zyrtare e RMV-së" numër 101 nga 22.05.2019, neni 3, paragrafi (6), <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20besplatna%20pravna%20pomos.pdf> [hapur më

⁷³ ibis, neni 3, paragrafi(7)

Ndihma juridike primare përshin: informatë të përgjithshme dhe këshillë të përgjithshme juridike, këshillë fillestare juridike për të drejtën e shfrytëzimit të ndihmës juridike, ndihmë gjatë kompletimit të kërkesës për ndihmë juridike sekondare, ndihmë gjatë plotësimit të formularëve, forma të lëshuara nga organ administrativ në procedurë administrative për mbrojtje sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; sigurim pensional, invalidor dhe shëndetësor; mbrojtje të viktimave nga dhuna gjinore dhe familjare; procedurë për regjistrim në librin amë të të lindurve; sigurim të dokumenteve për identifikim personal dhe shtetësi; përpilim të parashtrësve për në Komisionin për mbrojtja nga diskriminimi dhe në Avokatin e Popullit dhe kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ndihmë juridike sekondare japin avokatë në procedurë para gjykatës, organ shtetëror, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i R. së Maqedonisë së V., Fondi për sigurim shëndetësor i R. së Maqedonisë së V. të cilët ushtrojnë autorizime publike në pajtim me dispozitat e Ligjit për ndihmë juridike falas.

Ndihmë juridike sekondare miratohet për person i cili ka nevojë për ndihmë juridike profesionale nga avokat për çështje konkrete juridike dhe i cili nuk ka mundësi t'i paguajë shpenzimet e procedurës për shkak të gjendjes së tij financiare dhe kërkesa e të cilit është e arsyeshme.⁷⁴ Ndihmë juridike sekondare përfshinë përfaqësim në procedurë para gjyqit, organit shtetëror, Fondit për sigurim pensional dhe invalidor në R. e Maqedonisë së V., Fondin për sigurim shëndetësor në R. e Maqedonisë së V. dhe personave që ushtrojnë autorizime publike në pajtim me nenin 14 të Ligjit për ndihmë juridike falas, si dhe çlirim nga shpenzimet në pajtim me dispozitat e parapara me këtë dhe ligj tjetër.⁷⁵

Ministria për Drejtësi, lidhur me procedurën për ndihmë juridike sekondare, bashkëpunon me Odën e avokatëve të R. së Maqedonisë së V., organet e jurisprudencës, si dhe me qendrën për punë sociale, organet shtetërore dhe institucionet tjera kompetente.

Me Ligjin për ndihmë juridike falas rregullohen të drejtat për ndihmë juridike falas, procedura në të cilën realizohet, shfrytëzuesit, kushtet dhe mënyra e realizimit të saj, dhënësit e ndihmës juridike falas, organet kompetente për vendimmarrje, mbrojtja e të drejtës juridike falas, financimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të saj, organizimi i ditëve për këshilla juridike falas, ndihmë juridike falas në konteste ndërkuftare si dhe mbikëqyrja në zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Qëllimi i ligjit është të sigurojë qasje të barabartë të qytetarëve dhe personave tjerë të përcaktuar me këtë ligj në institucionet e sistemit, për njoftim, realizim dhe për të mundësuar ndihmë juridike efektive, në pajtim me parimin për qasje të barabartë në drejtësi.

Procedura për ndihmë juridike sekondare është urgjente dhe kjo është përkufizuar në mënyrë të prerë në Ligj.

Ndihma juridike falas realizohet nga Ministria për Drejtësi, avokatët dhe shoqatat e autorizuara të qytetarëve, ndërsa mjetet për miratim të ndihmës juridike falas sigurohen nga Buxheti i Ministrisë për Drejtësi si program i veçantë i propozuar nga ministri, i miratuar nga Qeveria e R. së Maqedonisë së V. si dhe prej donacioneve dhe të ardhura tjera në pajtim me ligj.

Në Ligjin për ndihmë juridike falas, mjetet për kompensim për dhënie të ndihmës juridike primare nga shoqatat e autorizuara dhe klinikat juridike ndahen me konkurs publik⁷⁶, të cilin e shpall Ministria për Drejtësi në ueb faqen e vet në tremujorin e parë të vitit aktual. Shpalljen dhe zbatimin e konkursit publik si dhe verifikimin e dokumenteve të parashtruara, mënyrën e vlerësimit me pikë gjatë vlerësimit të fletëparaqitjeve, kontrollin e shpenzimit të mjeteve i përcakton ministri për Drejtësi.

Shoqatat dhe klinikat juridike të cilat nuk financohet në pajtim me nenin 11 të Ligjit për ndihmë juridike falas kanë të drejtë për kompensim për ndihmën juridike primare të ndarë për çdo lëndë veçmas për të cilën është miratuar kërkesë për ndihmë juridike sekondare. Në pjesën e kompensimit të dhënësve të ndihmës juridike sekondare, përkatësisht avokatët e regjistruar në

74 ibis neni 13, paragrafi(1)

75 ibis, neni 13, paragrafi 2

76 ibis, neni 11, paragrafi 1

regjistrin e avokatëve për dhënie të ndihmës falas para Ministrisë për Drejtësi në R. e Maqedonisë së V. do t'u paguhet kompensim në shumë procentuale nga shpërblimi për avokatë si dhe shpenzimet, në pajtim me Tarifën për shpërblim dhe kompensim të harxhimeve për punë të avokatëve të miratuar nga Oda e avokatëve.

Me Ligjin e ri për ndihmë juridike falas, janë siguruar përfitime më të larta dhe mbrojtje për qytetarët: para se gjithash, janë lehtësuar kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë qytetarët për të fituar ndihmë juridike falas, me çka sigurohet qasje e barabartë në drejtësi për të gjithë, veçanërisht për qytetarët më të varfër dhe të marginalizuar.

Njëkohësisht, ndihmë juridike falas, me disa përjashtime do të parashihet në të gjitha fushat juridike, me çka rritet përfshirja e personave të rrezikuar dhe të lëndueshëm, kurse me atë edhe mundësia për mbrojtje më të madhe të të drejtave të qytetarëve. Ajo që është e rëndësishme të theksohet është që me Ligjin e ri shpenzimet tjera lidhur me procedurën (shembull taksa gjyqësore, shpenzime për ekspertizë) nuk do të jenë më në llogari të qytetarëve, por të njëjtat do të përfshihen me ndihmën juridik falas.⁷⁷

Ndihmë juridike falas kanë personat fizik në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me ligj.

Dallimi mes dhënësve të ndihmës juridike për ndihmë juridike paraprake dhe ndihmë në kontestet gjyqësore dhe administrative përbëhet në atë që ndihma juridike paraprake jepet nga person zyrtar i autorizuar në seksionet rajonale të Ministrisë për Drejtësi dhe nga shoqatat e autorizuara të qytetarëve, ndërsa ndihma juridike realizohet nga avokatët.

Në pajtim me Ligjin e ri, ndihma juridike sekondare përfshin përfaqësimin në procedurë para gjyqit, organit shtetëror, Fondit për sigurim pensional dhe invalidor në R. e Maqedonisë së V., Fondit për sigurim shëndetësor në R. e Maqedonisë së V. dhe personave që ushtrojnë autorizime publike si dhe çlirim nga shpenzimet në pajtim me dispozitat e parapara me këtë dhe ligje tjera.

Në pajtim me të lartpërmendurën, në Ligjin për ndihmë juridike falas, nuk përmenden të drjetat nga sfera e mjedisit jetësor (në fakt, e drejta për mjedis jetësor të shëndoshë është e garantuar edhe me aktin më të lartë në shtet – Kushtetuta). Këto të drejta pjesërisht mund të inkorporohen nën mbrojtjen e viktimave nga veprat penale, por vetëm pjesërisht, për shkak se kodi penal identifikon vepra kundër mjedisit jetësor kur ato janë kryer në vëllim më të madh, në zonë më të madhe, mbi numër më të lartë njerëzish, përkatësisht botën shtazore dhe bimore.

Në pajtim me Konventën e Aarhusit, qasje në drejtësi për çështje lidhur me mjedisin jetësor duhet t'i mundësohet secilit qytetar, që e është e drejta e tij e garantuar me Kushtetutën e RMV-së. Në RMB, veçanërisht në qytetet më të mëdha, qytetarët janë të vetëdijshëm për ndotjen e ajrit dhe të mjedisit jetësor, mirëpo deri sot ngec inicim konkret i procedurave (jashtëgjyqësore dhe gjyqësore) në rastet kur për shkak të ndotjes së mjedisit jetësor drejtpërsëdrejti janë rrezikuar jeta dhe shëndeti i njerëzve. Institucionet shtetërore në këtë sferë ende nuk kanë mjaftueshëm kapacitete për t'u ballafaquar me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe të ndërmarrin masa obligative në drejtim të kujdesit për të njëjtin. Parashtrohet pyetja sa edhe gjykatat janë të gatshme për të vepruar për konteste nga sfera e mjedisit jetësor, duke e pasur parasysh numrin e vogël të procedurave në këtë sferë të cilat iniciohen para gjykatave, mungesën e praktikës gjyqësore dhe mosbesimin në sistemin gjyqësor si dhe shpenzimet e mëdha të cilave u nënshtrohen palët gjatë realizimit të kësaj të drejte qytetare në rastet kur e njëjta u është rrezikuar apo shkelur.

Duke u nisur nga domethënia e mjedisit jetësor është nënvizuar në të legjislacionin e konventave, në nenin 8 të Kushtetutës së R. së Maqedonisë së V., mjedisi jetësor është përcaktuar si vlerë dhe e drejtë e cila duhet të mbrohet dhe të avancohet. Rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe avancimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës janë vlerë themelore e rregullimit kushtetues të R. së Maqedonisë së V. "Çdo njeri ka të drejtë për mjedis jetësor të shëndoshë. Secili është i obliguar t'i avancojë dhe mbrojë mjedisin jetësor dhe natyrën. Republika siguron kushte

⁷⁷ Publikuar më 22.05.2019 në pravdiko.mk, <https://www.pravdiko.mk/noviot-zakon-za-besplatna-pravna-pomosh-so-podobreni-reshenija-za-pristap-do-pravda/> [hapur më 28.05.2019]

për realizimin e të drejtës së qytetarëve për mjedis jetësor të shëndoshë”, është përcaktuar në nenin 43 të Kushtetutës së RMV-së.

Qëllimi, në pajtim me Konventën e Aarhusit është të mundësohet qasje në drejtësi përkatësisht e drejtë e secilit qytetar në RMV, pavarësisht gjendjen e vet financiare dhe pronësore është të ketë të drejtë dhe të fitojë ndihmë juridike falas në konteste për mjedisin jetësor. Shkak është që nuk bëhet fjalë vepër për shkelje të së drejtës personale të qytetarit e cila është e rrezikuar apo e shkelur, por edhe për shkeljen e të drejtave të interesit publik.

Të drejtë për të parashtruar kërkesë për ndihmë juridike sekondare ka:

- Person shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- Shtetas i huaj me leje për qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut apo person pa shtetësi i cili qëndron legalisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- Person i cili ka të drejtë për ndihmë juridike të siguruar nga Republika e Maqedonisë së Veriut në pajtim me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- Kërkues të drejtës për azil.

Mekanizmi NJF duhet t'u mundësojë qasje në të drejtat edhe personave që nuk posedojnë dokumentacion personal. E njëjta vlen edhe për personat pa shtetësi të cilët nuk kanë qëndrim të rregulluar, por gjenden në territorin e R. së Maqedonisë së V.

Vlerësohet që gjendja financiare e kërkuesit dhe anëtarëve të familjes së vet është e rrezikuar me shpenzimet në procedurë, nëse: ⁷⁸

të ardhurat mujore të kërkuesit që jeton vetë nuk e tejkalojnë shumën e neto pagës minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të përcaktuar me dispozitat nga fusha e pagës minimale, të ardhurat mujore të kërkuesit që jeton në ekonomi familjare me anëtarët e familjes së vet nuk janë mbi shumën e neto pagës minimale nga paragrafi (1) alineja 1 e këtij neni dhe të ardhurat mujore të secilit person tjetër të familjes nuk e tejkalon shumën prej 20% të neto pagës minimale të përcaktuar me dispozitat nga sfera e pagës minimale.

Sipas Ligjit të ri për ndihmë juridik falas, neni 18, paragrafi (2) në mënyrë taksative numëron çfarë konsiderohet si të ardhura gjatë analizës së kërkesës për ndihmë juridike falas, përkatësisht, nuk konsiderohen si të ardhura transferet sociale dhe kompensimet tjera të fituara në bazë të ndonjë statusi (për shembull, student).

Sipas Ligjit të ri për NJF, kërkues që jeton vetë dhe i cili ka të ardhura mujore jo më të larta se neto paga mesatare në RMV, përkatësisht kërkues i cili jeton në ekonomi familjare me anëtarët e familjes e cila ka të ardhura mujore jo më të larta se neto paga minimale në RMV, ndërsa çdo anëtar tjetër i ekonomisë familjare ka të ardhura jo më të larta se 20% të neto pagës mesatare në RMV në pajtim me Ligjin për ndihmë minimale.

⁷⁸ Ligji për ndihmë juridike falas, “Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 101 nga 22.05.2019, neni 11, paragrafi (1) <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20besplatna%20pravna%20pomos.pdf> [hapur më 19.06.2019]

1.6.4 Praktikë jashtëgjyqësore dhe gjyqësore në Maqedoni në sferën e mjedisit jetësor dhe gasja në drejtësi

Në këtë kapitull, është paraqitur pasqyrë e mundësive për shfrytëzim të mekanizmave vendor dhe ndërkombëtar për mbrojtje të mjedisit jetësor, të cilat mund të përdoren gjatë rrezikimit të jetës dhe shëndetit të njerëzve si dhe mundësia për ndihmë juridike (falas) dhe kushtet për shfrytëzim të saj. Gjithashtu, është paraqitur mundësi për shfrytëzim të actio popularis për çështje lidhur me mjedisin jetësor.

Procedurat jashtëgjyqësore mund të iniciohet pranë avokatit të popullit dhe trupa tjerë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

1.6.4.1 Avokat i Popullit

Ligji për themelim të Avokatit të Popullit (“Gazeta zyrtare e RM-së” numër 60/03) në nenet 11-18 parasheh lehtësim të kushteve, me ç’rast parashtruesi është i çliruar nga tatimi për procedurën që e ka filluar pranë institucionit Avokat i Popullit. Ndihmë dhe intervenim nga Avokati i Popullit mund të kërkojë çdo qytetar dhe i huaj (personalisht ose nëpërmjet të autorizuarit të tij) kur të vlerëson që e drejtë e tij kushtetuese dhe ligjore i është shkelur me akte ose veprime të organeve të drejtorisë shtetërore dhe organizatave që kanë autorizime publike. Mbrojtja e të drejtës pranë Avokatit të popullit mund të kërkohej pasi qytetari paraprakisht të jetë adresuar (ka parashtruar kërkesë, lutje, ka kërkuar ndihmë, intervenim apo veprim tjetër) në organin apo organizatën kompetente ndërsa gjatë kësaj ai organ apo organizatë ka miratuar apo nuk ka miratuar akt, ka ndërmarrë, përkatësisht nuk ka ndërmarrë veprim adekuat

Procedura pranë Avokatit të Popullit iniciohet me parashtrësë (kundërshtim, ankesë) e cila mund të dërgohet personalisht në zyrën e Avokatit të Popullit, me postë, me gojë në procesverbal tek Avokati i Popullit, me telefaks apo me postë elektronike.

Avokati i Popullit mund të ngritë procedurë edhe me iniciativë të vet, mirëpo për vazhdim të procedurës nevojitet pëlqim nga qytetari të cilit i është shkelur e drejta kushtetuese apo ligjore.

Kur të konstatohen shkelje të caktuara, Avokati i Popullit mund:

- ë japë rekomandime për mënjanim të shkeljeve të konstatuara;
- Të propozojë përsëritje të procedurës gjyqësore (hapje e serishme e procedurës);
- Të parashtrorë nismë për inicim të procedurës disiplinore kundër personit zyrtar apo përgjegjës; dhe/ose
- Të parashtrorë kërkesë te prokurori publik kompetent për ngritje të procedurës penale.

Duke e njohur nenin 44 të Kushtetutës së R. së Maqedonisë së V. me të cilin qytetarëve u garantohet e drejta për mjedis jetësor të shëndoshë, institucioni Avokat i Popullit i merr parasysh edhe parashtrësas që kanë të bëjnë me shkeljen e kësaj të drejte.

Duhet të përmendet që si mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, Avokati i Popullit ka mandat vetëm nëse shkeljen e ka bërë organ publik. Në 16 vitet e kaluara edhe me detyrë zyrtare edhe me nismë të qytetarëve, ka intervenime nga institucioni, veçanërisht lidhur me ndotjen mirëpo kjo nuk është vërejtur edhe në raportin fundit të vitit 2018, në dispozicion. Aktivitetet e Avokatit të Popullit kanë qenë udhëzime për intervenim në mbrojtjen e mjedisit jetësor, nëpërmjet inkuorporimit të standardeve të domosdoshme ekologjike të ndotësve më të mëdhenj, përkatësisht inkuorporimin e licencave të integruara ekologjike.

1.6.4.2 Ndërmjetësim

Ndërmjetësimi, si një nga mënyrat alternative të zgjidhjes së kontesteve në R. e Maqedonisë së V. është promovuar me miratim të Ligjit për ndërmjetësim në vitin 2006, të përpiluar në pajtim me Strategjinë për reforma në sistemin e jurisprudencës 2004-2008, me qëllim primar çlirim të gjykatave nga numri tepër i lartë i lëndëve, si dhe përcaktimi i R. së Maqedonisë së V. për integrim në rrjedhat evropiane.

Procedura për ndërmjetësim është lloj i veçantë i procedurës e cila për nga karakteri është vullnetar, efikas, e shpejtë dhe më e lirë se procedura gjyqësore. Ndërmjetësimi mund të aplikohet në marrëdhënie kontestimore civile, tregtare, të punës, për konsumatorë dhe të tjera ndërmjet personave fizik dhe juridik në të cilat palët mund lirshëm të menaxhojnë me kërkesat e tyre në pajtim me ligjin, ndërsa mund të aplikohet edhe në konteste familjare dhe penale nëse përshtatet me natyrën e marrëdhënieve kontestimore apo nëse me ligj të veçantë nuk është përjashtuar aplikimi i saj.

Përparësitë e ndërmjetësimit shprehen nëpërmjet joformalitetit dhe fleksibilitetit të procedurës, duke e pasur parasysh atë që në ndërmjetësim merren parasysh interesat e palëve për arritje të marrëveshjes së ndërsjellë që do të jetë mjaftueshëm e respektuar nga palët. Kontestet nga sfera e mjedisit jetësor janë konteste të ndërmjetësueshme dhe si të tilla mund të realizojnë qasje në drejtësi nëpërmjet procesit të ndërmjetësimit.

Deri në këtë moment nuk ekzistojnë raste të ndërmjetësimit me konteste lidhur me mjedisin jetësor.

1.6.4.3 Mekanizëm ankimor i Aarhusit

Duhet të përmendet edhe mundësia për parashtrim të ankesave në pajtim me Konventën e Aarhusit. Mekanizmi për harmonizim me Konventën e Aarhusit është një nga instrumentet e rralla ndërkombëtare për mbrojtje të mjedisit jetësor, i cili u mundëson pjesëtarëve të publikut ta shprehin shqetësimin e tyre drejtpërsëdrejti në këshill të ekspertëve të pavarur. Komiteti për ankesa (Compliance Committee) ka mandat t'i shqyrtojë të dhënat për rastin, mund japë rekomandime në Takimin e nënshkruesve (Meeting of the parties – MOP) drejtpërsëdrejti deri te pala e prekur.

Komiteti, gjithashtu mund t'i shqyrtojë çështjet për harmonizim me nismë vetanake dhe të përpilojë rekomandime; përpilon raporte për harmonizim ose zbatim të dispozitave të Konventës; të sigurojë këshillë apo ta lehtësojë ndihmën për individin.

Deri në këtë moment nuk ekzistojnë raste të parashtruara në Komitetin nga shteti jonë.

1.6.4.4 Konventa për mbrojtje të botës së egër bimore dhe shtazore dhe të habitateve natyrore në Evropë (Konventa e Bernit)

Mekanizëm tjetër ndërkombëtar është Konventa për mbrojtje të botës së egër bimore dhe shtazore dhe habitatet natyrore në Evropë (Bern), e ratifikuar në vitin 1979 e cila ka të bëjë me mbrojtjen e botës së egër, bimore dhe shtazore si dhe habitatet e natyrore në Evropë. Rrëqebulli ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*) është futur në Shtojcën 2 të Konventës së Bernit, që paraqet njohje të madhe dhe hap përpara mbrojtjes së kësaj kafshe të rrezikuar në shkallë kritike e cila jeton vetëm në Ballkan.

Më vitin 2013 eksperti i pavarur pranë Mekanizmit për ankesa, i Bankës Evropiane për rinovim dhe zhvillim e cila financiarisht e përkrah këtë projekt ka publikuar konstatime me të cilat konfirmohet që studimi ekologjik për Urën e Boshkut nuk është i kompletuar për shkak se në atë mungojnë të dhëna të rëndësishme. Eksperti pohon që gjatë vendimmarrjes për përkrahje financiare të projektit, banka i ka shkelur procedurat e saj ekologjike. Komiteti i Përhershëm i Konventës së Bernit për mbrojtje të botës së egër bimore dhe shtazore dhe të habitateve natyrore në Evropë kërkoi nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë urgjentisht ta suspendojë ndërtimin e hidrocentraleve të vogla në Parkun nacional Mavrovë, njoftojnë organizatat ekologjike qytetare të Maqedonisë.

Njëkohësisht, ekziston nismë edhe për suspendim të KEX e Ribnicës, Jadovës dhe Zhirovnicës I dhe II, për të cilat koncesionet janë miratuar në vitin 2015 për të cilat ndërtimi ende nuk ka filluar. Deri tani në territorin e PN Mavrovë nga viti 2010 deri 2017 janë ndërtuar katër hidrocentrale të reja të vogla në lumenjtë Tresoneçka, Galiçka, Kakaçka dhe Beličicë.

1.6.5. Procedura gjyqësore

Kompetenca e gjykatave e përfshin mbrojtjen e qytetarëve prej akteve të caktuara joligjore të drejtorisë shtetërore dhe të institucioneve tjera që ushtrojnë autorizime publike (konteste administrative). Gjykatat kanë kompetencë të përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

1.6.5.1 Gjykata kushtetuese e RM-së

Sipas nenit 9 të Kushtetutës, qytetarët janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës e lëkurës, prejardhjen nacionale dhe sociale, bindjen politike dhe fetare; pozitën pronësore dhe shoqërore. Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve.

Me nenin 108 të Kushtetutës është përcaktuar që Gjykata Kushtetuese e Republikës e cila e mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Nëpërmjet realizimit të kompetencave të saj, Gjykata kushtetuese përkujdeset për ruajtjen e parimeve kushtetuese, duke e përfshirë edhe parimin e barazisë së qytetarëve si parim themelor kushtetues. Kompetenca Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar në nenin 110 të Kushtetutës të cilin Gjykata Kushtetuese inter alia vendos për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën. I mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, vetëdijes, mendimit dhe të shprehurit publik të mendimit, bashkimit politik dhe veprimit dhe ndalimit të diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, nacionale, sociale dhe politike.

Gjykata Kushtetuese e realizon rolin e saj në këtë domen në dy mënyra:

- Nëpërmjet revizionit kushtetues, përkatësisht vlerësim të përputhshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore me parimin kushtetues të barazisë; dhe
- Nëpërmjet kontesteve konkrete për kërkesa të caktuara të qytetarëve, përkatësisht nëpërmjet mbrojtjes së drejtpërdrejtë të të drejtave dhe lirive të caktuara të përfshira në Kushtetutë.

Procedura për mbrojtje të drejtpërdrejtë gjyqësore-kushtetuese të lirive dhe të drejtave, duke e përfshirë edhe mbrojtjen nga diskriminimi, është rregulluar me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 51 të Rregullores, secili qytetar që konsideron se me ndonjë akt apo veprim i është shkelur e drejta ose liria e përcaktuar me nenin 110 të Kushtetutës mund të kërkojë mbrojtje nga Gjykata Kushtetuese në afat prej 2 muajve nga dita e parashtrimit të aktit final apo të plotfuqishëm, përkatësisht nga dita kur ka kuptuar për ndërmarrje të veprimit me të cilin është bërë shkelja por jo më vonë se 5 vite nga dita e ndërmarrjes së vet. Gjatë kësaj, duhet të përmenden shkaqet për të cilat kërkohet mbrojtje, aktet ose veprimet me të cilat janë shkelur, faktet dhe provat në bazë të të cilave parashtrohet kërkesa, si dhe të dhëna tjera të nevojshme për vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese.

Në Rregulloren janë paraparë afate të shkurta për veprim për kërkesa/procedura në të cilat vendoset për të drejtat dhe liritë e qytetarit, me çka sigurohet prioritet dhe urgjencë në vendosjen

për këto lëndë. Në pajtim me nenin 56 të Rregullores, me vendimin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive, Gjykata Kushtetuese do të përcaktohet nëse ekziston shkelje e tyre dhe varësisht prej kësaj do a anulohet aktin, do ta ndalojë veprimin me të cilin është kryer shkelja ose do ta refuzojë kërkesën.

Në pajtim me nenin 57 të Rregullores, gjatë procedurës, Gjykata Kushtetuese mund të sjell aktvendim për ndërprerje të përmbarimit të aktit ose veprimit deri në miratim të vendimit final.

Qytetarët mund drejtpërsëdrejti të drejtohen për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ndonjë dispozite tjetër⁷⁹, si dhe kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe shoqatave të qytetarëve. Parashtrimi i iniciativave nuk ndërlihet me ekzistim të interesit juridik të parashtruesit. Nevojitet vetëm që nisma të jetë përpiluar në formë përkatëse, përkatësisht saktë të jetë përcaktuar akti i cili kontestohet, shkaqet për të cilat kontestohet akti, cilat dispozita kushtetuese dhe ligjore cenohen me aktin e kontestuar dhe kush është iniciuesi.

Gjykata mban debat material dhe vendos për iniciativat nëse akti i kontestuar është me karakter të përgjithshëm dhe nëse është në fuqi. Nëse ka baza për dyshim, Gjykata së pari ngrit procedurë, ndërsa në fazë të dytë ngadalëson (shfuqizon ose anulon).

Procedura për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, iniciohet me kërkesë (ankesë kushtetuese) nga secili që konsideron që disa nga liritë dhe të drejtat e përmendura janë shkelur me akt ose veprim përfundimtar apo të plotfuqishëm. Gjatë kësaj, kërkesa duhet të përpilohet në formë përkatëse, përkatësisht në atë duhet të jetë përcaktuar akti apo veprimi me të cilin shkelen të drejtat dhe liritë, faktet dhe provat për atë, shkaqet për të cilat kërkohet mbrojtja dhe të dhëna tjera relevante.

Krahas faktit që ky lloj i kompetencës është kufizuar në vëllimin e vet, ajo ka dy karakteristika. Së pari, jo vetëm vendime dhe akte administrative por edhe gjyqësore, të bartëve të pushtetit publik mund të jenë të kontestuara. Së dyti, parashtrimi i kërkesës së tillë nuk imponon apsolvimin e të gjitha mjeteve juridike kundër aktit final apo të plotfuqishëm. Përndryshe, procedura konsiderohet si e iniciuar me vet parashtrimin e kërkesës, ashtu që mbetet Gjykata të prononcohet materialisht për kërkesën. Sipas rregullit, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive, Gjykata Kushtetuese vendos në bazë të debatit publik të mbajtur, në të cilin detyrimisht ftohet edhe Avokati i Popullit. Për shkak të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive, Gjykata mund ta anulohet aktin, ta ndalojë veprimin me të cilin është kryer shkelja apo ta refuzojë kërkesën. Kjo procedurë bazohet në parimet për prioritet dhe urgjencë.

Ekziston mundësi për *actio popularis* për kontestim të ligjshmërisë thelbësore dhe procedurale të planeve urbanistike (si “akte të përgjithshme”) pranë Gjykatës Kushtetuese.⁸⁰ Nëse me ndryshimin e aktit konkret nuk mund të mënjanohej pasojat nga aplikimi i ligjit, dispozitës apo aktit të përgjithshëm me çka vendimi i Gjykatës Kushtetuese është anuluar, Gjykata mund të përcaktojë pasojat të mënjanohej me kthim në gjendjen e mëparshme, me kompensim të dëmit apo në mënyrë tjetër. Përmbarimi i akteve të caktuara të plotfuqishme të miratuara në bazë të ligjit, dispozitave apo ndonjë akti tjetër të përgjithshëm, me çka vendimi i Gjykatës Kushtetuese është anuluar, - nuk mund të lejohet, as të zbatohet, nëse zbatimi – ka filluar, i njëjti do të ndërpritet⁸¹.

79 Rregullore e Gjykatës Kushtetuese e RMV-së, neni 12

80 Rregullore e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së: “Pranë gjykatës kushtetuese secili mund të parashtrorë nismë për ngritje të procedurës për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjit apo të kushtetutshmërisë së ndonjë dispozite tjetër...”, neni 12

81 Rregullore e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, neni 81

Ekziston praktikë e konsiderueshme praktike pranë Gjykatës Kushtetuese në lidhje me revidimin e planeve të kontestuara urbanistike nga perspektiva e “transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut”.⁸² Një nga rastet e tilla është anulimi i Planit Detajuar Urbanistik (PDU) për Taftalixhe 1, të miratuar më 5 janar 2016. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar që Komuna Karposh nuk i ka respektuar dispozitat kushtetuese dhe ligjore gjatë miratimit të PDU-së së kontestueshëm i cili e përfshin shtrirjen nga bulevardi Partizanski odredi, rruga Moskovska, bulevardi Makedonija dhe bulevardi 8 Shtatori me të cilin parashihet në sipërfaqet e gjelbra të shfaqen ndërtesa të reja.

Plani i detajuar urbanistik për Taftalixhe 1 dhe Karposh 4 është miratuar për ditën e Pashkëve në vitin 2016, gjatë mandatit të ish kryetarit të komunës Stevço Jakimovski. Iniciativat qytetare Ne jemi Karposh 4 dhe Taftalixhe e Gjelbër për vendimin e këtillë disa herë kanë organizuar protesta dhe marshe duke kërkuar të ndërpritet betonizimi i komunës dhe e kanë kundërshtuar planin në Gjykatën Kushtetuese. Mos publikimi i Vendimit për moszbatim të vlerësimit strategjik (numër. 34-2079/17 nga 06.07.2015) në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me Ligjin për mjedis jetësor, donë të thotë që nuk është respektuar në tërësi procedura për miratim të planit detajuar urbanistik të paraparë me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik, për Taftalixhe 1, që shpie në shkelje të parimit të sundimit të së drejtës, si vlerë themelore e rregullimit kushtetues të R. së Maqedonisë së V., për çka Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar që vendimi i kontestuar nuk është në pajtim me nenin 8 paragrafin (1) alinetë 3 dhe 10 të Kushtetutës së R. së Maqedonisë së V., me nenin 15-v të Ligjit për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor dhe me nenin 65 të Ligjit për mjedis jetësor.

Në tjetër rast kur Gjykata ka shqyrtuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e planit detajuar urbanistik për zonën industriale në komunën Kërçovë, ka dhënë këtë mendim “... nga provat në dispozicion, Gjykata ka vlerësuar që mund të mos jetë e nevojshme të konfirmohet që publiku ka qenë i informuar për dhënie Draft-planit të detajuar urbanistik në këqyrje të publikut në pajtim me nenin 18 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik, ashtu që ligjshmëria në këtë pjesë të procedurës mund të vihet në pikëpyetje. Megjithëse nga Raporti për këqyrje të publikut është e dukshme që ka pasur koment të plotësuar nga një qytetar, sidoqoftë mbetet çështja nëse dhe si janë informuar qytetarët për organizim të këqyrjes publike për draft-planin”. Gjykata thekson që duhet të identifikohet publiku i prekur dhe të njëjtit të ftohen.

Në këtë rast, Gjykata ka vendosur për ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e planit të detajuar urbanistik për rajon në komunën Kërçovë dhe ta revokon vendimin për miratim të këtij plani urbanistik, qartë është përmendur që duke mos i marrë parasysh komentet nga publiku konsiderueshëm shkelet procedura e përcaktuar ligjore për miratim të planeve detajuar e urbanistike.

1.6.5.2 Procedurë civile

Në rast të shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë, mund të ngritet procedurë civile kundër personave juridik të cilët shkaktojnë rrezik. Në atë rast, nevojitet të dëshmohet legjitimiteti i tyre, ndërsa paditës duhet të jenë persona të cilët drejtpërsëdrejti i vuajnë pasojat e dëmshme nga burimi i rrezikut. Gjatë procedurës civile, organizatat qytetare mund të paraqiten si palë e tretë. Në atë rast mund të kërkohet mënjanim i rrezikut (në pajtim me nenin 143 të Ligjit për marrëdhënie obligative-LMO), kurse personat fizik mund të kërkojnë edhe në pajtim me nenin 144 të LMO nga gjykata t’u urdhërojë fabrikave të ndërpresin veprimet me të cilat shkelen të drejtat e tyre personale dhe t’i mënjanojnë pasojat e shfaqura me këto veprime. Ngritja e procedurës qytetare, në këtë rast është drejtpërsëdrejti e lidhur me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, ashtu që për atë shkak të njëjtit paraqiten si paditës privat, që çon në ngritje të procedurës penale. Duhet të përmendet që mbajtja e procedurës civile kërkon ekspertiza për t’u dëshmuar lidhja shkak-pasojë ndërmjet paditësit dhe burimit të rrezikut.

⁸² Rregullore e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, nga përmbartimi i akteve konkrete të miratuara në bazë të planit që anulohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të lejohet as të aplikohet, ndërsa nëse zbatimimi është në rrjedhës, i njëjti do të ndërpritet, neni 80

Pikërisht nevoja për t'u dëshmuar se është kryer ndikim i caktuar mbi mjedisin jetësor nëpërmjet ekspertizës është pengesa kryesore në këtë proces, përkatësisht çmimi i lartë të cilin qytetarët duhet ta mbulojnë me harxhim të tyre.

1.6.5.3 Procedura penale

Kodi penal në kapitullin XX i rregullon veprat penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës. Përkatësisht në nenin 218, vepra penale, kundër Ndotjes së mjedisit jetësor dhe natyrës, saktë përmenden lartësitë e dënimeve me burg për veprat penale të kryera për persona fizik. Për vepra të kryera penale nga kapitulli 22 për persona juridik parashihet dënim me para dhe atë për:

1. Atë që me mosrespektim të dispozitave për mbrojtjes dhe avancim të mjedisit jetësor do ta ndotë ajrin, dheun, ujin, sipërfaqen ujore apo rrjedhën ujore në vëllim më të madh apo në zonë më të gjerë dhe me atë do të shkakton rrezik për jetën ose shëndetin e njerëzve apo shkatërrim të botës shtazore ose bimore në përmasa më të mëdha, do të dënohet me burg prej katër deri në dhjetë vite.
2. Personi zyrtar ose përgjegjës në person juridik i cili me mosrespektim të dispozitave për mbrojtje të mjedisit jetësor nuk vendos aparat për pastrim ose do të lejon ndërtim, lëshim në funksion ose shfrytëzim të impiantit që e ndotë mjedisin jetësor apo në mënyrë tjetër nuk ndërmerr masa për parandalim ose pamundësim të ndotjes së ajrit, dheut, ujit, sipërfaqes ujore ose rrjedhës ujore që e tejkalon limitin e lejuar apo për parandalim të zhurmës që konsiderueshëm e tejkalon limitin e lejuar dhe me atë do të shkaktojë rrezik për jetën ose shëndetin e njerëzve ose shkatërrim të botës shtazore dhe bimore në përmasa më të mëdha, do të dënohet me dënim me burg së paku pesë vite.
3. Nëse vepra është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me dënim me para ose me burg prej tre viteve.
4. Gjatë shqiptimit të dënimit me kusht, kryerësit të veprës nga paragrafët (1) dhe (2), gjykata mund t'i imponojë kusht në afat të caktuar t'i ndërmarrë masat e përcaktuara për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor.
5. Nëse veprën nga ky nen e kryen person juridik, do të dënohet me dënim me para.

Kodi penal parasheh edhe dënime me burg edhe për persona fizik, përkatësisht dënim me para për persona juridik të cilët do të kryejnë vepër penale ndotje të ujit për pije, prodhim i mjeteve të dëmshme për mjekim të bagëtive ose kafshëve, rrezikim i mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina, grumbullim dhe menaxhim i paautorizuar me materie nukleare. Në nenin 234 parashihen dënime më të mëdha me burg për persona fizik, kryerës të veprave të rënda kundër mjedisit jetësor dhe natyrës, përkatësisht nëse me veprimin e kryer ndodh lëndim më i rëndë trupor apo çrregullim më i rëndë i shëndetit të më shumë personave, ndodh vdekje e një ose më tepër personave ose ndryshimet nga ndotja nuk mund të mënjanoen kohë të gjatë, ndodh dëm pronësor i përmasave më të mëdha.

Nëse për shkak të veprave nga ky kapitull ka ndodhur përkeqësim i konsiderueshëm i kushteve jetësore në suaza të zonës së mbrojtur të përcaktuar me ligj.

Mënyra e fillimit të procedurës penale dhe pasojat nga fillimi i procedurës janë rregulluar me Ligjin për procedurë penale, në nenin 19 "Procedura penale fillon me lëshim të urdhrimit për zbatim të procedurës hetimore, ose me veprimin e parë të kryer hetimor para se të lëshohet urdhër për zbatim të procedurës hetimore me përcaktim të debatit kryesor për propozim akuzë apo padi private, me propozim për lëshim të urdhrimit për dënim apo me propozim për përcaktim të masës për siguri. Kur është përcaktuar që fillimi i procedurës penale ka pasojat e kufizimit të të drejtave të caktuara, ato ndodhin me miratim të akt-akuzës."

Gjykatat në vend, nga viti 2012 deri sot, kanë miratuar gjithsej 401 aktgjykime lidhur me vepra penale kundër mjedisit jetësor. Pjesa më e madhe e tyre (157) kanë të bëjnë me uzurpim të patundshmërive. Persona që kanë zënë hapësirë publike në natyrë dhe e kanë shfrytëzuar për nevoja të tyre janë dënuar me kush apo me dënime me para. Pjesa e dytë sipas numrit të aktgjykimeve është peshkimi ilegal, për të cilin ka gjithsej 90 vendime gjyqësore. Për peshkim pa

leje janë përcaktuar gjoba ditore deri në dënime me burg prej disa muajve. Ngjashëm kanë kaluar edhe gjahtarët ilegal, për të cilët në këtë periudhë janë miratuar 61 aktgjykime sipas kapitullit për mjedis jetësor në Kodin penal.

Mirëpo, ndotësit më të mëdhenj të natyrës edhe në procedurat e rralla gjyqësore që janë mbajtur kundër tyre, jo vetëm që kanë shpëtuar me dënime me para, por edhe ato aktgjykime kanë dështuar në gjykatat e apelit.

Ekzistojnë raste që janë zgjidhur në dobi të paditësit lidhur me mjedis jetësor.

Pjesë e tyre janë:

Supermarketi nga Gjevgjelia ka lëshuar erë të keqe dhe zhurmë të madhe nga gypat e ventilimit dhe me atë i ka rrezikuar banorët e tre shtëpive. Kjo është vepra e vetme penale ku është gjykuar ndotës i ajrit nga viti 2012 deri sot. Ky aktgjykim është miratuar nga Gjykata e Gjevgjelisë në vitin 2014 dhe është i vetmi që mund të gjendet në arkivin gjyqësor në internet për shtatë vitet e fundit, që ka të bëjë me ndotjen e mjedisit jetësor me mosrespektim të dispozitave. Kompania ka qenë e dënuar me 130.000 denarë, ndërsa menaxheri me 61.500 denarë.

Miniera në pjesën lindore të vendit, për shkak të instalacioneve pa mirëmbajtje për kontroll të zgjyrës, i ka ndotur lumenjtë lokal për tre kategori, nga e dyta në të pestën. Gjykata lokale e ka gjykuar kompaninë me dënim prej 300.000 denarë, menaxheri 61.500 denarë, kurse menaxheri kompetent me 49.200 denarë. Përgjithësisht, jo më pak se 6.700 euro dënime për kompani të madhe ndërkombëtare minierash. Megjithatë, ata janë ankuar dhe gjykata e apelit e ka refuzuar aktgjykimin e gjykatës themelore, me arsyetim se ajo vlen për ndotje edhe të dheut edhe të ujit, ndërsa rezultate nga matjet ka pasur vetëm nga uji.

Në vitin 2016 një banor i Shkupit ka qenë i gjykuar me tre muaj dënim me burg me kusht për rrezikim të mjedisit jetësor me hedhurina, që është edhe një vepër penale nga kapitulli për mjedis jetësor. Në këtë bazë ka pasur tre aktgjykime, mirëpo vetëm një ka kaluar me dënim. Ai ka qenë grumbullues i ambalazhit prej plastikës, e ka grumbulluar në oborrin e vet në Shkup. Gjykata ka konstatuar që ka kryer menaxhim me hedhurina pa poseduar leje përkatëse për atë, ndërsa me grumbullimin e ambalazhit në oborr e ka rrezikuar mjedisin rreth pronës së tij. Atij i është përcaktuar dënim me kusht për shkak se ka qenë i varfër, mirëpo është dashur të paguan paushall prej 1.000 denarë për shpenzime gjyqësore.

Një banor i Prilepit ka qenë i gjykuar me një vit burg për veprën e njëjtë, për shkak se edhe pse ka pasur ndërmarrje të regjistruar për grumbullim dhe për tregti me hedhurina të parrezikshme, ai ka marrë hedhurina drejtpërsëdrejti nga qytetarë dhe ua ka shitur firmave tjera, ndërsa mjetet (rreth 100 mijë euro) i ka futur në llogari të vet. Aktgjykimi thotë që është i gjykuar për rrezikim të mjedisit jetësor me hedhurina.

Në arkivat gjyqësore ka aktgjykime kundër ndërmarrjeve publike në dy komuna për shkak se e kanë rrezikuar mjedisin jetësor me hedhurina.

Njëri është kundër NPK Tetovë dhe drejtorit Xhelal Ceka në vitin 2016. Gjykata themelore në Tetovë e ka gjykuar ndërmarrjen të paguan dënim prej 100.000 denarë, ndërsa gjykatat e apelit në Gostivar, pas ankesës në prokurori e ka rritur dënimin në 200.000 denarë.

Gjykata e apelit të Shkupit ka anuluar aktgjykim të gjykatës së Velesit kundër ndërmarrjes publike të një nga komunave të rrethinës, e cila ka qenë e dënuar të paguan 100.000 denarë për shkak të ndotjes së ujit në një fshat. Arsyetimi ka qenë se të dhënat nuk kanë qenë të sakta për cilën periudhë supozohet ndotja.

Prokuroria themelore publike Shkup e cila në bazë të informatave ka hapur procedurë për Ndotje të mjedisit jetësor dhe natyrës për vepër penale, Ndotje të mjedisit jetësor dhe natyrës nga neni 218 i Kodit Penal. Në drejtim të përcaktimit të fakteve, organi kompetent publik ka dërguar kërkesë në Ministrinë për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor për të marrë të dhëna të nevojshme lidhur me kontrollin e kryer të deritanishëm për punën e deponisë DRISLLA-SHKUP SHPK, si dhe në rast se është kryer kontroll, a është konstatuar respektim i protokolleve për djegie të hedhurinave mjekësore nga ana e deponisë dhe informata tjera.

MPB-ja ka parashtruar kallëzime penale kundër ELEM për ndotje të mjedisit jetësor dhe natyrës, si dhe kundër pesë drejtorëve të mëparshëm dhe udhëheqës të KEX "Manastir", të dyshuar për bashkëpjesëmarrje në vepër penale. Sipas buletinit të MPB-së të dyshuar për

bashkëpjesëmarrje në ndotje të mjedisit jetësor dhe të natyrës janë I.K. (63) nga Gostivari, ish drejtor i degës së KEX Manastir, J.K. (67) nga Manastiri, drejtor i degës së KEX Manastir, O.Z. (54) nga Manastiri, drejtor i KEC Manastir, Z.M. (44) nga Manastiri, udhëheqës në Degën KEX Manastir dhe kundër S.A. (63) nga Manastiri, udhëheqës në Filialin e KEX Manastir. Përkatësisht, me denoncim paraprak në SPB Manastir dhe Prokurorinë Themelore Publike në Manastir, janë bërë një sërë kontrollesh me ç'rast është konstatuar që personat e denoncuar fizik, me mosrespektim të rregullave për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor, nuk i kanë rikonstruktuar filtrat ekzistues apo nuk kanë vendosur filtra të ri për pluhur. Kanë lejuar nëpërmjet punës së KEX të lëshohen grimca të dëmshme me sasi më të madhe se 50 miligram për metër kub. Gjithashtu, personat fizik të denoncuar kanë lejuar të bëhet mënjanim i hirit në depo, ku shpesh janë krijuar vorbuj ajror të hirit me dhe. Në atë mënyrë kanë shkaktuar rritje të indikatorit statistikor të ndotjes së ajrit në qytetin e Manastirit, që paraqet rrezik për shëndetin e njerëzve.

1.6.5.4 Procedurë administrative

Procedura administrative inicohet me kërkesë të palës apo nga organ publik me detyrë zyrtare, kur kategorikisht është konstatuar me ligj dhe kur organi publik do të mësojë fakte të cilat ua kërkojnë të mban procedurë administrative me qëllim të mbrohet interesi publik.

Procedurën administrative e inicion organ kompetent me detyrë zyrtare apo me kërkesë të palës. Procedura për ngritje të kontestit administrativ është rregulluar me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, në Kapitullin IX, nenin 51 dhe neni 52. Për lëndët të cilat sipas Ligjit apo natyrës së tyre nevojitet kërkesë nga pala, organi kompetent mund të iniciojë dhe të mbajë procedurë vetëm nëse ekziston kërkesë e tillë. Pasi të iniciohet procedura, organi kompetent duhet t'i përcaktojë të gjitha faktet dhe rrethanat që janë me rëndësi për t'u miratuar aktvendim dhe palëve t'u mundësojë t'i realizojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike. Këto veprime mund të kryhen në procedurë të shkurtuar ose në procedurë të veçantë testimi.

Formalisht, Ligji për procedurë të përgjithshme administrative e identifikon parimin e mjetit juridik, përkatësisht palët e prekura kanë të drejtë të kontestojnë çdo veprim administrativ (apo lëshim) përkatësisht akt administrativ (shkalla e parë – pranë trupit të njëjtë që e ka miratuar aktin; shkalla e dytë – pranë Komisionit shtetëror të pavarur; shkalla e tretë – Gjykata administrative).

o konfirmohet me nenin 104 të Ligjit të njëjtë, ku qartë është përcaktuar që “pala ka të drejtë për mjet juridik kundër çdo veprimi apo lëshimi administrativ, nëse vlerëson që i shkel të drejtat apo interesin juridik” (shoqatat qytetare nga sfera e mjedisit jetësor, konsiderohen si palë me interes juridik në konteste nga sfera e mjedisit jetësor).

Gjykata administrative e ka anuluar aktvendimin e Komisionit shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative me të cilën refuzohet ankesa kundër licencës së lëshuar ekologjike për projektin, për ankesë kundër aktvendimit të parashtruar nga shoqata e qytetarëve Front 21/42. Licenca e lëshuar ekologjike për projektin Ura e Boshkut e lëshuar nga Ministria për Mjedis Jetësor në vitin 2012 kthehet në veprim të serishëm.

“Për gjykatën nuk ekzistojnë prova që në lëshimin e licencës ekologjike për KEX “Ura e Boshkut” tërësisht është respektuar procedura në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor. Gjykata ka konfirmuar që faktet janë përcaktuar në mënyrë të paplotë dhe të gabuar dhe se në procedurën nuk është mbajtur llogari për rregullat e procedurës. Duke e pasur parasysh këtë, gjykata e anuloi vendimin e Komisionit lidhur me ankesën e parashtruar kundër aktvendimit me të cilin lëshohet licencë ekologjike për projektin KEX “Ura e Boshkut” dhe e ktheu lëndën në veprim të serishëm”

Projekti “Ura e Boshkut” parashihte ndërtim të hidrocentralit 68MW në Parkun Nacional Mavrovë. Licencën ekologjike për këtë projekt Ministria për Mjedis Jetësor e ka lëshuar më vitin 2012. Aktvendimi është ankimuar pranë Komisionit shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë me

arsyetimin që studimi ekologjik për këtë projekt në bazë të të cilit është lëshuar licenca nuk është i kompletuar. Kjo donë të thotë që Ministria e ka lëshuar licencën në kundërshtim me Ligjin për mjedis jetësor.

Në vitin 2013 Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative ka miratuar aktvendim me të cilin e refuzoi ankesën dhe e konfirmoi aktvendimin e Ministrisë për Mjedis Jetësor. Nga viti 2013 kjo lëndë ishte para Gjykatës Kushtetuese.

“Për gjykatën administrative, nuk është e qartë si komisioni shtetëror ka pranuar që aktvendimi i shkallës së parë është miratuar në pajtim me ligj dhe që miratimit i ka paraprirë procedurë e plotë dhe e detajuar dhe që janë grumbulluar të gjitha provat”, shkruan në aktgjykimin e gjyqit.

Gjykata ka konstatuar që Ministria për Mjedis Jetësor është dashur të miratojë aktvendim për licencë ekologjike në bazë të studimit të plotë për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor, raport për përputhshmëri të këtij studimi dhe rezultati nga konsultimet me publikun. Kjo nuk ka ndodhur. Përveç kësaj, ministria është dashur në aktvendim t’i përmend masat konkrete për parandalim, kufizim, zbutje ose zvogëlim të ndikimeve të dëmshme, si dhe masat për rritje të ndikimeve të volitshme mbi mjedisin jetësor si rezultat i zbatimit të projektit.

Përlicencën ekologjike për Urë e Boshkut enderrjedhë procedurë administrative. Përkatësisht, në kundërshtim me Ligjin për mjedis jetësor, validiteti i aktvendimit të kontestueshëm për projektin Ura e Boshkut në vitin 2014 është vazhduar nga Ministria për Mjedis Jetësor. Për këtë kundërvajtje, në qershor të vitit 2015 është ngritur edhe një procedurë ankimore pranë komisionit shtetëror.

Projekti KEX “Ura e Boshkut” u gjend edhe para Konventës së Bernit në vitin 2015 kur u miratua rekomandimi për stopim të të gjitha projekteve të planifikuara në Parkun Nacional Mavrovë.

Fakt shtesë që ka shkelje të Ligjit për mjedis jetësor është që para miratimit të aktvendimit, KEX Ura e Boshkut (që i plotëson kërkesat për mbrojtje të mjedisit jetësor), nga ana e ELEM-it është dërguar shkresë me të cilën e ka informuar Ministrinë për Mjedis Jetësor që ende nuk kanë filluar aktivitete për monitorim ekologjik të projektit. Qëllimi i këtij monitorimi ka qenë përcaktim i gjendjes zero të ajrit, rrjedhave ujore dhe nivelit ambientaal të zhurmës, si dhe të gjendjes me shumëllojshmërinë biologjike në zonën që është përfshirë nga ndërtimi dhe funksionimi i KEX Ura e Boshkut. Ky monitorim është i domosdoshëm për përcaktim të masave të cilat do të reduktonin ndikimin nga projekti. Analizat e këtilla duhet të jenë pjesë përbërëse e Studimit për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor, kurse të mos ndodhin pas përpilimit dhe miratimit të saj.

Megjithëse nga Prokuroria Themelore Publike Shkup në bazë të informatës kanë hapur lëndë për punë në deponinë për vepër penale ndotje e mjedisit jetësor dhe natyrës, paralelisht koncesionari aktual i deponisë “Drislla”, është edhe në një betejë pranë Gjykatës administrative. E drejta për koncesion e FLC Ambiente nga Italia kontestohet pasi fitoi tenderin në vitin 2013.

Gjykata administrative në aktgjykimin e fundit thotë që kompania nuk ka pasur aspak përvojë dhe ka qenë e formuar dy ditë para afatit të vazhduar për skadim të tenderit. Partneri i konsorciumit Unieko që e ka formuar firmën në fakt është marrë me ndërtimtari dhe prodhim të tullave dhe nuk ka pasur as qarkullimin e nevojshëm të mjeteve. Gjykata administrative, sipas aktgjykimin e pranoi padinë e kompanisë gjermane Shollc dhe e angazhon kryetarin e Qytetit të Shkupit ta firmosë marrëveshjen për investim të përbashkët në ndërmarrjen publike. Qyteti i Shkupit posedon 20 përqind të deponisë.

1.6.5.5 Procedurë për kundërvajtje

Derisa procedurat penale mbahen kundër gjahtarëve individual ilegal, peshkatarëve ilegal, prerësve të drunjtve, grumbulluesve të hedhurinave dhe të tjerë, ndotësit fitojnë dënime mandatore apo fletëparaqitje për kundërvajtje. Raporti i fundit i publikuar në faqen e Inspektoratit Shtetëror për mjedis jetësor ka të bëjë me vitin 2014, kur janë miratuar 366 aktvendime me të cilat urdhërohet

të korrigohet ndonjë parregullsi, 28 aktvendime për ndalesë për punë, ndërsa janë iniciuar 72 procedura për kundërvajtje dhe asnjë procedurë penale.

Megjithëse Ligji për kundërvajtje është krejtësisht i harmonizuar me Ligjin për mbrojtje të mjedisit jetësor, që e bën më të lehtë denoncimin e kundërvajtjeve se sa të veprave penale, inspektorët për mjedis jetësor nga Shkupi, sipas raportit të tyre për vitin 2017 për tërë vitin kanë parashtruar një kërkesë për t'u ngritur procedurë për kundërvajtje dhe asnjë për procedurë penale, që mund të jetë indikacion për mungesë të kapacitetit të inspektorëve që më tepër të dalin në terren, të zbatojnë më tepër mbikëqyrje dhe më shumë të shqiptojnë dënime.

Sipas kryetarit të Shkupit, Petre Shilegov në seancë të Këshillit të Qytetit të Shkupit, numri i dënimeve të shqiptuara është rritur dyfish në krahasim me vitin 2017. Siç ka shtuar, në shtator 2018 janë shqiptuar 137 dënime mandatore, ndërsa në tetor 220 paralajmërime dhe 132 dënime. Janë dënuar ndërmarrjet të cilat nuk i kanë respektuar kushtet për B-licencën e integruar ekologjike, objektet ndërtimore si dhe personat që kanë vepruar në mënyrë joadekuate me hedhurinat.

Për momentin lufta për mjedis jetësor më të pastë vazhdon me pagesë të kundërvajtjeve, si dhe me procedurë penale, të cilat më së shpeshti përfundojnë me dënime me para apo me anulim të aktgjykimeve.

1.6.5.6 Ankesë për aktvendim apo vendim në Komision të Qeverisë

Ndër veglat të cilat qytetarët i kanë në dispozicion në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor është edhe ankesa për aktvendim apo vendim në Komisionin e Qeverisë për zgjidhje të punëve administrative në shkallë të dytë, përkatësisht Komision për zgjidhje në shkallë të dytë për ankesa lidhur me aktvendimet e lëshuara nga Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor. Në afat prej 14 deri 30 ditëve nga publikimi i ndonjë vendimi, i njëjti mund ankimohet pranë organit publik përkatës, ndërsa nëse ky mekanizëm nuk funksionon, mund të ngritet edhe kontest administrativ.

1.6.6. Mekanizma rajonale për mbrojtje gjyqësore në dispozicion të qytetarëve në RMV

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut është mekanizëm që mund të përdoret nëse janë apsolvuar të gjitha mjetet juridike në shtetin amë dhe nëse shteti e ka ratifikuar Konventën për të drejta të njeriut.

Konventa bën ndarje ndërmjet dy llojeve të ankesave: individuale, e parashtruar nga një person, grup individësh, kompani apo organizatë joqeveritare dhe ankesë ndërshtetërore, e parashtruar nga një shtet kundër një shteti tjetër. Nga themelimi i Gjykatës, pothuaj të gjitha ankesat janë parashtruar nga individë të cilët janë adresuar me rastet e tyre drejtpërsëdrejti në Gjykatë, duke vlerësuar që janë viktima të një ose më tepër shkeljeve të përcaktuara në Konventë.

Ankesat mund të parashtrohen drejtpërsëdrejti nga individë, Ndihmë nga avokati nuk është e domosdoshme në fillim të procedurës. Mjafton që në Gjykatë të dërgohet formular për ankesë, i plotësuar në mënyrë të drejtë si dhe dokumentet e nevojshme lidhur me ankesën. Megjithatë, regjistrimi i ankesës nga ana e Gjykatës nuk paraqet garanci që ankesa do të pranohet ose çështja në fjalë do të jetë e bazuar. Sistemi i Konventës siguron qasje "të lehtë" në Gjykatë, duke i mundësuar secilit individ të parashtrorë ankesë, madje edhe nëse ai/ajo jeton në rajon të largët të shtetit anëtar apo nëse nuk posedon aspak mjete financiare.

Duke e pasur parasysh të lartpërmendurën, nuk ka shpenzime për procedurën pranë Gjykatës. Ankesat duhet të plotësojnë numër të caktuar të kritereve që të mund të shpallen si të pranueshme nga Gjykata. Në të kundërtën, ankesat nuk do të jenë aspak të shqyrtuara. Ankuesi duhet të ketë qenë, personalisht apo drejtpërsëdrejti, viktimë e shkeljeve të parapara në Konventë dhe duhet të ketë pësuar dëm të konsiderueshëm. Ankesat mund të parashtrohen vetëm nëse kundër një ose më shumë shteteve anëtare të Konventës, ndërsa jo kundër cilit do shtet apo individ tjetër.

Organizatrat joqeveritare dhe shtetet kanë të drejtë të parashtrorë ankesa. Nga ana e kryetarit të Gjykatës, atyre mund t'u lejohet të intervenojnë në procedurë si palë e tretë. Kryetari i Gjykatës mund t'i lejojë ndonjë personi tjetër, përveç palës që ankohet, si dhe të secilit shtet nënshkruar të Konventës, përveç atij kundër të cilit është parashtruar ankesa, të intervenojë në procedurën.

Kjo situatë quhet intervenim i palës së tretë. Personi apo shteti në fjalë ka të drejtë të dërgojë parashtrësia dhe të marrë pjesë në debatet publike.

Kur Gjykata pranon ndonjë ankesë, mund të vendos që shteti kundër të cilit ajo është parashtruar, duhet të ndërmarrë masa të caktuara të përkohshme derisa në ndërkohë Gjykata e shqyrton rastin. Këto masa zakonisht përbëhen nga kërkesa që shteti që përmbahet nga zbatimi i veprimeve të caktuara.

Disa ankesa mund të jenë të kualifikuara si urgjente dhe zgjidhja e tyre është prioritare. Situata e këtillë në raste ku ka të dhëna nga ankuesi që ai ose ajo ballafaqohet me rrezik të drejtpërdrejtë të lëndimit fizik.

Lidhur me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejta të njeriut (GJEDNJ), ku ka lidhje të mbrojtjes së mjedisit jetësor me të drejtën për jetë dhe të drejta tjera siç janë e drejta për mbrojtje të jetës private dhe familjare, e drejta për mjet juridik efikas janë:

L'Erabliere A.S.B.L. v.s. Belgium. Procedura e organizatës joqeveritare për mjesi jetësor me të cilën kontestohet licenca për planifikim urbanistik, e refuzuar për shkak se në të njëjtën nuk janë përshkruar faktet e rastit, mirëpo gjykata i ka ditur faktet nga procedura paraprake gjyqësore.

Locascia and Others v. Italy (no. 35648/10) e iniciuar nga 19 aplikues, të cilët jetojnë në komunën Caserta dhe San Nicola La Strada në bazë të nenit 2 dhe nenit 8 të Konventës, ankohen për rrezikun mbi shëndetin e tyre dhe për pengesë të realizimit të së drejtës për jetë private dhe shtëpi për shkak të aktiviteteve të fabrikës LO Utaro dhe për dështimin e autoriteteve të sigurojnë pastrim pasi është mbyllur fabrika. Ky rast është në rrjedhë.

Cordella and Others v. Italy (no. 54414/13) (52 aplikues) dhe Ambrogi Melle and Others v. Italy (no. 54264/15) (130 aplikues). Këta aplikues, të cilët jetojnë në afërsi të Tarantos pohojnë që autoritetet nuk kanë arritur ndërmarrin masat përkatëse për ta mbrojtur mjedisin jetësor dhe shëndetin e personave dhe thirren në shkelje në nenet 2, 8 dhe 13 të Konventës. Ky rast është në rrjedhë.

PJESA II: PRAKTIKË GJYQËSORE NË EVROPË ME FOKUS NË MJEDISIN JETËSOR DHE NDIHMËN JURIDIKE FALAS

2.1 Hyrje – zhvillim i praktikë gjyqësore

Në nivel ndërkombëtar, përkatësisht në suaza të OKB-së, nëse ndonjë shtet e shkel të drejtën e qytetarëve të vet, ata individualisht apo në mënyrë kolektive mund të parashtrorjnë ankesa për shkeljen e të drejtave të tyre të mbrojtura me protokollet fakultative në disa prej konventave në Komitetin për të drejta të njeriut të garantuara me Traktat ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike; Komitetin për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor; në Komitetin për eliminim të diskriminimit të gruas për të drejtat e garantuara me Konventën për ndalim të të gjitha formave të diskriminimit të grave; Komitetin kundër torturës për të drejtat e garantuara me Konventën kundër torturës; Komitetin për të drejtat e fëmijëve për të drejtat e garantuara me Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, Komitetin për të drejtat e personave me pengesa në pajtim me Konventën për të drejtat e personave me pengesë dhe ngjashëm. Në suazat e Konventës së Aarhusit, ky është Komiteti për harmonizim apo i ashtuquajtur Komiteti ankimor i Aarhusit. Këto procedura mund t'i shqyrtojmë si mekanizma jashtëgjyqësor. Në anën tjetër, ekzistojnë dy mekanizma kyç rajonal gjyqësor të cilët e garantojnë qasjen në drejtësi të qytetarëve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

2.1.1 Gjykata Evropiane e drejtësisë

Gjykata e Bashkimit Evropian për drejtësi⁸³ (Gjykata) është kompetente për të ndjekur nëse ligjet e BE-së interpretohen dhe aplikohen në mënyrë të barabartë në secilin prej vendeve anëtare, me fjalë tjera, a janë ligjet e BE-së identike për të gjitha palët dhe në të gjitha kushtet. Për këtë qëllim Gjykata e kontrollon anën juridike të procedurave të institucioneve të BE-së, kontrollon nëse vendet anëtare i plotësojnë obligimet e tyre dhe i interpreton ligjet e BE-së me kërkesë të gjykatave nacionale.

Gjykata ka autorizim për t'i zgjidhur kontestet juridike ndërmjet vendeve anëtare, institucioneve të BE-së, bizneseve dhe individëve. Me qëllim të përballet me mijëra rastet që i pranon, Gjykata është ndarë në dy trupa kryesor: Gjykata e drejtësisë, që punojnë me kërkesat për aktgjykime preliminare nga gjykatat nacionale, veprime të caktuara për anulim dhe ankesa; dhe Gjykata e Përgjithshme e cila vendos për të gjitha veprimet për anulim, të iniciuara nga individë apo kompani, si dhe disa procedura të ngjashme të ngritura nga vendet anëtare. Tribunali për administratë publike, i cili është tribunal special, gjykon gjatë kontesteve ndërmjet BE-së dhe punonjësve të saj.

Gjykata sjell vendime për rastet që janë parashtruar prej tij. Katër llojet më të shpeshta të rasteve janë:

1. *Aktgjykim preliminar.* Gjykatat në çdo vend anëtar të BE-së janë përgjegjëse për zbatim të drejtë të ligjeve të BE-së në atë vend. Nëse ndonjë gjykatë nacionale ka çfarëdo dyshimi rreth interpretimit apo validitetit të ligjeve të BE-së, mund kurse ndonjëherë edhe e ka patjetër të kërkojë këshillë nga Gjykata e drejtësisë. Kjo këshillë jepet në formë të “aktgjykimit preliminar” obligativ. Kët aktgjykime janë kanal i rëndësishëm për qytetarët për të përcaktuar në çfarë mase, nëpërmjet gjykatave të tyre nacionale, ligjet e BE-së ndikojnë në jetën e tyre.

83 Përshkrim i Bashkimit Evropian–Si punon Bashkimi Evropian, botues Komisioni Evropian, viti 2012, European Commission official web side, European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations, European Commission - Enlargement - Europe agreement, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/europe-agreement_en [hapur më 14.05.2019]

2. *Procedura për konstatim të shkeljes.* Komisioni ose (shumë rrallë) ndonjë vend anëtar, mund të iniciojë procedurë nëse ata për çfarë do arsye konsiderojnë që ndonjë vend anëtar nuk i plotëson obligimet e veta në pajtim me ligjet e BE-së. Gjykata i hulumton të gjitha të dhënat dhe sjelle aktgjykim. Nëse konstatohet që është bërë shkelje, vendi i akuzuar anëtar duhet t'i përmirësojë gjërat pa prolongim me qëllim t'i shmangë dënimet që mund t'i aplikojë Gjykata.
3. *Veprime për shfuqizim.* Nëse cili do prej vendeve anëtare, Këshilli, Komisioni ose (në kushte të caktuara) Parlamenti, konsiderojnë që ndonjë ligj i BE-së nuk është legal, ata mund të kërkojnë nga Gjykata ta shfuqizojë. Këtë "procedurë për shfuqizim" mund ta shfrytëzojnë edhe individë që dëshirojnë Gjykata të anulojë ndonjë ligj për shkak se i njëjti ka pasoja të drejtpërdrejta negative mbi ata.
4. *Veprime për mosveprim.* Në pajtim me Marrëveshjen, Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni duhet të miratojnë vendime të caktuara në kushte të caktuara. Nëse këtë nuk e bëjnë vendet anëtare, institucionet e BE-së dhe (në kushte të caktuara) individë ose kompani, mund të dërgojnë ankesë në Gjykatë për regjistrim zyrtar të kundërvajtjes.
5. *Procedurë.* Gjykata e drejtësisë përbëhet nga 28 gjykatës, nga një prej secilit vend anëtar, për t'u siguruar që ajo i përfaqëson të gjitha sistemet juridike nacionale. Gjykatës i ndihmojnë tetë "avokatë të përgjithshëm", të cilët japin mendime për rastet që janë parashtruar në Gjykatë. Ata duhet atë ta bëjnë në mënyrë publike dhe objektive. Gjykatësit dhe avokatët e përgjithshëm janë ose ish anëtarë të gjykatave më të larta nacionale ose ekspertë juridik të cilët gëzojnë reputacion të lartë dhe në pavarësinë e cilëve nuk ka asnjë dyshim. Ata i përcaktojnë qeveritë e vendeve anëtare me marrëveshje të përbashkët. Secili prej tyre caktohet me mandat prej gjashtë viteve. Gjykatësit në këtë gjykatë zgjedhin kryetar mandati i të cilit është tre vite. Gjykata e drejtësisë mund të kryesojë me përbërje të plotë, si kryesi e madhe prej 13 gjykatës apo kryesi prej pesë ose tre gjykatësve, varësisht prej kompleksitetit dhe rëndësisë së rastit. Rreth 60% të rasteve i shqyrton Mbledhja prej pesë gjykatësve, ndërsa 25% të tyre i shqyrton Kryesia prej tre gjykatësve.

Gjykata e përgjithshme gjithashtu përbëhet nga 28 gjykatës të caktuar nga ana e vendeve anëtare me mandat prej gjashtë viteve. Gjykatësit në Gjykatën e Përgjithshme gjithashtu zgjedhin Kryetar nga radha e tyre me mandat prej tre viteve. Kjo Gjykatë kryeson në suaza të kryesive prej tre apo pesë gjykatës (ndonjëherë edhe vetëm një gjykatës) për të mbajtur dëgjime. Në dëgjimet për rreth 80% të rasteve në Gjykatën e Përgjithshme marrin pjesë nga tre gjykatës. Kryesia e madhe prej 13 gjykatës apo përbërja e plotë prej 28 gjykatësve mund të kryesojnë nëse kompleksiteti dhe rëndësia e rastit e arsyeton atë.

Të gjitha rastet parashtrohen në Regjistrin e Gjykatës, me ç'rast për çdo rast veçmas ndahet një gjykatës dhe avokat i përgjithshëm. Menjëherë pas parashtrimit fillon procesi gjyqësor që zhvillohet në dy faza: me shkrim dhe me gojë. Në fazën e parë, të gjitha palët e përfshira dorëzojnë deklaratat me shkrim, ndërsa gjykatësi i cili e udhëheq rastin përpilon raport i cili paraqet përmbledhje të deklaratave dhe e përcakton bazën juridike të rastit. Gjykata diskuton për raportin në takimin e përgjithshëm dhe vendos për atë se çfarë përbërje gjyqësore do ta dëgjon rastin dhe për atë se a nevojiten argumente me gojë. Pastaj vijon faza e dytë – dëgjimi publik, kur avokatët e paraqesin rastin e tyre pranë gjykatësve dhe avokatëve të përgjithshëm, të cilët mund të parashtrojnë pyetje të dedikuara për ata.

Pas dëgjimit me gojë, avokatët e përgjithshëm të caktuar për rastin konkret përgatisin mendimin e tyre. Në pajtim me këtë mendim, gjykatësi përgatit propozim-aktgjykim që u dërgohet gjykatësve tjerë për shqyrtim. Pastaj gjykatësit diskutojnë dhe e miratojnë aktgjykimin. Gjykata i miraton aktgjykimet me votim të shumicës dhe i shqipton në dëgjim publik. Në të shumtën e rasteve, teksti i aktgjykimit përkthehet në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së ditën e njëjtë. Mendimet e ndara nuk janë të përfshira.

Jo të gjitha rastet e ndjekin këtë procedurë. Për rastet me karakter urgjent ekzistojnë procedura të thjeshtësuara dhe urgjente që i mundësojnë gjykatës ta sjellë aktgjykimin në afat prej rreth tre muajve.

2.1.1.1 Gjykata e drejtësisë dhe implementim i Konventës së Aarhusit

Analiza e deritanishme tregon që edhe në nivel evropian qasja në drejtësi në raste ekologjike përmban disa mungesa të mëdha veçanërisht në nivel të gjykatave nacionale⁸⁴ të cilat jo gjithmonë janë në gjendje ta mbështesin sistemin e mbrojtjes gjyqësore të pranishëm në nivel të BE-së për aktivitete të drejtpërdrejta ekologjike.

Të përballur me qasjen shumë konservative të gjykatave të BE-së lidhur me kërkesat për tolerim, siç është propozuar nga më shumë hulumtues evropian, zgjidhje do të ishte të përpilohet amendament për nenin 263 (4) të marrëveshjes për BE me qëllim të mundësohet qasje më e mirë në drejtësi në rastet e mjedisit jetësor në nivel të BE-së.⁸⁵ Në fakt, me miratimin e Konventës së Aarhusit, legjislacioni i BE-së në një mënyrë e anashkalon procedurën e rëndë të ndryshimit të neneve nga Marrëveshja për BE, vetëm për të mundësuar qasje më të gjerë në drejtësi në rastet e mjedisit jetësor.

Me refuzimin të përdoret Konventa e Aarhusit si kriter referent për shqyrtim të ligjshmërisë së rregullores së Aarhusit, GJDBE i anuloi pritjet e atyre që besonin që përfundimisht gjykatësit e BE-së do të jenë të përgatitur për ta braktisur, sipas publikut të ekspertëve, qasjen e vjetëruar të Plaumanit në rastet ekologjike.

Sipas publikut të ekspertëve, GJDBE-ja vendosi ta injorojë nenin 9 (3)⁸⁶ nga Konventa e Aarhusit edhe përkrah referimit eksplisit në dispozitën e fundit në rregulloren e Aarhusit. Rezultati i tërthortë i asaj është që e ka kufizuar relevancën e rregullores së Aarhusit për vendime të cilat mund të ndikojnë në interesat e pranuesve të atyre vendimeve, me çka përjashtohet revizioni administrativ për pjesën më të madhe të akteve në BE në sferën e mjedisit jetësor.

Kritikët e ashpër kontestojnë që aktgjykimet e GJDBE-së duhet të kualifikohen si hap i madh mbrapa për mbrojtje gjyqësore në çështjet lidhur me mjedisin jetësor në nivel të BE-së. Është përcaktuar që, në vend që të adresohen dështimet e tanishme të BE-së lidhur me qasjen në drejtësi në rastet ekologjike, GJDBE qasja e hap rrugën edhe për një dekadë mosrespektim nga ana e BE-së në fushën e qasjes në drejtësi për rastet që e prekin mjedisin jetësor.

2.1.2. Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut është formuar më vitin 1959. Ajo i rregullon kërkesat individuale apo shtetërore për shkelje të supozuara të të drejtave qytetare dhe politike të përcaktuar në GJEDNJ. Gjykata punon me orar të plotë pune nga viti 1998 dhe tek e njëjta mund të adresohen drejtpërsëdrejti individë. Për pothuaj pesëdhjetë vite Gjykata ka miratuar më shumë se 10.000 aktgjykime. Aktgjykimet janë obligative për vendet e prekura dhe i kanë detyruar qeveritë ta ndryshojnë legjislacionin dhe praktikën administrative të tyre në spektër të gjerë të fushave. Praktika e Gjykatës e bën Konventën instrument të fuqishëm për plotësim të sfidave të reja dhe fuqizimin e sundimit të së drejtës dhe demokracisë në Evropë. Gjykata është me seli në Strazbur prej nga e ndjek respektimin e të drejtave të njeriut për 800 milionë evropian në 47 vende-anëtare të Këshillit të Evropës që e kanë ratifikuar Konventën.⁸⁷

84 Marrëveshja për BE, Gjykatat e BE-së janë të obliguara me marrëveshjet ndërkombëtare që i lidh BE-ja, European Commission official web site, European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations, European Commission - Enlargement - Europe agreement, neni 216, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/europe-agreement_en [hapur më 11.04.2019]

85 Hendrik Shukens, Qasje në drejtësi në rastet e mjedisit jetësor për aktgjykimet e Gjykatës së drejtësisë, 13 janar 2015, <https://www.utrechtjournal.org/articles/10.5334/ujiel.di/> [hapur më 21.06.2019]

86 86 Konventa e Aarhusit, "Secila palë do të përkujdeset, subjektet e publikut (që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin nacional, nëse ekzistojnë) të kenë qasje në procedurat administrative ose gjyqësore për kontestim të akteve dhe lëshimeve nga ana e personave fizik dhe autoriteteve publike, që janë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nacional të asaj pale nënshkruese lidhur me mjedisin jetësor", neni 9 paragrafi (3)

87 Konventa evropiane për të drejtat e njeriut, https://www.echr.coe.int/Documents/Court_in_brief_ENG.pdf [hapur më 25.04.2019]

Pjesa II (neni 19-51) i GJEDNJ e rregullon Gjykatën për drejta të njeriut, strukturën e vet, organizimin dhe juridiksionin. Rregullorja e gjykatës është dokument i veçantë me të cilin rregullohet gjithë procedura në më shumë detaje. GJEDNJ është gjykatë ndërkombëtare, e cila është themeluar në vitin 1959. Gjykata vendos për ankesa të cilat janë parashtruar nga individë (neni 34) apo shtete (neni 33), në të cilat janë paraqitur konstatime ankimore për shkeljen e të drejtave qytetare dhe politike të përcaktuara me Konventë. Aktgjykimet e Gjykatës janë obligative për shtetet e caktuara dhe si rezultat i atyre aktgjytimeve, qeveritë e ndryshojnë legjislacionin dhe praktikë administrative në më shumë fusha.

Neni 35 i përcakton kriteret për pranueshmëri, ashtu që: Gjykata mund të pranojë rast vetëm pasi të apsolvohen të gjitha mjetet juridike nacionale, në bazë të parimeve përgjithësisht të pranuar nga e drejta ndërkombëtare dhe në afat prej 6 muajve llogaritur nga data kur është miratuar vendimi final i brendshëm (intern). Gjykata nuk do të pranojë asnjë ankesë individuale të parashtruar në bazë të neni 34, kur a) ankesa është anonime; ose b) kur në esencë është e njëjtë sikur edhe ankesa të cilët Gjykata e ka shqyrtuar paraprakisht ose veç më e ka dorëzuar në instancë tjetër ndërkombëtare hetimore ose gjyqësore dhe nëse nuk përmban fakte të reja. Gjykata nuk do të pranojë asnjë ankesë individuale të parashtruar në bazë të neni 34, nëse vlerëson që: a) ankesa nuk është kompatible me dispozitat e Konventës ose protokollet e saj, nëse është dukshëm e pabazë apo nëse me atë keqpërdoret e drejta për ankesë individuale, ose b) parashtruesi nuk ka pësuar dëm të konsiderueshëm, përveç nëse respektimi i të drejtave të përkufizuara në Konventë apo protokollet e saj kërkon shqyrtim të ankesës sipas bazueshmërisë dhe me kusht të mos mund të refuzohet rast në bazë të asaj që nuk është shqyrtuar si duhet nga gjykata e vendit. 4. Gjykata do të refuzon çdo ankesë që e vlerëson si të papranueshme në bazë të këtij neni. Në atë mënyrë Gjykata mund të veprojë në çfarë do shkalle të procedurës.⁸⁸ Numri i gjykatësve është i barabartë me numrin e shteteve anëtare të Konventës (për momentin 47). Gjykatësit kanë cilësi të gjykatësit individ dhe nuk e përfaqësojnë shtetin nga i cili janë zgjedhur. Mandati i gjykatësve është me kohëzgjatje prej nëntë viteve pa mundësi për zgjedhje të sërishme.

Gjykatësit i shqyrtojnë lëndët në katër formacione të ndryshme:

1. gjykatës individ i shqyrton ankesat të cilat dukshëm janë refuzuar pa pranueshmëri (neni 27);
2. Komisioni i formuar nga tre gjykatës mund të vendosë unanimisht për pranueshmërinë dhe të drejtat ligjore të palës në lëndë, të cilat veç më janë përfshirë me praktikën mirë të vendosur gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 28);
3. Këshilli prej shtatë gjykatësve që vendos me votim të shumicës në lidhje me pranueshmërinë dhe të drejtat ligjore të palës në lëndë (neni 29); dhe
4. në raste të veçanta, Këshilli i madh gjyqësor i formuar nga 17 gjykatës të cilët shqyrtojnë lëndë të drejtuara atyre apo pasi Këshilli gjyqësor të ketë deleguar kompetencën (neni 30) ose kur është pranuar kërkesë për transferim të lëndës për shqyrtim pranë Këshillit të madh gjyqësor (neni 43).

Monitorimi i aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të drejtësisë në të cilat është konstatuar shkelje, paraqet detyrë të Komitetit të ministrave, që duhet të sigurojë siguri që shtetet ndërmarrin masa të përgjithshme të cilat janë të domosdoshme për t'u parandaluar shkelje e mëtutjeshme (ndryshim i legjislacionit, praktika gjyqësore, rregullat e veprimt). Krahas kësaj, siguron siguri që palëve që ankohen t'u paguhet dëmshpërblim të cilin e ka përcaktuar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në raste të caktuara ndërmarrja e masave tjera konkrete për t'u dhënë siguri për kompensim të plotë (hapje e serishme e procedurës, anulim i ndalesës ose urdhër për konfiskim, ndarje të lejes për qëndrim, etj.).

⁸⁸ Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut Romë, 4 nëntor 1950, neni 35 https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_access_justice_ENG.pdf [hapur më 29.05.2019]

Si të dërgohet aplikim në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut⁸⁹

Gjuhë zyrtare në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut janë gjuha angleze dhe franceze, mirëpo nëse e keni më lehtë, pala mund të drejtohet me shkrim në sekretariatit në gjuhë zyrtare të një prej shteteve të cilat e kanë ratifikuar Konventën. Formulari i ankesës, tërësisht të plotësuar dhe të nënshkruar nga ana e palës dhe përfaqësuesit të tij/saj, është i domosdoshëm për të nisur procedura. Nëse ankesa parashtrahet në formë elektronike apo me faks, formulari i ankesës në formë të shkruar duhet të dërgohet me postë. Mirëpo, fillimisht është me rëndësi të përdoren mjetet juridik të vendit. Më poshtë janë paraqitur disa raste relevante të Gjykatës.

Hamer kundër Belgjikës

Aktgjykim i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut nga 27 nëntori 2007. Pala ankimore ka poseduar shtëpi të ndërtuar nga prindërit e vet në tokë pyjore ku ndërtesa nuk ka qenë e lejuar. Është ngritur procedurë kundër saj për shkak se shtëpia ka qenë e ndërtuar me shkelje të legjislativit relevant për pylltari dhe gjykatat kanë konstatuar që ajo duhet ta kthejë tokën në gjendjen e mëparshme. Shtëpi është rrënuar me forcë. Pala ankimore ka pohuar që e drejta e vet për jetë private ka qenë e shkelur.

Gjykata herën e parë konsideronte që, edhe pse nuk është prerazi e mbrojtur me Konventë, mjedisi jetësor është vlerë në të cilën edhe shoqëria edhe autoritetet publike kanë interes të madh. Mendimet ekonomike, e madje edhe e drejta për pronësi, nuk duhet të kenë prioritet në aspekt të shqetësimit për mjedisin jetësor, veçanërisht kur shteti ka ligje në atë fushë. Për atë shkak, autoritetet publike kishin përgjegjësi të veprojnë për të mbrojtur mjedisin jetësor.

Në rastin Hamer kundër Belgjikës, ka ekzistuar situatë ku pala ankimore ka poseduar shtëpi të ndërtuar nga prindërit e saj. Shtëpia është gjendur në tokë pyjore ku nuk kanë qenë të pranueshme dhe të lejuara objekte të këtij lloji. Ankuesja ka pasur për detyrë ta kthejë tokën në gjendjen paraprake, përkatësisht në atë gjendje në të cilën ka qenë para se të ndërtohet shtëpia. Meqë nuk ka vepruar ashtu, shtëpi ilegale ka qenë e rënuar me forcë. Pala ankuese është drejtuar në gjykatën kompetente duke argumentuar që e drejta e saj për jetë private me këto veprime ka qenë e shkelur. Gjykata gjatë miratimit të vendimit është nisur nga këto fakte relevante: e drejta e pronësisë është e drejtë personale dhe interes publik, ndërsa mjedisi jetësor i shëndoshë është vlerë po aq e rëndësishme jo vetëm për autoritetet publike por edhe për gjithë shoqërinë.

Së këtejmi, e drejta për mjedis jetësor është e drejtë kolektive, përkatësisht e drejtë e interesit publik dhe prioritet në lidhje me të drejtën për pronësi.

Konkluzion: Të drejtat kolektive dhe interesi i përgjithshëm publik janë gjithmonë prioritet dhe me rëndësi më të madhe përkundër të drejtave individuale të individit. Megjithëse mjedisi jetësor nuk është rreptësisht i mbrojtur me Konventë, i njëjti është vlerë e interesit publik.

⁸⁹ Doracak për të drejtën evropiane lidhur me qasjen në drejtësi, Agjencia e Bashkimit Evropian për të drejta fundamentale dhe Këshilli i Evropës, 2016 https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_access_justice_ENG.pdf [hapur më 23.04.2019]

2.1.3 Komiteti për harmonizim me Konventën e Aarhusit

E drejta për qasje në drejtësi është nocion i cili e përshkruan shtyllën e tretë të Konventës së Aarhusit dhe nënkupton të drejtën për mjet juridik. Kjo e drejtë ka të bëjë me pasqyrë të mundshme në vendimet që i zbatojnë trupat relevant të shkallës së dytë, nëpërmjet përdorimit të mjeteve juridike, lidhur me dy shtyllat e para të Konventës së Aarhusit – e drejta për qasje tek informatat dhe e drejta për pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje, por gjithashtu edhe në lidhje me procedura për shqyrtim të veprave dhe lëshimeve nga personat privat dhe organet juridike që janë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit nacional për mjedisin jetësor. E drejta për qasje në drejtësi, në aspekt të Konventës së Aarhusit, e përcakton të drejtën për qasje tek mjetet juridike në dispozicion para gjykatës, ligjit apo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj.

Më tetor 2002, në takimin e parë të vendeve nënshkruese të Konventës së Aarhusit, të mbajtur në Lluke (Itali), është miratuar Vendimi I/7, me të cilin u vendos mekanizëm për mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të Konventës – mekanizmi ankimor i Aarhusit. Komiteti për harmonizim të Konventës së Aarhusit është formuar me qëllim ta plotësojë kushtin nga neni 15 i Konventës që e paraqet bazën juridike për themelimin të Komitetit ankimor të Aarhusit, trup i “natyrës jokonfrontuese, jogjyqësore dhe konsultative, për shqyrtim të respektimit të dispozitave të kësaj Konvente”. Përkufizimi i këtillë i Komitetit sugjeron që qëllimi i vet nuk është të zgjidh konteste kundër shteteve të caktuara, por të ndihmojë në identifikimin e mungesave në transponim dhe zbatim të dispozitave të Konventës dhe të japë rekomandimet e veta për anulim të tyre.

Konventa ka mekanizëm të vetëm për kontroll të harmonizimit, ndërsa ai mund të aktivizohet në katër mënyra:

1. Pala (vend nënshkrues i Konventës) parashtron kërkesë për harmonizimin me Konventën;
2. Pala (vend nënshkrues i Konventës) parashtron kërkesë lidhur me harmonizim me palë tjetër (vend nënshkrues i Konventës);
3. Sekretariati i Konventës udhëzon në Komitet, përkatësisht parashtron referat;
4. Pjesëtar i publikut mund të parashtojë komunikim kundër ndonjë veni nënshkrues i Konventës

Komiteti ankimor i Aarhusit ka 3 funksione themelore:

- a) t'i shqyrtojë të gjitha parashtruesat, referatat ose komunikimet;
- b) me kërkesë të Takimit të palëve të përpilojë raport lidhur me transponimin dhe zbatimin e Konventës në vende të caktuara nënshkruese;
- c) ta monitorojë, vlerësojë dhe ndihmojë transponimin dhe zbatimin e Konventës në vendet nënshkruese.

Fuqia juridike e Komitetit ankimor të Aarhusit përbëhet në atë që pas raportit dhe rekomandimeve të Komitetit, Takimi i palëve mund të ndërmarrë masa përkatëse për t'u arritur harmonizim i plotë ndërmjet Konventës dhe sistemeve juridike nacionale të vendeve nënshkruese.

Masat që i ndërmerr Takimi i palëve, si trupi më i lartë i Konventës, më së shpeshti janë në formë të këshillave, rekomandimeve, paralajmërimeve dhe ngjashëm.

Prapë se prapë, në pajtim me Vendimin I/7, Takimi i palëve mund të kërkojë nga vendi i përfshirë nënshkrues të parashtojë strategji, duke përfshirë edhe orar kohor, për arritje të harmonizimit të plotë me Konventën dhe të parashtojë raporte të rregullta për realizim të strategjisë së ofruar, apo të publikojë deklaratë për mos harmonizim me Konventën.

Masa më e rreptë që mund ta miratojë Takimi i palëve është pezullim i të drejtave dhe privilegjeve të veçanta të cilat i janë ndarë vendit të përfshirë nënshkrues në bazë të Konventës, përkatësisht e njëjta duhet të jetë e përjashtuar nga sistemi i Konventës së Aarhusit.

Mekanizmi i këtillë për harmonizim është unik në të drejtën ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit jetësor, për shkak se u mundëson pjesëtarëve të publikut ta shprehin shqetësimin e tyre

për harmonizim të nënshkruesve edhe atë drejtpërsëdrejti në Komitetin e ekspertëve juridik ndërkombëtarë, që është i autorizuar për t'i shqyrtuar rrethanat e rastit (Komiteti për harmonizim të Konventës së Aarhusit). Megjithatë, Komiteti për harmonizim nuk mund të sjell vendime me karakter obligativ, por vetëm rekomandime deri në takimin përfundimtar të Palëve. Megjithatë, praktika deri tani ka treguar që Palët rregullisht përpiqen t'i respektojnë rekomandimet e Komitetit për harmonizim.

Një nga mënyrat nëpërmjet të cilave mund të iniciohet procedurë pranë Komitetit ankimor të Aarhusit është parashtrim i komunikimit (ankesës) nga publiku. Ky opsion juridik është në dispozicion të çdo personi fizik ose personi juridik, duke përfshirë edhe shoqatat qytetare.

Publiku mund të parashtrorë komunikim në më tepër baza:

- *Mungesë të përgjithshme institucionale* – vend nënshkrues nuk i ndërmerr masat e domosdoshme legislative, rregullatore ose tjera të cilat nevojiten për zbatim të Konventës në pajtim me nenin 3, paragrafi (1);
- *Mosplotësim i qëllimeve konkrete nga Konventa* – vendi nënshkrues ndërmerr masa të caktuara legislative, rregullore ose tjera për zbatim të Konventës të cilat nuk i arrijnë qëllimet e veta; dhe
- *Shkelje konkrete e të drejtës ose obligimit nga Konventa* – vend nënshkrues ndërmerr veprim konkret me të cilin shkel ndonjë dispozitë të Konventës.

Komunikimi rekomandohet të dërgohet nëpërmjet e-postës në Sekretariatin e Konventës. Komunikimi duhet të jetë konciz dhe të mos përmban informata të panevojshme. Në raste ku gjendja faktike është e ndërlikuar, nevojitet të shkruhet rezyme e shkurtë e përmbajtjes së komunikimit në fillim. Megjithatë, komunikimi duhet t'i përmbajë këto informata:

1. informatat personale për subjektin që e ka parashtruar aplikimin;
2. të shënohet shteti i prekur;
3. përshkrim i gjendjes faktike dhe natyrës së mos harmonizimit të supozuar ndërmjet Konventës dhe legjislacionit nacional;
4. të përmenden dispozitat e shkelura nga Konventa;
5. përshkrim i mjeteve juridike nacionale të shfrytëzuara;
6. parashtrim i dokumenteve shoqëruese (legjislacion relevant nacional, vendime/ aktgjykime konkrete dhe ngjashëm);
7. rezyme e shkurtë e fakteve relevante;
8. nënshkrim; dhe
9. adresa.

Para parashtrimit të komunikimit, pavarësisht që nuk është obligative, aplikuesi të ketë përfaqësues juridik, ai duhet të jetë i njoftuar me kriteret themelore sipas të cilave mund të iniciojë diskutim pranë Komitetit. Hapi i këfillë është i domosdoshëm që të mos refuzohet komunikimi për shkak të mungesave të caktuara formale.

Rrjedhimisht, aplikuesi duhet të dijë që:

- Komunikimi mund të parashtrorë vetëm kundër shtetit që është palë e Konventës së Aarhusit dhe vetëm kundër veprimeve që janë ndërmarrë pasi që shteti i përfshirë është zotuar që do t'i respektojë dispozitat e Konventës. Në pajtim me 20 të Konventës, e njëjta bëhet obligative ditën e 90 pasi të parashtrorë instrumenti për ratifikim, pranim ose miratim nga ana e vendit nënshkrues;
- Komunikim mund të parashtrorë kundër një shteti që nuk është tërhequr nga kompetenca e Komitetit ankimor të Aarhusit për komunikime me publikun;
- Para se të dërgohet komunikimi në Komitetin ankimor të Aarhusit rekomandohet të shfrytëzohen të gjitha mjetet juridike nacionale të cilat mund ta anulojnë në mënyrë efektive apo ta kompensojnë ndikimin negativ i veprimet konkret;
- Komunikimi mund të parashtrorë për shkelje të të drejtës individuale që është e ga-

rantuar me dispozitat e Konventës. Megjithatë, komunikimi parashtrohet me qëllim të përmirësohet transponimi dhe zbatimi i Konventës në vendet nënshkruese, kurse jo për mbrojtjen e të drejtave individuale (tërthorazi arrihet edhe ky qëllim);

- Komiteti ankimor i Aarhusit është trup jokonfrontues, jogjyqësor dhe konsultativ. Komiteti nuk ka për qëllim të “tregojë me gisht kah vendet nënshkruese të cilat e shkelin Konventën, por t’i identifikojë mungesat në vendet nënshkruese dhe në atmosferë konstruktive, të kontribuojë për tejkalimin e tyre⁹⁰”.

2.1.4. UNECE –Komisioni ekonomik i KB për Evropë

Shqetësimi i UNECE (Komisioni ekonomik i KB për Evropë) për problemet me mjedisin jetësor daton që nga viti 1971, kur është formuar grup i këshilltarëve të lartë të qeverive të UNECE për çështjet lidhur me mjedisin jetësor, që ka shpjer në formim të Komitetit për politikë për mjedisin jetësor, që tani kryeson një herë në vit. Komiteti siguron udhëzim kolektiv politik në sferën e mjedisit jetësor dhe zhvillim të qëndrueshëm, përgatit takime të ministrave, zhvillon të drejtë ndërkombëtare për mjedis jetësor dhe i përkrah iniciativat ndërkombëtare në rajon. Komiteti punon për mbështetje të vendeve për përmirësim të menaxhimit të tyre me mjedisin jetësor dhe bashkëpunim ndërkufitar, si dhe për fuqizim të implementimit të obligimeve rajonale ekologjike të UNECE dhe për avancim të zhvillimit të qëndrueshëm në rajon.

Qëllimi i vet kryesor është t’i vlerësojë përpjekjet e vendeve për ta reduktuar ngarkimin e përgjithshëm të ndotjes dhe t’i menaxhojnë me resurset e tyre natyrore, të integrojnë politika ekologjike dhe socio-ekonomike, ta fuqizojnë bashkëpunimin me komunitetin ndërkombëtar, t’i harmonizojnë kushtet dhe politikat e mjedisit jetësor në tërë rajonin dhe të stimulojnë inkuadrime më të madh të publikut dhe diskutime në lidhje me mjedisin jetësor dhe vendimmarrje.

Komiteti është trupi i përgjithshëm i aktiviteteve të UNECE-s për mjedis jetësor.

Puna e Komitetit bazohet në disa shtylla strategjike:

- Sigurim i sekretariatit për procesin “Mjedis jetësor për Evropë” dhe pjesëmarrje në promovimin rajonal të Agjendës 21;
- Zhvillim dhe zbatim i Udhëzimeve të UNECE-s për vlerësim të mjedisit jetësor në vendet e UNECE-s që nuk janë anëtare të OECD-së;
- Mbikëqyrje e aktiviteteve të UNECE-s për monitorim, vlerësim dhe raportim për mjedisin jetësor;
- Rritje të efektivitetit të përgjithshëm të marrëveshjeve multilaterale për mjedis jetësor të UNECE-s dhe lehtësim të këmbimit të përvojave për zbatim të marrëveshjeve multilaterale për mjedis jetësor: Konventa Espo, Konventa e Aarhusit, Konventa për ndotje ndërkufitare të ajrit në largësi, Konventa për mbrojtje shfrytëzim të rrjedhave ujore ndërkufitare dhe liqeneve ndërkufitare dhe Konventa për pasoja ndërkufitare nga fatkeqësitë industriale.
- Pjesëmarrje dhe/ose lehtësim të këmbimit të përvojave në numër të madh të aktiviteteve ndërsektoriale që janë ndërmarrë nën udhëheqësi të UNECE-s (për shembull, arsim për zhvillim të qëndrueshëm, transport, shëndet dhe mjedis jetësor, sipërfaqe të gjelbra) ose në partneritet me organizata tjera (për shembull iniciativa për siguri, proces evropian për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe shëndetit).

90 Snezhana Mishiq, Udhëzues për zbatim të Konventës së Aarhusit, Komisioni Evropian i Kombeve të Bashkuara 2000, fq.149, <http://documents.rec.org/publications/PPTtoolkitMAC.pdf> [hapur më 07.06.2019 год.]

2.1.5. Praktikë gjyqësore e gjykatave nacionale të vendeve në botë dhe Evropë

2.1.5.1 Praktika gjyqësore në Armeni

Rasti Teghout 30 tetor 2009 dhe 1 prill 2011

Rezime numër 1 (30 tetor 2009)

Tre organizata joqeveritare–Qendra për antikorrupsion Transparensi interneshënëll, Ekoera dhe zyra e Komitetit të Helsinkit në Vanadzor – kanë parashtruar rast pranë Gjykatës administrative të Armenisë për ta kontestuar ligjshmërinë e akteve administrative që lejojnë nxjerrje të bakrit dhe molibdenit në rajonin Teguut. Gjykata administrative e ka refuzuar ankesën, duke u fokusuar në nenet 3 dhe 79 të Ligjit për procedurë administrative të Armenisë. Nenet e përmendura kanë paraparë që personat juridik dhe fizik kanë qasje në drejtësi vetëm në rastet kur veprimet, lëshimet administrative si dhe veprimet që i shkelin apo drejtpërsëdrejti mund t'i cenojnë të drejtat dhe interesat e tyre legjitime. Të pakënaqur nga vendimi i gjykatës, organizatat joqeveritare Transparensi Interneshënëll dhe Ekoera kanë kërkuar Gjykata e Kasacionit ta anulon vendimin në bazë të nenit 9 të Konventës së Aarhusit, që është pjesë përbërëse e sistemit juridik nga neni 6 i Kushtetutës së Armenisë. Gjykata e Kasacionit deklaroi që OJQ Ekoera është subjekt i formuar në pajtim me ligjin armen për organizata joqeveritare dhe i plotëson kërkesat e legjislacionit nacional dhe e promovon mbrojtjen e mjedisit jetësor në bazë të misionit dhe qëllimeve të përmendura në statutin e saj. Ashtu, Gjykata ka konstatuar që OJQ Ekoera e ka të drejtën për qasje në drejtësi pranë gjykatave në lidhje me çështjet lidhur me mjedisin jetësor. Megjithatë, Gjykata konstaton që OJQ Qendra për antikorrupsion e Transparensi interneshënëll nuk ka interes të mjaftueshëm për rastin dhe për atë shkak nuk ka pasur të drejtë edhe për qasje në drejtësi në rastin konkret. Në bazë të vendimit të lartpërmendur, Gjykata administrative ka qenë e obliguar t'i shqyrtojë çështjet thelbësore të rastit.

Rasti rezime numër 2 (1 prill 2011)

Me aktgjykimin nga 24 marsi 2010, Gjykata administrative e Armenisë e ka konfirmuar pozicionin e vet për gjendjen e OJQ Ekoera, sipas të cilit personat fizik dhe juridik nuk mund të kërkojnë mbrojtja të “çfarë do të drejte dhe të drejte abstrakte” në gjykatë. Kërkesa e organizatës joqeveritare ekologjike edhe një herë është refuzuar. Të pakënaqur nga kjo, OJQ Ekoera sërish ka parashtruar ankesë pranë Gjykatës së Kasacionit në Armeni. Megjithatë, Gjykata e Kasacionit në Vendimin e vet nga data 1 prill 2011 ka deklaruar: “... Në vendimin numër 906, Gjykata Kushtetuese e Armenisë, duke e shqyrtuar kushtetutshmërinë e fjalës “të tij/saj” pas nocionit, të shkelur “neni 3 paragrafi (1) i Kodit për procedurë administrative të Armenisë, dispozita të jetë në pajtim me Kushtetutën e Armenisë. Sipas logjikës së legjislacionit armen, rezulton që mbrojtja efektive e të drejtave të shkelura përfshin, ndër të tjerat, të drejtat të aplikohet në gjyq për subjekte të drejtat e të cilëve janë shkelur drejtpërsëdrejti”. Sipas logjikës së legjislacionit armen vijon që mbrojtja efektive e të drejtave të shkelura nënkupton, ndër të tjerat edhe të aplikohet në gjykatë për subjektet të drejtat e të cilëve janë shkelur drejtpërsëdrejti. Në bazë të konkluzionit të Gjykatës Kushtetuese dhe lidhur me dispozitat relevante të Kodit të Armenisë për procedurë administrative dhe Kodin e Armenisë për procedurë civile, Gjykata e Kasacionit e ka refuzuar ankesën për kasacion dhe e ka konfirmuar aktgjykimin e Gjykatës administrative të Armenisë⁹¹.

⁹¹ Case Summary posted by the Task Force on Access to Justice, http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.i/Jurisprudence_prij/ARMENIA/Armenia_2009_2011_Teghout.pdf [hapur më 23.04.2019]

Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Armenisë numër 906

Zyra e OJQ-së Këshilli qytetar i Helsinkit në Vanadzor, ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Armenisë të miratojë vendim për kushtetutshmërinë e fjalëve “të tij/saj”, pas nocionit “të shkelur” në nenin 3 të kodit armen për procedurë administrative. Sipas qëndrimit të palës ankuese, nocioni “mbrojtje të drejtave të veta” i përcaktuar në nenin 19 të Kushtetutës së Armenisë ka domethënie të gjerë që e përfshin konceptin për mbrojtje të interesit publik. Pas shqyrtimit të rastit, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar, neni 3 i Ligjit për procedurë administrative duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën. Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese është bazuar në këto parime: Sipas logjikës së nenit 19 të Kushtetutës së Armenisë, entiteti mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta. Njëkohësisht, nenet 18 dhe 19 të Kushtetutës së Armenisë dhe neni 6 paragrafi (1) i Konventës evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nuk e përjashtojnë mundësinë të kërkojë mundësi të kërkojë mbrojtje e të drejtave të shkelura në emër të publikut. Krahas kësaj, Gjykata Kushtetuese e deklaroi këtë:

1. Identifikimi i rolit të OJQ-ve në zhvillimin e shtetit dhe të shoqërisë qytetare dhe me qëllim të rritet efikasiteti i aktiviteteve të tyre, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar që Kodi armen i procedurës administrative mund t'i përfshijë pjesëtarët e organizatave të interesuara joqeveritare (në bazë të statuteve të tyre) t'i iniciojnë rastet pranë gjykatës për t'i mbrojtur interesat e publikut. Për atë shkak, duhet të merren parasysh ngjarjet aktuale të institutit actio popularis në Evropë. Ky lloje i rregullores jo vetëm që e promovon mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime, por do ta zmadhojë edhe rolin e OJQ-ve si pjesë thelbësore e shoqërisë qytetare.

2. Në të gjitha rastet, qasja kryesore është që actio popularis duhet të përjashtohet përveç nëse nuk ekziston interes juridik. Gjykata Kushtetuese konstaton që për të rritur efektivitetin e kontrollit social mbi shtetin dhe autoritetet lokale dhe për të garantuar zbatim të funksioneve kryesore të organizatave joqeveritare, zhvillimi i mëtutjeshëm i ligjit duhet ta marrë parasysh pozitën e përmendur juridike të Gjykatës.

Vërejtje: Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është dërguar për vendimin e Gjykatës së kasacionit të Armenisë, për ankesë të parashtruar nga OJQ-ja Ekoera. Organizata joqeveritare e kontestoi mohimin e gjendjes, ndërsa kur Gjykata administrative e Armenisë ka kërkuar të rishqyrtohet ligjshmëria e akteve administrative që lejojnë nxjerrje të bakrit-molibdenit në rajonin e Tegut. OJQ Ekoera parashtroi raport (ACCC/C/2012/62) në Komitetin për harmonizim të Konventës së Aarhusit, i cili është në shqyrtim.⁹²

⁹² Case Summary posted by the Task Force on Access to Justice, http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.j/Jurisprudence_prj/ARMENIA/Armenia_2010_Helsinki_Citizen_s_Assembly.pdf [hapur më 23.04.2019]

Lenaerts c.s. v. nv 's Heerenbosch, Nr. 70/2007

Konteksti

Akti nga 12 janar 1993 “përcaktim i të drejtës për veprim për mbrojtje të mjedisit jetësor” u mundëson organizatave ekologjike të cilat plotësojnë kërkesa të caktuara për të parashtruar procedurë për ndërprerje të veprimeve të cilat janë evidente për shkelje të ligjit për mjedis jetësor apo janë kanosje serioze për kundërvajtjet e tilla, pranë Kryetarit të gjykatës së shkallës së parë (Gjykata e qarkut). Ligji e autorizon kryetarin e gjykatës së shkallës së parë të përcaktojë dhe ku është e përshtatshme, të urdhërojë ndërprerje të kundërvajtjeve të dukshme apo kanosjeve serioze për kundërvajtje të tilla apo të urdhërojë masa për parandalim të dëmit mbi mjedisin jetësor.

Krahas organizatave për mbrojtje të mjedisit jetësor, autoritetet administrative dhe komunale mund të ndërmarrin masa për pushim. Krahas asaj, neni 271 i ligjit të ri komunal lejon një ose më shumë banorë të një komune të veprojnë në emër të komunës nëse kryetari i komunës dhe përgjegjësit nuk e bëjnë atë. Së shpejti është pranuar në praktikën gjyqësore që kjo dispozitë mund të kombinohet me Aktin nga 12 janari 1993, ashtu që qytetarët individë do të mund vetë të miratojnë procedurë të tillë në dobi të organit komunal që i plotëson kushtet me atë që do ta zë vendin e komunës e cilat refuzon të miratojë aksion të tillë. Kjo praktikë gjyqësore është miratuar nga Gjykata Supreme (Hof van Cassatie, 14 shkurt 2002, RW 2001-2002, 1504), jur nga leximi i përbashkët i dy veprimeve të lartpërmendura përcakton që nëse kryetari i komunës dhe përgjegjësit nuk ndërmarrin veprime në ato rrethana, një ose më shumë banorë mund të ndërmarrin veprime juridike në emër të komunës për ta mbrojtur mjedisin jetësor. Kamata nuk duhet të demonstrohet për shkak që supozohet që komuna ka interes. Gjykata Supreme gjithashtu ka konsideruar që procedura për ndërprerje nuk varet nga gjendja e shpejtësisë ose urgjencës (Hof van Cassatie, 5 mars 1998, TMP 1998, 161).

Rasti

Disa banorë të komunës Ostmall në lidhje me qëndrimin, në emër të asaj komune kanë parashtruar procedurë për kundërvajtje në bazë të licencës ndërtimore nga e njëjta komunë e cila, gjoja është lëshuar në mënyrë ilegale. Banori ka parashtruar padi pasi këshilli shtetëror (Gjykata supreme administrative) e ka refuzuar kërkesën për pezullim të licencës. Kryetari i Gjykatës së shkallës së parë në Antwerpen e ka shpallur aktin si të papranueshëm, duke përmendur që neni 271 i aktit të ri komunal nuk mund të aplikohet kur licenca është parashtruar nga ana e komunës në dobinë e të cilës banorët kanë ndërmarrë veprime. Pas ankesës, Gjykata e apelit në Antwerpen ka parashtruar çështje kushtetuese për vendim preliminar në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar nga Gjykata nëse i dispozitat e përmendura i shkelin nenet 10, 11 dhe 23 të Kushtetutës nëse interpretohen në mënyrë që procedura për ndërprerje është përjashtuar kur komuna e ka dërguar objektin apo licencën ekologjike.

Aktgjykim i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese ka vendosur që nëse këto rregulla interpretohen në mënyrë që e drejta për “zëvendësim të veprimit” nuk mund të shfrytëzohet nga qytetarë individë në raste në të cilat (nga ana e hipotezave) licencë (ilegale) kanë dërguar të njëjtat autoritete lokale për aktivitetin e kritikuar që e dëmton mjedisin jetësor, interpretimi i tillë do të krijonte dallim në trajtimin ndërmjet qytetarëve që nuk mund të arsyetohet. Interpretimi i tillë e ka cenuar parimin për barazi dhe mosdiskriminim të përfshira në nenet 10 dhe 11 të Kushtetutës. Vetëm interpretimi që u mundëson qytetarëve të inkorporojnë aksion të tillë është në pajtim me dispozitat e përmendura në Kushtetutë. Si pasojë e kësaj, aksioni është dashur të shpallet si i pranueshëm.⁹³

⁹³ Case Summary posted by the Task Force on Access to Justice nga: 08.10.2011 http://www.unecce.org/fileadmin/DAM/env/pp/compliance/TFon_A_to_J/Belgium_2007_Lenaerts.pdf [hapur më 10.05.2019]

Organizatë joqeveritare ekologjike “VZW Milieufrent Omer Wattez” kundër autoritetit të provincës të Ost-Vlaanenden (VZW Vlaams Zweefvliegcentrum, Nr. 193.593)

Licenca ekologjike është lëshuar nga autoriteti i provincës së Ost-Vlaanenden për punë të aeroportit për avionë pa motorë në zonë të vlefshme bujqësore. Vendimi është parashtruar nga VZW Milieufrent, duke pohuar që i ka shkëlur skicat për planifikim për zonë të tillë. Në lidhje me çështjen për pranueshmëri, Këshilli shtetëror ka deklaruar që sipas akteve nënligjore të veta, “VZW Milieufrent Omer Wattez” është organizatë joqeveritare ekologjike aktive në rajonin e Ardeneve Flamane, të cilit i përket edhe qyteti Gerarsbergen. Interesi kolektiv i punës së OJQ-së është mjaftueshëm i specializuar dhe ka të bëjë me planifikimin e shfrytëzimit të tokës, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe rurajtjen e natyrës. Ky qëllim nuk përputhet me interesin e përgjithshëm, as me interesat individuale të pjesëtarëve të publikut. Në vend të kësaj, ajo rezulton nga leximi i kombinuar i nenit 2, paragrafi (5) dhe neni 9 paragrafi (2) i Konventës së Aarhusit, që sugjerojnë në atë që organizatat joqeveritare ekologjike si ankuesi duhet të kenë qasje efektive në drejtësi. Në Konventë, organizatat joqeveritare për mjedis jetësor duhet të kenë qasje në Këshillin Shtetëror. Ashtu, vendimi i autoritetit të provincës nga 2 shkurti 2006 për ndarje të licencës së tillë është shfuqizuar⁹⁴

Në rastin e përmendur ku bëhet fjalë për vendim për lëshim të licencës ndërtimore të kontestueshme për ndërtim të aeroportit për avionë pa motorë në zonë bujqësore, Këshilli shtetëror si organ kompetent ka lejuar organizatë joqeveritare e cilat vepron në fushën e mjedisit jetësor të ketë legjitimacion aktiv për kontestim të vendimit, përkatësisht të paraqitet si palë në procedurë për ankesë kundër vendimit të shkallës së parë.

OJQ-ja në fjalë e fiton legjitimitetin dhe legalitetin drejtpërsëdrejti nga neni 2 paragrafi (5) dhe (105) dhe neni 9 nga Konventa e Aarhusit ku prerazi përcaktohet që organizatat joqeveritare ekologjike duhet të kenë qasje efektive në drejtësi. Në këtë rast, duhet të kenë qasje në Këshillin Shtetëror që është kompetent të vendos me rastin e ankesës. Epilogu i procedurës është anulim i vendimit të autoritetit të provincës nga 02.02.2006 për licencën e ndarë.

Konkluzioni: Këshilli shtetëror u ka pranuar interes juridik organizatave joqeveritare ekologjike që si palë të mund të paraqiten në procedurat, përkatësisht në rastin konkret në procedurën administrative. Aplikimi i drejtpërdrejtë i nenit 2 paragrafi (5) dhe neni 9 i Konventës së Aarhusit mundësojnë qasje në drejtësi të OJQ-ve të specializuara në sferën e mjedisit jetësor.

⁹⁴ Case Summary posted by the Task Force on Access to Justice nga 08.10.2011: http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.j/Jurisprudence_prj/BELGIUM/ConseilEtatVZW_Milieufrent/Belgium_2009_VZW_Milieufrent.pdf [hapur më 10.05.2019]

2.1.5.3 Praktika gjyqësore në Hungari

Случај: Menaxhim me hedhurina në fshatin Kaposzmero

Vendimet administrative materiale, si për shembull, licencat mund të jenë lëndë e ankesave nga ata të cilët kanë pozitë juridike sipas Ligjit për administrative para 2017-12-31 në Hungari. Ankesat e tilla duhet të dërgohen në organin kompetent që e ka miratuar vendimin e shkallës së parë në afat prej 15 ditëve përlogaritur nga parashtrimi i vendimit nga pala në rast. Në rast se skadon afati për parashtrim të ankesës, pala mund të kërkojë mungesë të jashtëzakonshme për ankesë për 8 ditë shtesë nga skadimi i 15 ditëve të rregullta. Banorët e Kaposzmero, fshat i vogël në jugperëndim të Hungarisë, një ditë kanë vërejtur makina për punë të rënda tokësore duke mbërritur në rrethinën e fshatit të tyre. Së shpejti kanë zbuluar që është bërë fjalë për vend të ri për menaxhim me hedhurina në periferinë e fshatit. Në lokacionin është paraparë të menaxhohet me hedhurina nga rrënimi, dërmimi i tullave dhe beton.

Banorët gjithashtu kanë zbuluar që objekti i ka pasur licencat e nevojshme të lëshuara nga organi kompetent, megjithëse nuk kanë qenë të informuar për çfarë do lidhshmërie me lokacionin.

Menjëherë pasi e kanë identifikuar seriozitetin e situatës, banorët kanë kërkuar kopje të licencës për lokacioni. Menjëherë pasi e kanë pranuar atë licencë, kanë parashtruar ankesë në afat prej 15 ditëve, në afatin ligjor për të cilin do mjet juridik administrativ në Hungari. Përgjigja e Agjencisë Nacionale për mjedis jetësor, përkatësisht forumi i apelit në rast të tillë, ka qenë se ankesa e banorëve është parashtruar tepër vonë. Agjencia ka pohuar që afati për ankesë duhet të merret parasysh nga lëshimi i parë i licencës edhe përkrah faktit që e njëjta nuk i është komunikuar asnjë qytetari, as nuk është publikuar në internet apo nuk është bërë publik në çfarë do mënyrë. Agjencia ka pohuar që palët ankimore duhet të kenë kërkuar mungesë të jashtëzakonshme për ankesë për çka ka pasur në dispozicion afat prej tetë ditëve. Meqë nuk kanë vepruar ashtu, ankesa e tyre është vjetruar dhe prandaj ka qenë e refuzuar si e papranueshme pa shqyrtim thelbësor të detajeve. Banorët kanë parashtruar padi kundër këtij vendimi, në aktgjykimin e vet, Gjykata administrative dhe Laburiste në Peç e kanë konfirmuar validitetin e argumenteve të qytetarëve dhe është lëshuar urdhër që Agjencia të vendos për bazueshmërinë e rastit dhe gjatë kësaj i kanë marrë parasysh ankesat materiale të qytetarëve.

Gjykata ka konfirmuar që koha në dispozicion për ankesë nuk mund të fillojë para se dikush të jetë i informuar në mënyrë përkatëse për vendimin për të cilin dëshiron të ankohet. Askush nuk mund të jetë i privuar nga e drejta për mjet juridik nëse nuk ka pasur mënyrë racionale për të ditur për akt administrativ. Nëse vendimi i organit kompetent asnjëherë nuk është bërë publik, veçanërisht për ata me interes juridik lidhur me atë rast ndërsa me atë edhe me të drejtë për qasje në gjykatat, atëherë e drejta për mjet juridik mbetet joefikase.⁹⁵

Në Hungari në pajtim me ligjin për procedurë administrative, ankesa kundër vendimeve materiale, siç janë për shembull licencat, mund të parashtrohet secili banor i cili jeton në rajonin e përfshirë me licencën. Afati për ankesë kundër vendimit është 15 ditë pas pranimit të vendimit. E njëjta parashtrohet në organin kompetent me rastin e vendimit të shkallës së parë.

Konkluzioni: Afati për ankesë fillon të rrjedhë nga momenti kur vendimi u është dërguar subjekteve, përkatësisht nga momenti kur kanë kuptuar për atë apo në mënyrë të padyshimtë kanë pasur mundësi të kuptojnë për vendim të tillë të miratuar.

⁹⁵ Case Summary posted by the Task Force on Access to Justice, Hungary: Waste Management Site at Kaposmér Village nga: 12.03.2018 http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.j/Jurisprudence_prj/HUNGARY/Hu_2018_Kaposmero_Summary.pdf [hapur më 09.05.2019]

2.2 Vështrime përmbyllëse

Mund të konstatohet që sfidat kryesore praktike lidhur me përpunimin e rasteve në lidhje me mjedisin jetësor janë:

Mungesa e vetëdijes publike ndërmjet individëve dhe organizatave joqeveritare për mundësinë për ankesë kundër vendimeve administrative;

Mungesë e mekanizmave për ndihmë juridike falas për përkrahje të individëve të interesuar apo organizatave joqeveritare për t'u parashtruar ankesat administrative në pajtim me ligjin e zbatueshëm;

Mungesë e avokatëve/specialistëve juridik kompetent për ballafaqim me ankesat administrative për mjedisin jetësor;

Mungesë e kurseve të specializuara nga sfera e mjedisit jetësor në nivel të arsimit të lartë për zhvillim të shkathtësive juridike të nxënësve në parashtrimin e çështjeve nga sfera e mjedisit jetësor në organet administrative ose gjyqësore.

Duhet të përmendet që ekziston numër i vogël i rasteve kur organizatë joqeveritare e cilat vepron si paditës ka ngritur procedurë pranë gjykatës në emër të interesit publik. Disa nga sfidat përfshijnë edhe rrezik për përsëritje të dëmit mbi mjedisin jetësor, kur aktgjykimi i gjykatës nuk mund të përmbrohet.

PJESA III: PRAKTIKAT MË TË MIRA NË SIGURIM TË QASJES NË DREJTËSI NË SFERËN E MJEDISIT JETËSOR

3.1 Praktika të mira për të drejta të njeriut dhe mjedisin jetësor⁹⁶

UNEP, Zyra e Komisarit të Lartë të KB-së për të drejtat e njeriut dhe Raportuesi Special i KB-së për të drejtat e njeriut dhe mjedis jetësor i bashkuan përpjekjet për identifikim, promovim dhe këmbim të mendimeve për praktikën e mira lidhur me shfrytëzimin e obligimeve për të drejtat e njeriut dhe të obligimeve për informim, përkrahje dhe fuqizim të politikës për mbrojtje të mjedisit jetësor, veçanërisht në fushat e mbrojtjes dhe menaxhimit me mjedisin jetësor.

Nisma e përbashkët ka identifikuar shembuj praktik dhe konkret të praktikave të mira, ku shtetet dhe faktorët tjerë me sukses i kanë zbatuar obligimet për të drejtat e njeriut lidhur me mbrojtjen dhe menaxhim me mjedisin jetësor. Ky parim mund të përsëritet në kontekste tjera, që e ka rritur kuptimin dhe vetëdijen për lidhjen ndërmjet të drejtave të njeriut dhe mjedisit jetësor, duke përfshirë edhe qartësi më të madhe lidhur me obligimet për të njëjtat.

Praktikat e mira janë grumbulluar në nivel ndërkombëtar, rajonal, nacional dhe subnacional nëpërmjet bashkëpunimit, konsultimeve, pyetësorëve dhe sondazheve. Në procesin e identifikimit të praktikave të këtylla dhe analizë të aspekteve praktike të ndërveprimit ndërmjet dy sferave për të drejta të njeriut dhe mjedis jetësor, UNEP dhe partnerët kanë identifikuar sfida dhe probleme në ekuilibrimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Janë identifikuar mësimet lidhur me ndërveprimin e tillë, të cilat janë gjithashtu të arritshme me praktikën e mira.

3.2 Actio popularis

Në përgjithësi, e drejta për mjedis jetësor është një nga të drejtat themelore të njeriut. Në anën tjetër, mjedisi jetësor i shëndoshë është interes publik dhe nëse kjo merret parasysh ligjvënësi duhet të parashihet mundësi për actio popularis në procedurat dhe kontestet gjatë shkëlqes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë.

Si shembuj pozitiv dhe praktikë e mirë duhet t'i merr parasysh disa nga shtetet në të cilat është mundësuar actio popularis. Ky është rasti në Portugali, që mbase është vendi me qasjen më të madhe në mjetet juridike administrative dhe gjyqësore. Kushtetuta e Portugalisë përfshin actio popularis në procedurat gjyqësore, duke i përfshirë procedurat për shëndet publik, të drejtat e konsumatorëve, cilësinë e jetës, ruajtjen e mjedisit jetësor, trashëgiminë kulturore dhe ngjashëm.

- Në Mbretërinë e Bashkuar, Irlandë dhe Latvi, interpretimi i gjerë i gjykatave për konceptin e "interetit" ka çuar në njohjen de facto të actio popularis.
- Në disa vende actio popularis është e mundur për raste konkrete:
- Në Spanjë ekziston actio popularis për planifikim të shfrytëzimit të tokës, ujërave bregore, parqeve nacionale dhe të drejtën penale;
- Në Estoni ekziston actio popularis për planifikim të shfrytëzimit të tokës;
- Në Slloveni për padi qytetare, Ligji për mbrojtje të mjedisit jetësor u jep qasje të gjerë në gjykatat qytetare, qytetarëve të cilët veprojnë si individë ose nëpërmjet bashkësive, shoqatave dhe organizatave;⁹⁷
- Në R. e Maqedonisë, Kushtetuta jep mundësi për përdorim të actio popularis.

⁹⁶ Ndërmarrë nga ueb faqja e Raportuesit pranë KB-së për të drejtat e njeriut dhe mjedisin jetësor <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Environment/SREnvironment/Pages/SREnvironmentIndex.aspx> [hapur më 20.06.2019]

⁹⁷ Konventa e Aarhusit: si zbatohet qasja në dispozitat jurisprudente? (Belgjikë 2 qershor 2008), https://ec.europa.eu/environment/aarhus/pdf/conf/closing_speech.pdf [hapur më 13.05.2019]

3.3 Praktika të mira përjasje në drejtësi në sfera tjera

Pasi edhe Ligji i ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi⁹⁸ është pjesë e kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është e pashmangshme ta shqyrtojmë në pjesën e rregullimit të tyre. Me këtë Ligj rregullohen parandalimi dhe ndalimi i diskriminimit, format dhe llojet e diskriminimit, procedurat për mbrojtje nga diskriminimi si dhe përbërja dhe puna e Komisionit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.⁹⁹ Qëllim i këtij ligji është sigurim i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.¹⁰⁰ Në nenin 3 paragrafi (1) përmendet që ky ligj ka të bëjë me të gjithë presonave fizik dhe juridik.¹⁰¹ Personat të cilët konsiderojnë që janë viktimë të diskriminimit mund të parashtrojnë parashtresë në Komision, me shkrim apo me gojë në procesverbal, pa obligim për të paguar taksë dhe kompensim tjetër.¹⁰²

Ligjvënësi ka lënë hapësirë personi që konsideron se është i diskriminuar të mund para Komisionit të jetë i përfaqësuar nga shoqatë, fondacion apo sindikatë me pëlqim paraprak të tij.¹⁰³

Shoqata, fondacione ose organizata tjera të shoqërisë qytetare dhe institucioneve, që kanë interes të arsyetuar për mbrojtjen e interesave të ndonjë grupi apo në suaza të veprimtarisë së vet merren me mbrojtje nga diskriminimi, mund të parashtrojnë parashtresë nëse vërtetojnë që me veprim të ndonjë personi fizik ose juridik janë diskriminuar numër më i madh personash.¹⁰⁴

Personat që do të iniciojnë procedurë gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi janë të çliruar nga pagesa e shpenzimeve për taks gjyqësore. Shpenzimet për taksa gjyqësore përp personat janë në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.¹⁰⁵

Në kontest me rastin e padisë, personit që ndihet i diskriminuar mund t'i bashkëngjitet organ, organizatë, ent, shoqatë, sindikatë apo person tjetër që në suaza të veprimtarisë së vet merret me mbrojtjen e të drejtave për barazi dhe mosdiskriminim për të drejtat e të cilëve vendos gjykata me aplikim të dispozitave të Ligjit për procedurë kontestimore.¹⁰⁶

Për hir të vërtetës, elementet thelbësore në Ligjin e ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi¹⁰⁷ ngelin të pandryshuara, përkatësisht me ligjin e ri vetëm janë përpunuar në mënyrë plotësuese dhe më mirë janë rregulluar dispozitat dhe zgjidhjet ligjore.

Ajo që është më interesante është që duke e pasur parasysh faktin që bëhet fjalë për një nga të drejtat themelore të njeriut (siç është e drejta e njeriut për mjedis jetësor të shëndoshë), ky propozim-ligj lejon actio popularis, përkatësisht paditë për mbrojtje nga diskriminimi me interes publik. Meqë duhet të kemi parasysh që edhe mjedisi jetësor i shëndoshë është interes publik, vlerësojmë që e pashmangshme është nevoja actio popularis të mundësohet edhe në kuadër të ligjit për ndihmë juridike falas. Bëhet fjalë për të drejtë themelore të njeriut, lëndë e interesit publik, kurse sipas Konventës së Aarhusit duhet t'i nënshtrohet shpenzimeve minimale në procedurat, çdoherë kur të jetë shkelur kjo e drejtë.

E drejta për actio popularis në propozim ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi është rregulluar në nenin 35 paragrafi 1, ashtu që: Shoqatat, fondacionet ose organizata tjera të shoqërisë qytetare dhe grupe joformale që kanë interes të arsyetuar për mbrojtje të interesave të ndonjë grupi apo në suaza të veprimtarisë së vet merren me mbrojtje nga diskriminimi, mund

98 Ligj për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, Gazeta zyrtare e RMV-së numër 101 nga 22.5.2019

99 ibis, neni 1

100 ibis, neni 2

101 ibis, neni 3 paragrafi 1

102 ibis, neni 23 paragrafi 1

103 ibis, neni 23 paragrafi 2

104 ibis, neni 23 paragrafi 3

105 ibis, neni 39 paragrafi 1 dhe 2

106 ibis, neni 40 paragrafi 1 dhe 2

107 Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi ("Gazeta zyrtare e RMV-së" numër 50/10), Ligji për ndryshim të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi ("Gazeta zyrtare e RMV-së" numër 44/14), Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi ("Gazeta zyrtare e RMV-së" numër 150/15), http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2019/27_5Zakon%20za%20zastita%20od%20diskriminacija.pdf [hapur më 20.06.2019]

të ngrenë padi, nëse e vërtetojnë të mundshme që me veprimin e të pandehurit janë diskriminuar numër i madh personash.¹⁰⁸

Ky ligj shkon deri aty që i mundëson Komisioni me detyrë zyrtar të iniciojë procedurë për mbrojtje nga diskriminimi çdoherë kur të konstatojë që ka ndodhur diskriminim nga të gjitha organet shtetërore, organet e njësive të vetëqeverisjes lokale, personave juridik me autorizime publike dhe të gjithë personat tjerë juridik dhe fizik, në pajtim me bazat e diskriminimit¹⁰⁹, në sferën e:

1. punës dhe marrëdhënieve të punës;
2. arsimit, shkencës dhe sportit;
3. sigurisë sociale, duke e përfshirë edhe fushën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen shëndetësore;
4. jurisprudencës dhe drejtësisë;
5. banimit;
6. informimit publik dhe mediave;
7. qasjes të të mirat dhe shërbimet;
8. anëtarësimit dhe veprimit në shoqata sindikaliste, parti politika, shoqata dhe fondacione dhe organizata tjera të bazuara në anëtarësi;
9. kulturë dhe të gjitha sferat tjera.

Çdoherë gjatë kontesteve nga sfera e mjedisit jetësor duhet të merret parasysh edhe dispozita e Ligjit për procedurë kontestimore që e rregullon sigurimin e masave paraprake, ndërsa e njëjta i nënshtrohet shpenzimeve gjyqësore. Përkatësisht, gjatë procedurës, gjykata, me propozim të palës mund të përcaktojë masa të përkohshme për shkak të parandalimit të veprimit me detyrim apo për mënjanim të dëmit të pakompensueshëm.¹¹⁰

Masat e përkohshme janë të rëndësishme në kontestet nga sfera e mjedisit jetësor, për shkak se në pajtim me natyrën e tyre, në pjesë të madhe të rasteve, aplikimi i masave të këtilla mund të shpie në parandalim, përkatësisht mënjanim të dëmit të pakompensueshëm.

Duke pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për të drejta të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e shtetit, ato duhet të rregullohen në baza të barabarta, pra e drejta për të parandaluar dhe mbrojtje kundër diskriminimit nuk mund të rregullohen në një mënyrë shumë më të favorshme se sa bëhet me ligjin për ambient të shëndoshë. Duhet të punojmë për të përmirësuar ligjet që i rregullojnë të drejtat themelore të njeriut, që ato të përmbajnë zgjidhje të qëndrueshme ligjore, në mënyrë që të gjithë njerëzit të mbrohen përmes ligjit dhe në mënyrë legjitime. Projektligji për ndihmë juridike falas ka hapësirë, por edhe nevojë të pashmangshme për të bërë të mundur që të gjithë personat (fizikë dhe juridikë) të kenë qasje të barabartë në drejtësi sa herë që shkelet një e drejtë në fushën e mjedisit, por edhe më shumë për të siguruar dhe mundësuar *actio popularis*, sepse mjedisi i shëndoshë jetësor është në interes të publikut.

108 Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi Gazeta zyrtare e RMV-së numër 101 nga 22.5.2019, neni 35 paragrafi 1, <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2019/27,5Zakon%20za%20zastita%20od%20diskriminacija.pdf>

109 ibis, Neni 21 paragrafi(1)pika 15 në lidhje me nenin 23 paragrafi(4)dhe neni 3 paragrafi(2a)

110 Ligji për procedurë kontestimore (Gazeta zyrtare e RM-së, numër 7 nga 20.01.2011), neni 407 paragrafi(1), <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> [hapur më 09.09.2019]

PJESA IV: REKOMANDIME PËR ZHVILLIM TË MËTUTJESHËM TË POLITIKAVE DHE LEGJSLACIONIT TË MAQEDONISË PËR QASJE TË LEHTËSUAR NË SFERËN E MJEDISIT JETËSOR

4.1 Rekomandime për qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor

Rekomandimet që rezultojnë nga kjo analizë janë në udhëzime të fuqizimit të institucioneve për veprim në rastet lidhur me shkeljen e të drejtës për jetë dhe për mjedis jetësor si në procedurat paraprake ashtu edhe në procedurat gjyqësore. Fillimisht, të përforcohet ndihma juridike paraprake për lehtësim të zgjidhjes së problemeve juridike para ngritjes së procedurave gjyqësore, përkatësisht zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontesteve si formë “më e lirë” e ndihmës juridike falas përkatësisht ndërmjetësim. Me qëllim instituti ndërmjetësim të rikthehet në legjislacionin e Maqedonisë, qytetarët duhet të kenë qasje të lehtë tek informatat relevante në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme. Sigurimi i qasjes në drejtësi efektive për të gjithë, përkatësisht zvogëlim të shpenzimeve gjyqësore sipas Ligjit për taksa gjyqësore, Ligjit për taksa administrative dhe Ligjit për procedurë kontestimore ku parashihet për kategoritë e qytetarëve të lëndueshëm, si dhe palët në pajtim me këto ligje. Në mënyrë plotësuese, neni 9, paragrafi(4) i Konventës së Aarhusit është si vijon “... me procedurat nga paragrafi(1), (2)dhe(3) do të sigurohen masa adekuate dhe efikase për mënjanim të pasojave, duke e përfshirë edhe lëshimin e urdhrave gjyqësor (atje ku kjo është e përshtatshme), që do të jenë të drejta, fer, me kohë dhe jo tepër të shtrenjta. Vendimet e gjykatave dhe (gjithmonë kur kjo është e mundur) të trupave tjerë, do të bëhen publike për publikun”.

Donë të thotë, qasje në drejtësi duhet të lehtësohet nëpërmjet zvogëlimit apo anulimit të plotë të shpenzimeve administrative dhe gjyqësore për lëndët në pjesën e mbrojtjes së mjedisit jetësor. Përkrah rrethanave lehtësuese në Ligjin e ri për ndihmë juridike falas, ekspertizat e shtrenjta ende paraqesin barrierë për qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve. Problem tjetër që duhet të adresohet është në lidhje me cilësinë e ekspertizës dhe nëse e njëjta mund ta arrijë qëllimin për të cilin është bërë, përkatësisht lidhja me ndikimin mbi shëndetin dhe jetën e njerëzve nga aspekti i kapacitetit të sistemit të përgjithshëm të jurisprudencës.

Propozohet të shqyrtohet ideja për formim të Fondit për ekspertizë që do t'u kishte mundësuar ekspertëve të interesuar për pjesëmarrje në raste të interesit publik për mjedis jetësor, me tarifë të favorizuar ose pro bono t'i ofrojnë në dispozicion shkathtësitë e tyre, sigurim të pajisjes dhe kushte për ekspertizë me shpenzimet më të ulët të mundshme, në pajtim me nenin 9, paragrafi 4 i Konventës së Aarhusit. Sa i përket qasjes në drejtësi për raste nga sfera e mjedisit jetësor, janë iniciuar disa procedura të cilat drejtpërdrejt referohen në nenin 9 të Konventës së Aarhusit, që është ratifikuar dhe si e tillë është pjesë e sistemit juridik nacional dhe të njëjtat (procedurat) janë ende në rrjedhë. Duke i marrë parasysh programet për trajnim të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, është e dukshme që gjykatësit çdo vit kanë marrë pjesë në trajnime lidhur me Ligjin për mjedis jetësor dhe që përkushtohet vëmendje e posaçme në veprat penale nga sfera e mjedisit jetësor. Madje ekzistojnë edhe të ashtuquajturit prokurorë ekologjik, të cilët janë pjesë e Rrjetit/asociacionit Evropian për aktivitetet e të cilëve nuk ka informata në dispozicion¹¹¹. Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik është e hapur për bashkëpunim me ekspertë të jashtëm dhe organizata qytetare, ashtu që ekziston hapësirë për trajnime më të fokusuar dhe të specializuara në lidhur me Konventën e Aarhusit dhe të drejtën nga sfera e mjedisit jetësor, përkatësisht për studim të praktikës gjyqësore të Komitetit për harmonizim me Konventën e Aarhusit.

¹¹¹ Rrjeti evropian i prokurorëve për mjedis jetësor është formuar në vitin 2012, Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publik të Republikës së Maqedonisë, Hyrje në të Drejtën Evropiane Kontribute nga puna e Fondacionit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar (IRZ) Maqedoni Vëllimi II, <https://evropsko-pravo.info/mk/IRZ/Publications/Index/8e0d3789-60db-4f5f-b150-5bfedeb1947c> [hapur më 08.04.2019]

Në këtë drejtim, Shteti përkatësisht institucionet duhet të përkushtojnë vëmendje më të madhe në promovimin e të drejtës për ndihmë juridike falas dhe të sigurojnë dukshmëri më të madhe në dukshmërinë e punës së institucioneve dhe organizatave kompetente për zbatim të LNJF. Në këtë drejtim propozohet të përmirësohet informimi i opinionit lidhur me mundësitë për qasje në drejtësi nga sfera e mjedisit jetësor.

Gjithashtu, Shteti përkatësisht institucionet, duhet të sigurojnë realizim të të drejtës për qasje tek informatat lidhur me mjedisin jetësor, të sigurohet pjesëmarrje e publikut dhe të sigurojnë qasje në drejtësi me shpenzime të zvogëluara për procedurë (në pajtim me Konventën e Aarhusit).

Nevojitet azhurnitet më i madh i pushtetit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve në pjesën e mjedisit jetësor, si dhe angazhim më i madh i Prokurorisë publike në pjesën e inicimit të procedurave lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Duke e pasur parasysh Ligjin e ri për ndihmë juridike falas nuk është përjashtuar mjedisi jetësor si sferë në të cilën mund të kërkohet ndihmë juridike falas, duhet të punohet drejt inkurajimit të individëve që i plotësojnë kriteret në pajtim me NJF për shfrytëzim të të njëjtës. Me promovim më të madh të kësaj mundësie, do të sigurohet dukshmëri për qytetarët, përkatësisht do të afirmohet mbrojtja juridike për qasje tek informatat për mjedis jetësor. Njëkohësisht, kjo do ta përforcojë edhe implementimin e Konventës së Aarhusit, si mekanizëm ekzistues për qasje në drejtësi ekologjike.

Legjislacioni i Maqedonisë mundëson parashtrim të përbashkët të padisë nga grup qytetarësh (*actio popularis*), ndërsa të njëjtit mund të fitojnë edhe zbritje/çlirim nga shpenzimet për procedurë në pajtim me LNJ dhe Konventën e Aarhusit, që do ta përmirësojë qasjen në drejtësi për vendet e banuara ku jetojnë pjesëtarë të komuniteteve të marginalizuara dhe të lëndueshme, ndërsa krahas asaj ndikimet mbi mjedisin jetësor jo rrallë implikojnë pasoja mbi më shumë persona njëkohësisht.

Nevojitet fuqizim i kapaciteteve të Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publik në lidhje me të drejtën nga sfera e mjedisit jetësor dhe Konventa e Aarhusit, për t'u konstatuar nëse gjyqtarët dhe prokurorët publik përvetësojnë njohuri relevante për këtë tematikë. Nëse konstatohet që ekziston hapësirë për përmirësim të kapaciteteve të Akademisë në këtë sferë, të iniciohet zbatim i trajnimit plotësues dhe përgatitjes shtesë të ligjëruesve për përmirësim të qasjes në drejtësi nga sfera e mjedisit jetësor.

Propozohet të sigurohen informata për numrin e procedurave që janë nisur në lidhje me mbrojtjen e të drejtës për mjedis jetësor dhe të përlogaritët për qindja e suksesit të tyre, përkatësisht të procedurave lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor që janë iniciuar ose janë në rrjedhë. Gjithashtu, nevojitet ngritje e vetëdijes kolektive për domethënien dhe benefitet, mirëpo edhe pasojat që rezultojnë nga e drejta nga sfera e mjedisit jetësor dhe promovimi aktiv i kësaj të drejte. Në pajtim me standardet ndërkombëtare, nevojitet të inkorporohet e drejta e mjedisit jetësor të shëndoshë në më tepër zgjidhje ligjore, përkatësisht kudo të jetë e mundur, si kategori e posaçme e të drejtave, udhëzimeve dhe mësimëve për veprime të mëtutjeshme në rastet kur vjen deri në shkeljen e saj. Ekziston nevojë për t'u iniciuar diskutim me inkuadrim të Ministrisë për Mjedis Jetësor, Ministrisë për Drejtësi, Prokurorisë dhe gjykatësve të cilët e theksojnë rolin e tyre në aplikimin e qasjes në drejtësi dhe reduktim të barrierave.

Njëkohësisht, nevojitet avancim i sistemit për informim të publikut të përgjithshëm për të drejtat dhe obligimet që rezultojnë nga Kushtetuta, marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe dispozitat ligjore për mbrojtje të mjedisit jetësor (Ligji për mjedis jetësor, Ligjit për menaxhim me hedhurina, Ligji për mbrojtje të natyrës dhe ligje dhe akte nënligjore tjera), me qëllim i njëjti të jetë në funksion të përditshëm të qytetarëve dhe kompanive në R. e Maqedonisë.

Sa i përket ndërtimit të kapaciteteve, kjo nevojitet të bëhet në të gjitha nivelet e organeve shtetërore, vetëqeverisjen lokale dhe organizatat qytetare për pjesëmarrje aktive në sistemin për informim të publikut të përgjithshëm për të drejtat dhe obligimet lidhur me mjedisin jetësor.

Duhet të mundësohet qasje e lehtë dhe ndihmë juridike e qytetarëve dhe kompanive për të marrë informata për çështjet lidhur me mjedisin jetësor dhe mbrojtje juridike në realizimin e kësaj të drejte nëpërmjet ndihmës juridike falas. Për në fund, nevojitet inkuadrim efikas dhe efektiv i publikut të përgjithshëm në krijimin e politikave dhe ligjeve për mbrojtje të mjedisit jetësor, ndërsa veçanërisht në pjesën e menaxhimit me hedhurinat.

LITERATURA E PËRDORUR

1. Case Summary posted by the Task Force on Access to Justice, http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.j/Jurisprudence_prj/ARMENIA/Armenia_2009_2011_Teghout.pdf[hapur më 23.04.2019]
2. Commission v. French Republic, https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:62003CJ0239_SUM&from=FR[hapur më 12.06.2019]
3. Concul of Europe, Convention on Civil Liability for Damage resulting from Activities Dangerous to the Environment, Lugano, 21/06/1993 - Treaty open for signature by the member States, the non-member States which have participated in its elaboration and by the European Union, and for accession by other non-member States: <https://www.coe.int/en/web/cm> [hapur më 28.05.2019]
4. Concul of Europe, <https://www.coe.int/en/web/about-us/structure> [hapur më 07.05.2019]
5. European Union Network for the Implementation and Enforcement of Environmental Law (IMPEL), Ligjet e Bashkimit Evropian për mjedis jetësor (IMPEL): <https://www.impel.eu/about-impel/>[hapur më 09.05.2019]
6. http://www.adsdp.mk/adsdpmk/images/DRang/zakoni/ID_na_Zakonot_za_postapuvanje_po_pretstavki_i_predlozi_193_06112015.pdf. [hapur më 05.04.2019]
“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 93 nga 26.07.2007, [hapur më 29.05.2019]
7. Parliamentary Assembly ,Future action to be taken by the Council of Europe in the field of environment protection <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-en.asp?FileID=16731&lang=en>[hapur më 22.4.2019]
8. Themis Network Europe, Artikull i publikuar në themisnetwork.eu, Publikuar në themisnetwork.eu, <http://www.themisnetwork.eu/about-themis.html> [hapur më 17.04.2019]
9. United Nation, Climate Change, What is the Paris Agreement, <https://unfccc.int/process/the-paris-agreement/what-is-the-paris-agreement-0>[hapur më 06.05.2019]
10. Konventa e Aarhusit: si zbatohet qasja në dispozitat ligjore? (Belgjikë 2 qershor 2008), https://ec.europa.eu/environment/aarhus/pdf/conf/closing_speech.pdf [hapur më 13.05.2019]
11. Ueb faqe e Akademik.mk 17.01.2017, <https://akademik.mk/alternativnite-vonsudski-postapki-i-pristapot-do-pravda-evropskiot-parlament-i-sovetot-na-eu-za-medijatsijata-vo-graganskite-i-trgovskite-sporovi/>[hapur më 06.05.2019]
12. Ueb faqe e Inspektoratit Shtetëror për mjedis jetësor: http://www.sei.gov.mk/projects_page_mk.asp?ID=5
13. Rregullore e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së
14. Rregullore e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së
15. Direktiva 2003/4 / KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian nga 28 janari 2003 për qasje të publikut tek informatat për mjedis jetësor dhe për shfuqizim të Direktivës 90/313 / KEE të Këshillit, <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2003:041:0026:0032:EN:PDF>[hapur më 31.05.2019]

16. Marrëveshja për BE, Gjykatat e BE-së janë të obliguara me marrëveshjet ndërkombëtare që i lidh BE-ja, European Commission official web side, European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations, **European Commission - Enlargement - Europe agreement**, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/europe-agreement_en [hapur më 11.04.2019]
17. Komisioni Evropian, <http://ec.europa.eu/environment/waste/legislation/a.htm> [hapur më 18.06.2019]
18. Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, https://www.echr.coe.int/Documents/Court_in_brief_ENG.pdf[hapur më 25.04.2019]
19. Agjencia Evropiane për mjedis jetësor (EEA), <https://www.eea.europa.eu/about-us> [hapur më 23.04.2019]
20. Zhan Kllod Gotron, *Institucione juridiko-publike të të drejtës romake të recituara në sistemet e sotme juridike*, e Drejta Evropiane, Shkup 2006, <http://eprints.ugd.edu.mk/9927/1/Magisterska%20teza.pdf>[hapur më: 21.06.2019]
21. Zhan Kllod Gotron, *Kontribut në të drejtën ndërkombëtare rajonale e Drejta Evropiane*, Shkup 2006, faqe 33
22. Ligji përndihmë juridike falas, “Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 101 nga 22.05.2019 <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20besplatna%20pravna%20pomos.pdf>[hapur më 19.06.2019]
23. Ligji për ndihmë juridike falas, “Gazeta zyrtare e RMV-së” numër101 nga 22.05.2019, <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20besplatna%20pravna%20pomos.pdf>[hapur më 13.06.2019]
24. Ligji për mbrojtje të natyrës(“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër67/2004, 14/2006; 84/2007; 35/2010; 47/2011; 148/2011,59/2012 dhe 13/2013), <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/04b3bc15a4f14b3392180ebc7b584768.pdf> [hapur më 12.06.2019]
25. Ligji për cilësi të ajrit ambiental, “Gazeta zyrtare e RMV-së” numër47/2011” nga 31.07.2011, <http://www.moep.gov.mk/wpcontent/uploads/2014/09/Zakon%20za%20kvalitet%20na%20Vozduh%20-%20precisten%20tekst%20za%20informativni%20celi.pdf> [hapur më 02.04.2019]
26. Ligji për veprim për parashtrësia dhe propozime (“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër82/2008...193/2015)
27. Ligji për ratifikim më 4 dhjetor 1997“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 61/97, kurse në fuqi ka hyrë më 28 prill 1998, http://www.zeleni.org.mk/fileadmin/user_upload/publications/Odrzliviot_Razvoj_i_Zivotnata_sredina_niz_dokumentite_na_UN.pdf [hapur më 04.06.2019]
28. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi “Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 101 nga 22.5.2019, <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2019/27,5Zakon%20za%20zastita%20od%20diskriminacija.pdf>[hapur më 20.06.2019]
29. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, “Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 101 nga 22.5.2019]
30. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi(“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër50/10)
31. Ligji për ndërtim <http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=4694> [hapur më 22.04.2019]

32. Ligji për mjedis jetësor, “Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 147/2008 dhe 45/2011,
33. Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi (“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër150/15), <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2019/27,5Zakon%20za%20zastita%20od%20diskriminacija.pdf> [hapur më 20.06.2019]
34. Ligji për ndryshim të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi (“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër44/14)
35. Ligji për lëndë të para minerale, (“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 136/12 , 25/13, 93/13,44/14,160/14, 195/15,192/15,39/16,53/16,120/16,189/16),Nen i55, paragrafi (2), alineja 4 [http://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20mineralni%20surovini%20-%20Precisten%20tekst%20\(Rabotna%20verzija\).pdf](http://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20mineralni%20surovini%20-%20Precisten%20tekst%20(Rabotna%20verzija).pdf)[hapur më 13.06.2019]
35. Ligji për marrëdhëniet obligative (“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 18 nga 03/2001, 09/2001, 25/2001, 17/2002, 01/2003, 07/2008, 06/2009, 12/2009, <http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=33>[hapur më 29.05.2019]
36. Ligji për procedurë kontestimore (“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 7 nga 20.01.2011), <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-panichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf>[hapur më 09.09.2019]
37. J. Majr/rtr/afp,Çfarë sjellë marrëveshja për klimën nga Parisi?publikuar në DW më 13.12.2015, <https://p.dw.com/p/1HMg4> [hapur më 22.04.2019]
38. Konventa për përgjegjësi qytetare për dëmet si rezultat i aktiviteteve të rrezikshme për mjedisin jetësor, detaje për Marrëveshjen numër 150, Këshilli i Evropës, <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/150>[hapur më 22.04.2019]
39. Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut Romë, 4 nëntor 1950 neni 14, https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf [hapur më 13.05.2019]
40. Konventë për qasje ndërkombëtare në drejtësi 1, <https://assets.hcch.net/docs/a311a685-d6e7-41d4-8210-7c2b8c30429e.pdf> [hapur më 05.06.2019]
41. Konfiguracion i Këshillit për mjedis jetësor (ENVI), <https://www.consilium.europa.eu/en/council-eu/configurations/env/>[hapur më 17.06.2019]
42. Margarita M. Matlievska, Zhvillim i qëndrueshëm, paradigmë e re globale, Shkup 2011, Funksionet e Komisionit janë përcaktuar në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme numër A/RES/47/191 nga 22 dhjetori 1992, fq.33, <https://www.academia.edu/2925222/> [hapur më 04.06.2019]
43. Traktati ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike, OKB, 1976, mund ta gjeni në: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CCPR.aspx>[hapur më 18 prill 2017]
44. Ministria për Punë të Jashtme e RMV-së, http://mfa.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=124&Itemid=403&lang=mk
45. Raport nacional për implementim të Konventës së Aarhusit, 2017, Raste: Us1149 / 97, Us-89/01 https://apps.unece.org/ehlm/pp/NIR/listnr.asp?YearID=2017&wf_Countries=MK&wf_Q=QA&Quer_ID=&LngIDg=EN&YearIDg=2017[hapur më 08.05.2019]

46. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtje e mjedisit jetësor nëpërmjet dokumenteve të Kombeve të Bashkuara, botues Qendra e gjelbër e Maqedonisë, 2008, fq. 4 <https://civil.org.mk/wp-content/uploads/2013/05/djeklarazia.pdf> [hapur më 16.6.2019]
47. *Përshkrim i Bashkimit Evropian – Si punon Bashkimi Evropian*, botues Komisioni Evropian, 2012, European Commission official web side, European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations, **European Commission - Enlargement - Europe agreement**, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/europe-agreement_en [hapur më 14.05.2019]
48. Koment i përgjithshëm numër 36 (2018) për nenin 6 të Traktatit ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike, për të drejtën për jetë, https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CCPR/Shared%20Documents/1_Global/CCPR_C_GC_36_8785_E.pdf [hapur më 05.06.2019]
49. Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD), <https://www.oecd.org/gov/access-to-justice.htm>, [hapur më 26.05.2019]
50. Otatio Kviriko dhe Muuld Bumurgar, *Ndryshime klimatike dhe të drejta të njeriut: perspektivë për të drejtën ndërkombëtare dhe komparative*, fq. 303
51. Marrëveshja klimatike e Parisit, në fuqi nga 4 nëntor 2016, https://unfccc.int/files/meetings/paris_nov_2015/application/pdf/paris_agreement_english.pdf [hapur më 13.05.2019]
52. *E drejta për mjedis jetësor obligim i secilit qytetar dhe kompani*, botues Qendra për hulumtime dhe analiza juridike – QHAJ, dhjetor 2014, fq.3, <https://cpia.mk/> [hapur më 12.06.2019]
53. Rekomandimi 1614 (2003), Asambleja Parlamentare e Evropës, <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=17131&lang=en> [hapur më 22.04.2019]
54. Rekomandimi 1885 (2009), Asambleja Parlamentare e Evropës, <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetailsEN.asp?fileid=24830&lang=EN&search=cmNvbW1lbmRhdGlvbiAxODg1> [hapur më 11.04.2019]
55. Doracak për të drejtën evropiane lidhur me qasje në drejtësi, Agjencia e Bashkimit Evropian për të drejta themelore dhe Këshilli i Evropës, 2016 https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_access_justice_ENG.pdf [hapur më 23.04.2019]
56. Qasje në drejtësi lidhur me mjedisin jetësor: qëndrim, shpenzime dhe mjete në dispozicion lidhur me Konventën për qasje tek informatat, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi në mjedisin jetësor Evropa juglindore, autor Ksaba Kis http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.j/AnalyticalStudies/SEE_Access2Justice_Study_Final_logos.pdf [hapur më 08.05.2019]
57. Protokollin numër 12 i Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut Romë, 4 nëntor 2000, neni 1, https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf [hapur më 14.05.2019]
58. Protokollin i Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut Paris, 20 mars 1952, neni 1, https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf [hapur më 06.05.2019]
59. Rezoluta 2152 (2017), 27 janar 2017, Asambleja Parlamentare e Këshillit Të Evropës <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-EN.asp?fileid=23489&lang=en> [hapur më 09.05.2019]

60. Raportuesi pranë KB për të drejtat e njeriut dhe mjedis jetësor <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Environment/SREnvironment/Pages/SREnvironmentIndex.aspx>[ndërmarrë më 10.04.2019]
61. Snezhana Mishiq, *Udhëzues për zbatim të Konventës së Aarhusit*, Komisioni ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë 2000, fq.149, <http://documents.rec.org/publications/PPTtoolkitMAC.pdf>[hapur më 07.06.2019]
62. Këshilli i Evropës, <https://www.coe.int/mk/web/skopje/the-council-of-europe> [hapur më 08.04.2019]
63. Urdhëresë për pjesëmarrje të publikut gjatë përpunimit të dispozitave dhe akteve tjera si dhe të planeve dhe programeve nga sfera e mjedisit jetësor (“Gazeta zyrtare e RMV-së” numër 147/2008 dhe 45/2011)
64. Konferenca e Hagës për të drejtën private ndërkombëtare dhe për tekstin integral të Konventës në <https://www.hcch.net/> [hapur më 12.06.2019]
65. Hendrik Shukens, *Qasje në drejtësi në raste të mjedisit jetësor sipas aktgjykimeve të Gjykatës së drejtësisë*, 13 janar 2015.



